



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më datë _____. _____. 2024

VENDIM

Nr. 208, datë 18.04.2024

**PËR
RRËZIMIN E KËRKESËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR
CAKTIM MASE DISIPLINORE NDAJ GJYQTARIT Z. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 147, 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 146 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 86, shkronja “e”, nenet 97, 98 dhe 100 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 104 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, shqyrtoi kërkesën për procedimin disiplinor nr.4/2024, që i përket:

KËRKUES:

Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

SUBJEKT I PROCEDIMIT:

Magjistrati z. {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.

OBJEKTI I KËRKESËS:

1. Fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.
2. Propozimin për caktimin e masës disiplinore “*Shkarkim nga detyra*”.

BAZA LIGJORE:

Neni 102, pika 1, shkronja “dh”, neni 102, pika 2, shkronja “a” dhe neni 111 i Ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë dëgjimore publike, në përputhje me parashikimet e neneve 142 e e vijues, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe dëgjoi:

- **Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, përfaqësuar nga znj. Alma Tafani dhe z. Julian Zonja**, të cilët përfundimisht kërkuan pranimin e kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1, shkronja “dh”, neni 102, pika 2, shkronja “a” e Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe caktimin ndaj tij të masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”.
- **Magjistratin z. {...}**, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

V Ë R E N:

1. Magjistrati z. {...} ushtron funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.¹

2. Në datë 19.02.2024, në Këshillin e Lartë Gjyqësor, është depozituar kërkesa Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për fillimin ndaj tij të procedimit disiplinor², për shkeljet disiplinore të parashikuara nga nenet 102, pika 1, shkronja “dh” dhe 102, pika 2, shkronja “a” të Ligjit nr.96/2016, “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (referuar në vijim si Ligji për Statusin). Në kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur propozimin për caktimin ndaj magjistratit z. {...} të masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” të parashikuar nga neni 111 i Ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor mbështetet në nenin 194 të Ligjit nr. 115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të ndryshuar, dhe në nenin 138 të Ligjit nr. 96/2016, “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

I. PROCEDURA E ZHVILLUAR NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

¹ Me vendimin nr. 528, datë 11.10.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: 1. Trasferimin e përkohshëm me pëlqim të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një periudhë deri në një vit, që mund të ndërpritet në rast të ndryshimit të rrethanave që kushtëzuan transferimin.

²Shkresa nr. 674/38 prot., datë 16.02.2024 e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, depozituar me nr. nr.1081prot., datë 19.01.2024 në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

3. Pas depozitimit të kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...} dhe pas hedhjes së shortit, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr.95, datë 23.02.2024, ka vendosur të caktojë si relator të çështjes, z. Ilir Rusi, në cilësinë e anëtarit të Komisionit Disiplinor.

3.1. Vendimi për caktimin me short të relatorit të çështjes i është njoftuar palëve të procedimit disiplinor përkatësisht ILD-së dhe magjistratit z. {...}, brenda afatit 5 ditor të parashikuar në nenin 141 të Ligjit për Statusin.

4. Me vendimin nr.106, datë 29.02.2024, mbi propozimin e relatorit të çështjes, Këshilli ka vendosur kalimin e çështjes në seancë dëgjimore, duke caktuar datën 19.03.2024, ora 11:00, si datë të zhvillimit të seancës dëgjimore, për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, duke njoftuar rregullisht palët sipas parashikimeve të nenit 138 të Ligjit për Statusin.

4.1. Bashkë me njoftimin për caktimin e seancës dëgjimore, magjistratit i janë njoftuar dhe të drejtat e tij gjatë procedimit disiplinor, si dhe i është caktuar një afat deri në datë 15.03.2024, për të paraqitur një parashkrim me shkrim, sipas përcaktimeve të nenit 141 pika 2, shkronja a) të ligjit.

4.2. Në caktimin e seancës dëgjimore, Këshilli ka vlerësuar, njëkohësisht dhe rastet e parashikuara nga neni 139 i Ligjit për Statusin³, të cilat e çojnë atë drejt vendimarrjes për mbylljen e procedimit disiplinor, pa zhvilluar seancë dëgjimore. Sipas parashikimeve të nenit 117 të Ligjit për Statusin, shkelja disiplinore parashkruhet brenda pesë vjetëve. Duke patur në konsideratë datën e fillimit të hetimit disiplinor dhe afatin e parashkrimit për shkeljet disiplinore të pretenduara, fillimi i hetimit disiplinor u konstatua se është vendosur nga ILD brenda këtij afati parashkrimi për tre nga katër çështjet e hetuara. Po kështu, nga verifikimet e kryera dhe të dhënat e dosjes hetimore, nuk rezultoi që shkeljet e pretenduara, të ketë qenë objekt i ndonjë procedimi disiplinor, të zgjidhur me vendim të formës së prerë. Sipas nenit 134, pika 1, shkronjat “ç” dhe “d” të Ligjit për Statusin, parashikohet se Inspektori mbyll hetimin disiplinor, nëse provohet se rezultatet e hetimit të çojnë drejt përfundimit se magjistratit i mbaron statusi, bazuar në kriteret e parashikuara, në shkronjat “b” deri në “ç”, të pikës 1, të nenit 64 të ligjit ose ai nuk ushtron funksionin e tij në mënyrë të përhershme,

³ Neni 139 i ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar - **Mbyllja e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore** – “1. Këshilli vendos mbylljen e procedimit disiplinor pa zhvilluar seancë dëgjimore nëse: a) shkelja disiplinore është parashkruar në kohën kur ka filluar hetimi, sipas parashikimeve të nenit 117 të këtij ligji; b) çështja ka qenë objekt i procedimit disiplinor që është zgjidhur me vendim të formës së prerë; c) ka arsye të tjera për të mbyllur procedimin, në përputhje me parashikimet e nenit 134, pika 1, shkronjat “ç” dhe “d”; ç) raporti i hetimit është depozituar pa u arsyetuar. 2. Dorëheqja e magjistratit nuk ndalon fillimin ose vazhdimin e procedimit disiplinor. 3. Këshilli mbyll procedimin disiplinor, sipas parashikimeve të pikës 1, të këtij neni, me vendim të arsyetuar me shkrim. Ai njofton palët për shkaqet e mbylljes.”

sipas parashikimeve të nenit 67 të tij⁴ ose magjistrati ka vdekur. Nga verifikimet e kryera dhe nga të dhënat e dosjes hetimore, Këshilli ka arritur në përfundimin se nuk rezultoi e provuar ekzistenca e ndonjë prej këtyre shkaqeve ligjore.

4.3. Bashkë me kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, në Këshill është depozituar edhe raporti i hetimit të miratuar nga Inspektori, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 3 e Ligjit për Statusin⁵. Referuar këtij parashikimi ligjor, Këshilli ka vlerësuar se raporti i hetimit është depozituar i arsyetuar në të gjithë elementët formalë të kërkuar nga kjo dispozitë.

II. RRETHANAT E FAKTIT

5. Me vendimin nr. 23-2016-2524/394, datë 23.12.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, shtetasi {...} është dënuar për veprën penale “*Dhuna në familje*”, parashikuar nga neni 130/a-4 i Kodit Penal, me 15 muaj burgim. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë me vendimin nr.20-2017-303/81, datë 18.04.2017.

5.1. **Me kërkesën e datës 24.09.2018 shtetasi {...} ka kërkuar “lirimin me kusht”**. Bazuar në informacionit mbi shortin e datës 24.09.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, ka rezultuar se kërkesa e shtetasit {...} është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë me nr. 80002-00827-21-2918, nr. 13 akti, në datën 24.09.2018 dhe i është shortuar gjyqtarit {...} në datë 24.09.2018.

5.2. Me vendimin nr. 13/21-2018-1692, datë 23.10.2018, gjyqtari {...} ka vendosur pranimin e kërkesës dhe lirimin me kusht të të dënuarit {...}, duke urdhëruar pezullimin e pjesës së mbetur pavuajtur prej 3 (tre) muaj e 28 (njëzet e tetë) ditë burgim, të dënimit të dhënë me vendimin nr. 394, datë 23.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, duke e vënë në provë të dënuarin {...}, për një periudhë prej 3 (tre) muaj e 28 (njëzet e tetë) ditë. Përfaqësuesi i prokurorisë, prokurori {...} ka mbajtur qëndrim për pranimin e kërkesës.

5.3. Mbi vendimin nr. 13/21-2018-1692 nuk është ushtruar e drejta e ankimit dhe për rrjedhojë ky vendim ka marrë formë në datë 07.11.2018. Në bazë të urdhrit të ekzekutimit të

⁴ Neni 67 i ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar – *“Pamundësia fizike dhe mendore e një magjistrati - 1. Me marrjen djenë, Këshilli heton rastet për pamundësi fizike dhe mendore të magjistratit, të cilat çojnë në largimin nga funksioni ose pezullimin e përkohshëm të magjistratit... .”*

⁵ Neni 133 i ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar – *“Dokumentacioni i hetimit - ... 3. Me përfundimin e hetimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë harton raportin e hetimit, i cili përmban të paktën: a) emrin dhe mbiemrin e inspektorit kompetent; b) shkaqet për të filluar hetimin, subjektin dhe objektin e hetimit, sipas përcaktimeve të bëra në vendimin për fillimin e hetimit, ndryshimin ose shtimin e objektit të hetimit; c) veprimet e kryera gjatë hetimit; ç) përmbledhjen e deklaratave të magjistratit përkatës dhe të personave të tjerë ose institucioneve; d) parashtrimin e fakteve të pranuar dhe të papranuara, ashtu si edhe të provave, si dhe vlerësimin e vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre; dh) analizën ligjore të fakteve të pranuar që mbështesin përfundimin se shkelja disiplinore e pretenduar është kryer ose se hetimi duhet mbyllur; e) propozimin për mbylljen e hetimit ose për fillimin e procedimit disiplinor dhe propozimin për caktimin e masës disiplinore.”*

prokurorit dërguar me shkresë nr. 1051, datë 23.10.2018, shtetasi {...} është liruar në datën 23.10.2018.

6. I dënuari {...} ka paraqitur kërkesë për “lirim me kusht”, e cila është regjistruar me nr. 80103-00094-21-2021, datë 28.01.2021. Sipas informacionit mbi shortin e datës 28.01.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, kërkesa është shortuar pranë gjyqtarit {...}, me peshën në short 75 %. (në periudhën e gjykimit ushtronte detyrën zv/kryetarit (drejtuesit) të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë)

6.1. Në kërkesën e datës 28.01.2021, shtetasi {...} ka kërkuar lirimin me kusht, duke pretenduar se ka kryer dënimin e parashikuar nga ligji si prag për kërkimin e lirimit para kohe me kusht, si dhe duke qenë se vuajtja e dënimit ja ka arritur qëllimit të dënimit, pasi gjatë kohës së qëndrimit në {...} ndaj tij nuk ka masa disiplinore. Bashkëlidhur kërkesës ai ka paraqitur vendimin e dënimit me nr. 23-2020-506/98, datë 21.04.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë me shënimin e marrjes formë të prerë me vendimin nr. 20-2020-415/36, datë 10.09.2020 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

6.2. Rezulton se gjatë seancës së datës 30.03.2021, shtetasi {...} ka kërkuar heqjen dorë nga kërkesa dhe pushimin e gjykimit me arsyetimin: *“për ta ngritur këtë kërkim në një moment tjetër, që ai ta çmojë si më të përshtatshëm”*. Me vendimin nr. 21-2020-627/6, datë 30.03.2021, gjyqtari {...}, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes penale nr. 6, datë 28.01.2021, me kërkesë {...}, me objekt: *“Lirim me kusht”*. Vendimi ka marrë formë të prerë në datën 14.04.2021 pa u ankimuar.

7. I dënuari {...} ka paraqitur kërkesë për “uljen e dënimit”, regjistruar me nr. regj Them. 124/80001-00723-21-2021, datë regj.13.09.2021. Me vendimin nr. 21-2021-1574/124, datë 23.09.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, është vendosur ulja e dënimit me 90 (nëntëdhjetë) ditë, të dhënë me vendimin nr.23-2020-506/98 datë 21.04.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, lënë në fuqi me vendimin nr. 36, datë 30.09.2021 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, për periudhën e vuajtjes së dënimit, nga data 11.09.2020 deri në datën 12.09.2021. Vendimi ka marrë formë të prerë pa ankim në datën 08.10.2021.

8. Rezulton se shtetasi {...} ka paraqitur kërkesë të re për “lirim me kusht” depozituar në gjykatë në datën 02.09.2021. Bazuar në informacionin mbi shortin e datës 13.09.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, rezulton se **kërkesa e shtetasis {...} për “lirimin me kusht”,** është regjistruar me nr.17/80103-00700-21-2021 Akti, datë 13.09.2021, pra në të njëjtën datë me kërkesën për *“ulje dënimi”* regjistruar me nr. 124/80001-00723-21-2021, datë 13.09.2021, shortuar të dyja pranë gjyqtarit {...}, me peshën në short 75 %. Këto kërkesa janë gjykuar paralelisht nga gjyqtari {...}.

8.1. Me vendimin nr. 21-2021-1771/17, datë 21.10.2021, gjyqtari {...} ka vendosur lirimin me kusht të të dënuarit {...}, duke urdhëruar pezullimin e pjesës së mbetur pavuajtur prej 1 (një) vit e 21 (njëzet e një) ditë burgim, të dënimit të dhënë me vendimin nr. 23-2020-506/98,

datë 21.04.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, duke e vënë në provë të dënuar {...} për një periudhë prej një (1) vit e 21 (njëzet e një) ditësh, duke urdhëruar të dënuar {...} që gjatë kësaj periudhe prove, të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës, që mbulon vendbanimin ose vendqëndrimin e tij. Në aplikim të nenit 60/9 të K. Penal, urdhërohet të mos shoqërohet me persona të dënuar.

9. Vendimi nr. 22/21-2019-2200, datë 22.11.2019 i gjyqtarit {...}, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me kërkues {...}, me anë të të cilit është vendosur pranimi i kërkesës së të dënuarit për lirim me kusht, duke e vënë atë në provë për kohën e mbetur të dënimit për një periudhë prej 4 muajsh e 8 ditë. Vendimi ka marrë formë të prerë në datë 10.12.2019 pa u ankimuar nga palët.

10. Vendimi nr. 06/21-2018-496, datë 27.03.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me kërkues {...}. Gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës duke arsyetuar se “ Kërkuesi nuk paraqiti asnjë provë për të provuar kushtin procedural të mospasjes së një kërkesë të rrëzuar, jo më afër se 6 muaj nga paraqitja e kërkesës në shqyrtim. Kërkuesi dështoi të provonte para gjykatës plotësimin e kushteve procedurale të parashikuara në nenin 477 të Kodit të Procedurës Penale dhe si pasojë gjykata nuk mund të marrë në shqyrtim dhe të shprehet në lidhje me plotësimin e kushteve materiale të parashikuara në nenin 64 të Kodit Penal.

10.1. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim, kërkuesi {...}, duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe pranimin e kërkesës. Pasi ka shqyrtuar shkaqet e ankimit, Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin e saj nr. 20-2018-396/45, datë 03.05.2018 ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr. 06/21-2018-496, datë 27.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe pranimin e kërkesës së të dënuarit M. Sh dhe lirim para kohe me kusht për një kohë prove prej 6 muajsh, 22 ditë të të dënuarit”*,

III. PRETENDIMET E INSPEKTORIT TË LARTË I DREJTËSISË

11. Ankuesja {...} {...}mi, i është drejtuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me ankesën e depozituar pranë Këshilli i Lartë Gjyqësor me nr. 1495 prot., date 08.03.2019, e cila është përcjellë për kompetencë pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ku është regjistruar me nr. 979 prot., datë 09.06.2020. Në ankesë pretendohet se gjyqtari {...} me vendimin nr. 13/21, datë 23.10.2018 ka vendosur pranimin e kërkesës dhe lirim me kusht të të dënuarit K. SH, duke shkelur nenin 64 të K. Penal në të cilin parashikohet se nuk lejohet lirimi me kusht i të dënuarit përsëritës, duke bërë kështu një precedent të rrezikshëm për shkeljen e ligjit dhe përfitimin pa të drejte të të dënuarve, të cilët paraqesin rrezikshmëri të theksuar shoqërore. Ankuesja pretendon se dënimi i mëparshëm i këtij shtetasi prej 3 muaj nuk është

ekzekutuar dhe çuditërisht gjykata ka pranuar lirimin e tij me kusht edhe pse kishte pa vuajtur dënimin për një vendim tjetër gjykate të formës së prere me 3 muaj burgim.

11.1. Gjithashtu, në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të njëjtin magjistrat dhe për të njëjtën shkelje të pretenduar rezulton se ka paraqitur ankesë me nr. 29 prot., datë 6.1.2022 shtetasi {...}, i cili pretendon se: *“Ka liruar shtetasin {...} me kusht, në kundërshtim me ligjin, pak ditë para se të dilte në seancë Vettingu dhe vazhdon të lirojë kriminelë çdo ditë”*.

12. Në mbështetje të nenit 121, pika 2, shkronja “b” dhe nenit 122 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, me vendimin nr. 674/2 prot., datë 28.02.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është vendosur verifikimi i ankesës të paraqitur nga ankuesja {...} {...}mi, ndaj magjistratit {...}, me marrjen e të dhënave në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë⁶, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

12. 1. Në të njëjtën kohë, me vendimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nr. 29/6 prot., datë 02.06.2022 *“Për verifikimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës”*, është vendosur verifikimi i ankesës nr. 29 prot., datë 06.01.2022 të paraqitur nga shtetasi z. {...}, ndaj veprimtarisë së magjistratit {...} duke kërkuar të dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.⁷ Duke qenë se, kemi të bëjmë me shkelje të pretenduara ndaj të njëjtit magjistrat, bazuar në nenin 128 të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, me vendimin nr.674/9, datë 24.04.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë u vendos bashkimi i ankesës së shtetasës {...} {...}mi me ankesën e paraqitur nga shtetasi {...}, në proces verifikimi.

13. Nga dokumentacioni i inspektimit tematik të filluar me vendimin nr. 1, datë 11.02.2020, ndryshuar me vendimin nr. 43, datë 03.10.2022 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili ka për objekt trajtimin e kërkesave me objekte: Lirim me kusht, për periudhën 01.01.2017-31.01.2020, ku objekt inspektimi është dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, janë administruar vendimet e pranimit të kërkesave për lirim me kusht, të marra nga gjyqtari {...} në këtë periudhë.

14. Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. 674/11 prot., datë 16.5.2023, *“Për fillimin e hetimit disiplinor me nismë të ankuesit”*, ka vendosur fillimin e hetimit disiplinor me nismë të ankuesit ndaj magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, për shkelje disiplinore gjatë veprimtarisë në ushtrimin e funksionit si gjyqtar, të parashikuara nga neni të parashikuara nga neni 102, pika 1, shkronja “dh”, dhe neni 102, pika 2, shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën*

⁶ Shkresa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë me nr.453/1, datë 09.03.2023, e regjistruar në Zyrën e ILD-së me nr. 674/6 prot., datë 13.03.2023;

⁷ Shkresa nr. 29/5 prot., datë 02.06.2022, Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

e *Shqipërisë*” i ndryshuar, gjatë shqyrtimit të çështjeve gjyqësore për të cilat janë dhënë vendimet nr. 13/21-2018-1692, datë 23.10.2018, për lirim me kusht të kërkuarit {...}, vendimi nr. 21-2021-1771/17, datë 21.10.2021 për lirim me kusht të kërkuarit {...}, vendimi nr. 21-2021-1574/124, datë 23.09.2021 për ulje dënimi për kërkuarin {...}, vendimi nr. 22/21-2019-2200, datë 22.11.2019 për lirim me kusht të kërkuarit {...}, vendimi nr. 06/21-2018-496, datë 27.03.2018 për lirim me kusht të kërkuarit {...}, vendimi nr. 02/21-2018-69, datë 18.01.2019 për lirim me kusht të kërkuarit {...}, vendimi nr. 21/21-2018-2129, datë 27.12.2018 për lirim me kusht të kërkuarit {...}, vendimi nr. 14, datë 02.10.2017 për lirim me kusht, të kërkuarit {...}, vendimi nr. 6/21-2018-384, datë 06.03.2018 për lirim me kusht, të kërkuarit {...}, vendimi nr. 03/21-2019-277, datë 14.02.2019 për lirim me kusht, të kërkuarit {...}, vendimi nr. 05/21-2019-156, datë 30.01.2019 për lirim me kusht, të kërkuarit {...}, vendimi nr. 05, datë 09.02.2017, për lirim me kusht të kërkuarit {...}, vendimi nr. 03, datë 27.01.2017, për lirim me kusht të kërkuarit {...}, vendimi nr. 09, datë 11.05.2017, për lirim me kusht të kërkuarit {...}, të gjyqtarit {...}.

15. Në mbështetje të parashikimeve të nenit 100, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet detyrimi për të hetuar nëse ka shkaqe të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur një shkelje disiplinore. Ky detyrim lidhet me dokumentimin e saktë të fakteve që japin shkaqe të mjaftueshme lidhur me veprime apo mosveprime të magjistratit për të krijuar bindjen se ka ndodhur një shkelje disiplinore.

16. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve që kanë lidhje me hetimin disiplinor janë hetuar kryesisht të gjitha faktet, si dhe janë vlerësuar të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes. Në të njëjtën kohë, në kuadër të zhvillimit të veprimeve hetimore është mbajtur në konsideratë fakti se dispozitat e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar plotësohen me parashikimet e ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe.

17. Për këtë qëllim, në mbështetje të nenit 132 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenit 77 e 80 të Kodit të Procedurave Administrative në kuadër të këtij hetimi disiplinor janë administruar në cilësinë e provës dokumentacion nga ana e institucioneve, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, inspektimet tematike të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, i marrë gjatë verifikimit dhe gjatë hetimit disiplinor.

18. Në analizë të identifikimit të elementeve faktikë dhe juridikë të cilat provojnë, ekzistencën e shkeljes disiplinore, si dhe nuk diktojnë mbylljen e hetimit disiplinor, paraprakisht vlerësohet se në mbështetje të parashikimeve të nenit 117, nenit 120, pika 1,

shkronja “b”, “ç” “d” “dh”, nenit 134, pika 1, shkronja “a”, “b” “c” “d”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, gjatë procesit hetimor duhet të analizohen një sërë çështjesh të cilët kanë të bëjnë me: (i) ekzistencën e një veprimi/mosveprimi të magjistratit i cili parashikohet si shkelje disiplinore nga ligji në kohën e kryerjes së saj dhe në kohën e konstatimit të saj; (ii) ekzistencën e një veprimi/mosveprimi të magjistratit që ka ndodhur brenda afatit të parashkrimit për hetimin disiplinor referuar nenit 117, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nuk është parashkruar në kohën kur është filluar hetimi disiplinor, për shkak të kalimit të afateve; (iii) faktin nëse çështja ka qenë objekt i një hetimi të mëparshëm që është mbyllur ose për të cilën është dhënë vendim i formës së prerë, në kuadër të një procedimi disiplinor; (iv) faktin se shkelja disiplinore është kryer nga magjistrati ndaj të cilit po zhvillohet hetimi disiplinor gjatë kohës që ka qenë në detyrë dhe magjistratit gjatë zhvillimit të hetimit disiplinor nuk i ka mbaruar statusi i magjistratit, nuk ka dalë në pension, nuk ka vdekur, bazuar në kriteret e parashikuara, në shkronjat “b” deri në “ç”, të pikës 1, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016, apo nuk ushtron funksionin e tij në mënyrë të përhershme, sipas parashikimeve të nenit 67 të këtij ligji.

18.1. Në analizë të provave të administruara në kuadër të këtij procesi hetimor, me qëllim identifikimin e elementeve faktikë dhe juridikë të cilat provojnë ekzistencën e shkeljes disiplinore, rezulton se në rastin konkret nuk ekziston asnjë rrethanë faktike apo element juridik që dikton mbylljen e hetimit disiplinor nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në mbështetje të parashikimeve të nenit 117, nenit 120, pika 1, shkronja “b”, “ç” “d” “dh”, dhe nenit 134, pika 1, shkronja “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

18.1.1. Për sa i përket ekzistencës së një veprimi/mosveprimi të magjistratit që parashikohet si shkelje disiplinore nga ligji në kohën e kryerjes së saj, si dhe në kohën e konstatimit të saj, rezulton në kohën e dhënies së vendimit nr. 13/21-2018-1692, datë 23.10.2018, për lirim me kusht të kërkuesit {...}, vendimin nr. 21-2021-1771/17, datë 21.10.2021 për lirim me kusht të kërkuesit {...}, vendimin nr. 21-2021-1574/124, datë 23.09.2021 për ulje dënimi për kërkuesin {...}, vendimin nr. 22/21-2019-2200, datë 22.11.2019 për lirim me kusht të kërkuesit {...}, vendimin nr. 06/21-2018-496, datë 27.03.2018 për lirim me kusht të kërkuesit {...}, ka qenë në fuqi ligji nr. 96/2016 “ Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, ku shkeljet disiplinore parashikohen në nenet 101, 102, 103 dhe 104 të këtij ligji. Në të njëjtën kohë nëse provohet kryerja e veprimeve/mosveprimeve nga ana e magjistratit subjekt hetimi disiplinor, ato përbëjnë gjithashtu shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit të parashikuar në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “ Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe përkatësisht nga neni 102, pika 1, shkronja “dh” dhe neni 102, pika 2, shkronjat “a” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në

Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, lidhur me dhënien e vendimit nr. 13/21-2018-1692, datë 23.10.2018, për lirim me kusht të kërkuesit {...}, vendimin nr. 21-2021-1771/17, datë 21.10.2021 për lirim me kusht të kërkuesit {...}, vendimin nr. 21-2021-1574/124, datë 23.09.2021 për ulje dënimi për kërkuesin {...}, vendimin nr. 22/21-2019-2200, datë 22.11.2019 për lirim me kusht të kërkuesit {...}, vendimin nr. 06/21-2018-496, datë 27.03.2018 për lirim me kusht të kërkuesit {...}.

18.1.2. Për sa i përket ekzistencës së një veprimi/mosveprimi të magjistratit që ka ndodhur brenda afatit të parashkrimit për hetimin disiplinor, referuar nenit 117, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar rezulton se vendimi nr. 13/21-2018-1692, datë 23.10.2018, për lirim me kusht të kërkuesit {...}, vendimi nr. 21-2021-1771/17, datë 21.10.2021 për lirim me kusht të kërkuesit {...}, vendimi nr. 21-2021-1574/124, datë 23.09.2021 për ulje dënimi për kërkuesin {...}, vendimi nr. 22/21-2019-2200, datë 22.11.2019 për lirim me kusht të kërkuesit {...}, vendimi nr. 06/21-2018-496, datë 27.03.2018 për lirim me kusht të kërkuesit {...}, vendimi nr. 02/21-2018-69, datë 18.01.2019 për lirim me kusht të kërkuesit {...}, vendimi nr. 21/21-2018-2129, datë 27.12.2018 për lirim me kusht të kërkuesit {...}, vendimi nr. 14, datë 02.10.2017 për lirim me kusht, të kërkuesit {...}, vendimi nr. 6/21-2018-384, datë 06.03.2018 për lirim me kusht, të kërkuesit {...}, vendimi nr. 03/21-2019-277, datë 14.02.2019 për lirim me kusht, të kërkuesit {...}, vendimi nr. 05/21-2019-156, datë 30.01.2019 për lirim me kusht, të kërkuesit {...}, janë dhënë nga gjyqtari {...}, brenda afatit 5 vjeçar të parashkrimit të shkeljes disiplinore dhe çështjet e sipërcituara nuk janë parashkruar në kohën kur ka filluar hetimi disiplinor, për shkak të kalimit të afatit 5 vjeçar. Ndërsa, vendimet nr. 05, datë 09.02.2017, për lirim me kusht të kërkuesit {...}, vendimi nr. 03, datë 27.01.2017, për lirim me kusht të kërkuesit {...}, vendimi nr. 09, datë 11.05.2017, për lirim me kusht të kërkuesit {...}, të gjyqtarit {...}, janë dhënë jashtë afatit 5 vjeçar të parashkrimit të shkeljes disiplinore.

18.1.3. Në të njëjtën kohë rezulton se asnjë prej çështjeve të mësipërme nuk ka qenë objekt i një hetimi të mëparshëm që është mbyllur ose për të cilën është dhënë vendim i formës së prerë, në kuadër të një procedimi disiplinor, me pasojë mbyllje hetimi sipas parashikimeve të shkronjës “b”, pika 1, të nenit 134, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Në rastin konkret, rezulton e provuar gjithashtu se nga ana e magjistratit subjekt hetimi disiplinor janë ndërmarrë veprime/mosveprime gjatë kohës që ka qenë në detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe nuk i ka mbaruar statusi i magjistratit bazuar në kriteret e parashikuara në shkronjat “b” deri në “ç”, të pikës 1, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016, ose nuk ushtron funksionin e tij në mënyrë të përhershme, sipas parashikimeve të nenit 67 të këtij ligji.

19. Në mbështetje të parashikimeve të nenit 3, 101, 102, pika 1, shkronja “dh”, nenit 102 pika 2, shkronjat “a”, nenit 105, nenit 115, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim identifikimin e **elementeve juridikë dhe faktikë mbi përgjegjësinë disiplinore të magjistratit subjekt hetimi**

disiplinor, vlerësohet se gjatë procesit hetimor duhet të analizohen një sërë çështjesh si: (i) nëse veprimi apo mosveprimi i magjistratit subjekt hetimi disiplinor përbën shkelje disiplinore apo veprimi/mosveprimi lidhet me veprimtarinë e tij profesionale; (ii) kriteret për caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore; (iii) llojin e masës së disiplinore.

19.1. Në analizë të çështjes se nëse nga ana e magjistratit, subjekt hetimi disiplinor janë ndërmarrë veprime/mosveprime të cilat përbëjnë shkelje disiplinore apo veprimi/mosveprimi lidhet me veprimtarinë profesionale vlen të theksohet se në mbështetje të nenit 101, pika 2 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kur përcaktohet nëse veprimi apo mosveprimi e magjistratit konsiderohet shkelje disiplinore, ose është e lidhur vetëm me veprimtarinë profesionale, merren parasysh një sërë faktorësh si: (a) shkalla e pakujdesisë (fajësisë); (b) shpeshësia e kryerjes së veprimit ose mosveprimit apo sjelljes; (c) përvoja dhe pozicioni i magjistratit në sistem; (ç) dëmtimi, mundësia e shkaktimit të dëmtimit ose shkalla e pasojave që kanë ardhur ose mund të vijnë nga veprimi apo mosveprimi; si dhe (d) çdo situatë që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor ose të prokurorisë.

19.2. Nga ana tjetër, në analizë të çështjes lidhur me kriteret për caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore, vlen të theksohet se në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar nuk parashikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë se cilat shkelje disiplinore janë të lehta, të rënda apo shumë të rënda. Në përmbajtje të neneve 106-111 të ligjit nr. 96/2016 që japin përshkrimin e masave disiplinore, janë parashikuar konceptet shkeljes së lehtë, të rëndë dhe shumë të rëndë, në raport me secilën masë disiplinore. Në të njëjtën kohë neni 140, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës parashikon konceptin e shkeljeve shumë të rënda për shkarkimin e gjyqtarit nga detyra. Në këto kushte arrihet në përfundimin se për të arritur në një përfundim të qartë në lidhje me rëndësinë e shkeljes disiplinore duhet të bëhet rast pas rasti një analizë juridike dhe faktike e kriterëve për caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore, të parashikuara nga neni 115 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në raport me faktet e provuara në këtë proces hetimi disiplinor.

19.3. Në nenin 115, pika 1, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohen në mënyrë jo shteruese, si kriteret për caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore: (a) lloji dhe rrethanat e shkeljes; (b) shkalla e fajësisë dhe motivi; (c) pasojat e shkeljes; (ç) të dhënat profesionale, të çështjeve disiplinore dhe të dhëna kriminale të magjistratit; (d) masën e ndonjë rreziku të shkaktuar nga shkelja disiplinore; (dh) çdo rrethanë e rëndësishme që ka lidhje me shkeljen; (e) rrethana të lidhura me gjendjen shëndetësore të magjistratit; (ë) sjellja e magjistratit pas kryerjes së shkeljes dhe pas fillimit të hetimit; (f) sjellja e magjistratit gjatë procedimit hetimit/procedimit disiplinor dhe qëndrimin që mban ndaj tij; (g) çdo çështje tjetër që konsiderohet e rëndësishme.

19.4. Në analizë të kriterit “lloji dhe rrethanat e shkeljes” në raport me faktet e provuara gjatë hetimit disiplinor rezulton se pas një vlerësimi të hollësishëm të çdo prove veças dhe të

gjitha provave së bashku, në cilësinë e inspektoreve përgjegjës, në rastin konkret, nga ana e magjistratit subjekt hetimi disiplinor {...} janë ndërmarrë veprime/mosveprime të cilat kanë sjellë përfitim të padrejtë për palët në një proces gjyqësor në kundërshtim me ligjin, si pasojë edhe e zbatimit të gabuar të ligjit material dhe procedural, të konkretizuara këto gjatë dhënies së e vendimit nr. 13/21-2018-1692, datë 23.10.2018, për lirim me kusht të kërkuesit {...}, vendimin nr. 21-2021-1771/17, datë 21.10.2021 për lirim me kusht të kërkuesit {...}, vendimin nr. 21-2021-1574/124, datë 23.09.2021 për ulje dënimi për kërkuesin {...}, vendimin nr. 22/21-2019-2200, datë 22.11.2019 për lirim me kusht të kërkuesit {...}, vendimin nr. 06/21-2018-496, datë 27.03.2018 për lirim me kusht të kërkuesit {...}. Ndërkohë këto veprime/mosveprime parashikohen si shkelje disiplinore nga neni 102, pika 1, shkronja “dh” dhe neni 102 pika 2 shkronjat “a” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.^[8]

20. Nga hetimi disiplinor i kryer ka rezultuar se në datën 24.9.2018 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë është regjistruar kërkesa penale e të dënuarit {...} me objekt “Lirim me kusht”. Me shortin e datës 24.9.2018 çështja i ka kaluar për gjykim gjyqtarit të kësaj gjykate {...}.

20.1. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështje, me vendimin nr. 13/21-2018-1692, datë 23.10.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë nga gjyqtari {...} është vendosur pranimi i kërkesës për lirim me kusht, duke urdhëruar pezullimin e pjesës së mbetur pavuajtur prej 3 (tre) muaj e 28 (njëzet e tetë) ditë burgim, të dënimit të dhënë me vendimin nr. 394, datë 23.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, duke e vënë në provë të dënuarin {...}, për një periudhë prej 3 (tre) muaj e 28 (njëzet e tetë) ditë. 20.2. Vendimi nr. 13/21-2018-1692, datë 23.10.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, ka marrë formë të prerë në datën 7.11.2018, pa u ankimuar.

20.3. Nga aktet e përcjella nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë rezulton se shtetasi {...} është dënuar për veprën penale të “Mosdhënia e mjeteve për jetesë”, parashikuar nga neni 125 i Kodit Penal, dënuar me vendimin nr. 23-2016-898 (125), datë 03.05.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, me 100.000 lekë gjobë. Mbi ankimin e bërë nga prokurori, Gjykata e Apelit Gjirokastrë me vendimin nr. 20-2016-831/195, date 21.07.2016 ka vendosur: “*Ndryshimin e vendimit të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Sarandë duke deklaruar fajtor të pandehurin {...}, për kryerjen e kundërvajtjes penale të “Mosdhënia e mjeteve për jetesë” të parashikuar nga neni 125 i K. Penal dhe dënimin e tij me 3 (tre) muaj*

[8] Në mbështetje të nenit 101, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, magjistrati kryen shkelje disiplinore me dashje ose pakujdesi të rëndë, kur gjatë ushtrimit të funksionit nuk i referohet ligjit ose fakteve me dashje ose për shkak të pakujdesisë së rëndë, ose kur ka paaftësi të dukshme profesionale. Në të njëjtën kohë, në nenin 102, pika 1, germa “dh” dhe nenin 102 pika 2 germa “a”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se: “*Shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit janë, në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjelljet e magjistratit, si më poshtë:...[...].*... dh) veprimi, mosveprimi ose sjellja e magjistratit që sjell përfitime të padrejta ose dëme për palët në një proces gjyqësor ose procedurë hetimore, në kundërshtim me ligjin”

a) mosrespektimi i rëndë ose i përsëritur i legjislacionit procedural dhe material ose zbatimi i gabuar i legjislacionit procedural dhe material, kur konstatohet nga një gjykatë më e lartë;

burgim. Në aplikim të nenit 59 të kodit penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim duke urdhëruar vënien në provë për 18 muaj. Urdhërohet i pandehuri të mbajë kontakte me shërbimin e provës si dhe me detyrimin që të paguajë pensionin ushqimor për fëmijët”.

20.4. Vendimi është ekzekutuar me urdhrin nr. 282, datë 25.10.2016 të prokurorit Sali Hasa të Prokurorisë Sarandë. Me vendim të prokurorit Sali Hasa datë 19.02.2017 është vendosur pushimi i ekzekutimit të urdhrin të ekzekutimit nr. 282, datë 25.10.2016 në ngarkim të {...}, për shkak se përfiton nga amnistia, ku arsyetohet *“Nisur nga fakti se dënimi alternativ është vënë në ekzekutim, si dhe bazuar në ligjin nr. 141/2016, datë 22.12.2016 “Për dhënie amnistie”, neni 3, i dënuari plotëson kriteret për të përfituar nga kjo amnisti dhe për rrjedhojë ekzekutimi i mëtejshëm i këtij vendimi duhet të pushojë”.*

20.5. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve objektive të kërkuara nga neni 64 i Kodit Penal, sipas akteve rezulton se plotësohen kërkesat e nenit 477, paragrafi 1 dhe 2 të K. PR. Penale, për shqyrtimin e kërkesës nga gjykata kompetente e vendit të ekzekutimit dhe faktit të mos përsëritjes së kërkesës para se të kenë kaluar 6 muaj nga dita kur vendimi i rrëzimit të një kërkesë të mëparshme ka marrë formë të prerë, pasi kërkuesi nuk ka pasur kërkesë tjetër për lirim me kusht.

20.6. Në rastin e mësipërm jemi para aplikimit të kriterit se i dënuari duhet të ketë vuajtur jo më pak se 2/3 e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi gjer në 5 vjet burgim dhe nga gjykata është zbatuar ky kriter i parashikuar nga neni 64, paragrafi 1, i Kodit Penal. Vepra penale e dhunës në familje sipas nenit 130/a-4 të Kodit Penal parashikon një dënim nga 1 gjer në 5 vjet burgim, për të cilën kërkuesi është dënuar me 15 muaj burgim, 2/3 e të cilit llogariten në vuajtjen e një dënimi jo më pak se 10 muaj burgim.

20.7. Gjukata e ka kryer llogaritjen e vuajtjes së kohës së mësipërme të dënimit deri në ditën e shpalljes së vendimit, ku rezulton se kërkuesi kishte vuajtur 11 muaj e 2 ditë burgim dhe i mbeteshin për të vuajtur edhe 3 muaj e 28 ditë burgim. Nga kërkuesi në këtë rast plotësohej koha e vuajtjes jo më pak 2/3 e dënimit të dhënë siç e kërkon ligji, kjo edhe në datën e paraqitjes së kërkesës ku kishte vuajtur 10 muaj e 3 ditë burgim.

20.8. Lidhur me gjendjen gjyqësore të të dënuarit, në rast se i dënuari rezulton përsëritës për krime të kryera me dashje, gjykata në bazë të nenit 64, paragrafi 3 të Kodit Penal, është e detyruar të rrëzoj kërkesën, pasi ky element konsiderohet si ndalues i dhënies së lirimimit me kusht. Në rastin konkret rezultoi se i dënuari përveç dënimit për veprën penale që ishte duke vuajtur për të cilin ka kërkuar dhe lirimin me kusht ishte dënuar më parë për kundërvajtjen penale të “Mosdhënia e mjeteve për jetesë”, parashikuar nga neni 125 i Kodit Penal me vendimin e formës së prerë të Gjykatë së Apelit Gjirokastrë në datën 21.07.2016.

20.9. Dënimi i mëparshëm për kundërvajtje penale nuk përbën një kusht ndalues nga neni 64, paragrafi 3 i Kodit Penal, i cili parashikon se nuk lejohet liri me kusht për të dënuarin

përsëritës për krime të kryera me dashje. Megjithatë, sipas Vendimit Unifikues nr. 2, datë 25.05.2015, në rastet e tjera, hetimi mbi gjendjen gjyqësore të të dënuarit duhet të vlerësohet në perspektivën e rrezikut të recidivizmit të tij.

20.10. Në vlerësimin e arsyeve të veçanta, gjykata i referohet Vendimit Unifikues nr. 2, datë 25.05.2015, duke marrë për bazë raportet e vlerësimit të {...} dhe Zyrës së Shërbimit të Provës, të cilat kanë qenë pozitive dhe në favor të kërkesës për lirim me kusht, si dhe të disa rrethanave familjare të kërkuarit të vlerësuara në favor të zbatimit të lirit me kusht.

20.11. Në Vendimin Unifikues Nr. 2, datë 25.05.2015, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, janë analizuar dhe janë dhënë sqarime të hollësishme në kuptimin dhe zbatimin në praktikë të shprehjes "arsye të veçanta" të parashikuara nga neni 64 i Kodit Penal, ku merren parasysh: Natyra e veprave penale të kryera; qëndrimi i personit të dënuar ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjareve të viktimës; gjendja fizike apo psikologjike e personit të dënuar; dinamika e sjelljes së të dënuarit në I.E.V.P; kushtet familjare dhe prejardhjen shoqërore të të dënuarit.

20.12. Kolegjet e Bashkuara kanë vlerësuar se gjykata duhet të ndjekë disa etapa të nevojshme në gjykimin me objekt lirim me kusht. Në zbatim të orientimeve të Vendimit Unifikues nr. 2/2015 të Kolegjeve të Bashkuara pika 33, natyra e veprës penale të kryer është një nga elementët më të rëndësishëm që duhet të merret parasysh nga ana e gjykatës në shqyrtimin e kërkesës për lirim me kusht. Gjithashtu, edhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, duhet të mbahen në konsideratë. Sa më e lartë të jetë rrezikshmëria shoqërore e veprës penale të kryer, aq më i thellë duhet të jetë hetimi gjyqësor në lidhje me riedukimin e të dënuarit. Një vepër penale e kryer në bashkëpunim, me paramendim, apo me dhunë tregon për një shkallë të lartë rrezikshmërie të të dënuarit, çka duhet të shtyjë gjykatën për të qenë veçanërisht e kujdesshme në pranimin e kërkesës për lirim me kusht. Në këto raste, gjykata duhet të jetë pothuajse plotësisht e bindur, nëpërmjet fakteve dhe rrethanave konkrete, se i dënuari nuk do të jetë burim rreziku për shoqërinë nëse lirohet.

20.13. Kërkuari ka qenë i dënuar për veprën penale të dhunës në familje, e cila si në kohën e dënimit dhe aktualisht paraqet një vepër penale që ka një përhapje të gjerë në shoqëri dhe me rrezikshmëri të lartë shoqërore, në drejtim të pasojave më të rënda që vijnë prej këtyre autorëve, megjithëse të dënuarit i kishin mbetur për të vuajtur edhe 3 muaj e 28 ditë burgim nga dënimi i dhënë, pra një kohë që nuk përbën një dënim të konsiderueshëm të mbetur. Nga dosja e gjyqësore e dënimit për veprën penale të dhunës në familje rezulton se kërkuari nuk e ka pranuar veprën penale, duke pretenduar pafajësi.

20.14. Gjykata vlerëson dhe qëndrimin e të dënuarit ndaj veprës penale, viktimës apo familjes së viktimës. Sipas raportit të {...} i dënuari e pranon veprën penale, por nuk shprehet për pendesë, çfarë do të thotë se ai nuk është riedukuar, ndërsa përsa i përket normalizimit të marrëdhënieve me viktimën, në këtë rast nuk rezulton të ketë ndodhur edhe pse në zbatim të nenit 31/6 të ligjit nr. 10024, datë 27.11.2008 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", i

ndryshuar, ashtu dhe të vendimit unifikues nr. 2/2015, as raporti vlerësues i Shërbimit të Provës, dhe as vlerësimi i sjelljes nga {...} Durrës, nuk pasqyron informacion për të konfirmuar marrëdhëniet e kërkuarit me viktimën ose me familjarët e viktimës. Gjykata duhet natyrisht ta marrë parasysh si element në favor të kërkuarit, ndërsa në vetvete normalizimi i marrëdhënieve nuk është kusht i domosdoshëm për pranimin e kërkesës për lirim me kusht.

20.15. Vendimi nr. 13/21-2018-1692, datë 23.10.2018 i dhënë nga magjistrati {...} ka sjellë përfitim të padrejtë për të dënuarin {...} me lirim të tij me kusht, i cili nuk ka plotësuar në mënyrë kumulative kushtet objektive dhe subjektive për të përfituar. Edhe pse ka plotësuar kushtet objektive të lirimit me kusht, nuk rezulton që me dënimin e vuajtur ishte arritur qëllimi për edukimin dhe integrimin e tij, të cilat duhet të vlerësoheshin nga gjykata si rrethana negative të lirimit me kusht, si fakti i dënimit të tij me parë për një veprë penale në vazhdim të asaj të dhunës në familje, natyra e veprës penale të kryer, mospendimi për veprën penale, mosnormalizimin e marrëdhënieve me viktimën e veprës penale, çfarë rrit rrezikun e mosarritjes së mundësisë për rintegrim të tij në shoqëri dhe recidivizmit të tij për këtë veprë penale. Në bazë të rrethanave të mësipërme vuajtja e dënimit të mbetur *do te kishte ndikim me pozitiv në shoqëri dhe tek personi i dhunuar.*

20.16. Kolegjet e Bashkuara në lidhje me arsyet e veçanta që përlligjin lirim me kusht, kanë mbajtur këtë qëndrim unifikues: *“Ligjvënësi duke përdorur shprehjen “arsye të veçanta” ka bërë një vlerësim të përgjithshëm, pa i nominuar ato e duke e lënë në vlerësim të gjykatës sipas rrethanave konkrete që i paraqiten. Megjithatë, këto “arsye të veçanta” nuk janë të pavarura dhe duhet të jenë të lidhura ngushtë me qëllimin e institutit të lirimit para kohe me kusht i cili ka të bëjë me riedukimin dhe riintegrimin në shoqëri të të dënuarit. Arsyet e veçanta nuk janë gjë tjetër veçse rrethana konkrete, të cilat provojnë se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi për edukimin dhe i dënuari është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri. Ky interpretim i paragrafit të parë të nenit 64 të Kodit Penal të çon në konkluzionin logjik se kemi të bëjmë me një kusht të vetëm dhe “arsyet e veçanta” nuk janë gjë tjetër veçse fakte të cilat provojnë se me pjesën e dënimit të vuajtur është arritur qëllimi i dënimit penal në rastin konkret për edukimin e të dënuarit dhe ai është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri.”*

20.17. Fakti i pretenduar nga magjistrati {...} në parashtrimet e tij dënimi i mëparshëm i shtetasit {...} nuk ishte i pasqyruar në vërtetimin e gjendjes gjyqësore, ku rezulton i padënuar, si dhe *verifikimi i faktit të mësipërm, të dënimit penal të kërkuarit {...} nuk është konstatuar në gjykim dhe nuk i është nënshtruar debatit gjyqësor*, rezulton se në dosjen e kërkesës për lirim me kusht gjendet edhe vendimi gjyqësor për të cilin kërkohet lirim me kusht, vendimi me nr. 394, datë 23.12.2016 i dënimit të këtij shtetasi për veprën penale të “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/4 i K. Penal, ku pasqyrohet edhe gjendja gjyqësore e tij si i dënuar më parë, për kryerjen e veprës penale të “Mosdhënia e mjeteve për jetesë”, parashikuar nga neni 125 i Kodit Penal. Në këtë mënyrë nga gjykata nuk është kryer hetim gjyqësor mbi gjendjen gjyqësore të të dënuarit, për tu vlerësuar në perspektivën e rrezikut të recidivizmit të tij.

20.18. Në bazë të vërtetimit të gjendjes gjyqësore nr. 17, datë 20.8.2018 që gjendet në dosjen e lirimimit me kusht rezulton se {...} është i padënuar, ndërkohë që përfundimi i dënimit të tij për veprën penale të “Mosdhënia e mjeteve për jetesë”, konsiderohet data 19.2.2017 kur ka dalë urdhri i prokurorit për pushimin e ekzekutimit të dënimit për shkak të amnistisë. Pra, shtetasi {...} do të rezultonte i padënuar, pasi të kishte kaluar dhe periudha e rehabilitimit prej 2 vitesh nga data 19.2.2017, që do të thotë pas datës 19.2.2019.

21. I dënuari {...} ka paraqitur kërkesë për lirim me kusht, e cila është regjistruar në datën 28.01.2021 dhe në këtë datë i është shortuar gjyqtarit {...}. Në kërkesën për lirim me kusht të datës 28.01.2021 shtetasi {...} ka pretenduar lirimin me kusht, duke qenë se ka kryer dënimin e parashikuar nga ligji si prag për kërkimin e lirimimit para kohe me kusht, si dhe duke qenë se vuajtja e dënimit ja ka arritur qëllimit të dënimit, se gjatë kohës së qëndrimit në {...} ndaj tij nuk ka masa disiplinore.

21.1. Shtetasi {...} ka hequr dorë nga kërkesa gjatë seancës së datës 30.03.2021 me arsyetimin: *“për ta ngritur këtë kërkim në një moment tjetër, që ai ta çmojë si më të përshtatshëm”*. Me vendimin nr. 21-2020-627/6, datë 30.03.2021, gjyqtari {...}, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes penale nr. 6, datë 28.01.2021, me kërkues {...}, me objekt: “Lirim me kusht”. Vendimi ka marrë formë të prerë në datën 14.04.2021 pa u ankimuar.

21.2. Nga këto akte rezulton se megjithëse shtetasi {...} ka depozituar kërkesën e parë për lirim me kusht në datën 28.1.2021, duke pretenduar plotësimin e kohës së vuajtjes së dënimit, ai në këtë datë, por edhe në datën që ka hequr dorë nga kërkesa 30.3.2021 dhe është marrë vendimi i pushimit 20.3.2021 nga gjyqtari {...}, ai nuk kishte vuajtur $\frac{3}{4}$ e dënimit prej 5 vjet burgim. Në datën 30.3.2021 ai kishte vuajtur 3 vjet 2 muaj e 29 ditë, ndërkohë që duhet të kishte vuajtur jo më pak se 3 vjet e 9 muaj burgim, pra i duheshin edhe 6 muaj e 1 ditë burgim. Në këto kushte kërkuesi për këto arsye duhet të hiqte dorë nga kërkesa.

21.3. Shtetasi {...} ka paraqitur kërkesë për ulje dënimi, e cila është regjistruar me nr. Regj. Them 124/80001-00723-21-2021, datë regj. 13.09.2021, një ditë pasi ishin plotësuar 12 muaj nga dita që vendimi i dënimit ka marrë formë të prerë datë 10.9.2020, ndërsa vendimi i uljes nr. 21-2021-1574/124, datë 23.09.2021, i gjyqtarit {...} është shpallur brenda 10 ditëve nga kërkesa për ulje të dënimit, duke përfutur maksimumin e uljes prej 90 ditë, të parashikuar nga neni 75 të ligjit nr. 81/2020 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, për periudhën e vuajtjes së dënimit, nga data 11.09.2020 deri në datën 12.09.2021. Vendimi ka marrë formë të prerë pa ankim në datën 08.10.2021.

21.4. Nga përmbajtja e vendimit të uljes së dënimit nuk kuptohen provat e shqyrtuara, nuk rezulton se bazohet në një raport vlerësimi sipas parashikimit të nenit 75 të ligjit nr. 81/2020 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, por në vlerësimet sjellje edhe këto të pa identifikuar me numër, datë të {...}-së, shprehet pretendimi i të dënuarit se *“I dënuari {...}, kërkon të shpërblehet me ulje dënimi 90 ditë burgim, pasi pretendon se plotëson kriteret ligjore që parashikon neni 63 i ligjit të posaçëm”*).

21.5. Në vendimin e gjykatës si ligji i zbatueshëm citohen nenet 480 të K. Pr. Penale dhe 75 të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ndërsa analiza e vendimit për plotësimin e kriterëve ligjore të tilla si “të zbatojë rregulloren e burgut”, “të ketë pjesëmarrje shembullore në veprimtari trajnuese”, “të japë prova për riintegrim në shoqëri”, “**vlerësimi i sjelljes për 12 muajt e fundit të vuajtjes së dënimit**”, (kjo e fundit parashikohet njësoj edhe në nenin 5 të ligjit nr. 81/2020) vihet re se i referohet nenit 63 të ligjit Nr. 8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” të shfuqizuar me ligjin e ri nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”. Në përfundim gjykata e bazon vendimin në nenin 480 të K. Pr. Penale dhe nenin 63 të ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 të shfuqizuar.

21.6. Ligji Nr. 8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” të shfuqizuar me ligjin nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” parashikonte:

Neni 63

Ulja e dënimit

(Ndryshuar paragrafi i fundit me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)

Të dënuarit që zbatojnë rregullat dhe kanë një pjesëmarrje shembullore në veprimtari të trajtuese, duke dhënë prova për riintegrim në shoqëri, mund të përfitojnë një ose disa ulje, deri 90 ditë në çdo vit të vuajtjes së dënimit. Në burgjet e sigurisë së lartë ulja e dënimit bëhet deri 45 ditë në vit.

Për dhënien e këtij shpërblimi të veçantë, vlerësohet qëndrimi i të dënuarit nga ulja e mëparshme ose gjatë 12 muajve të fundit.

Ulja e dënimit bëhet me vendim të gjykatës, në bazë të kërkesë së të dënuarit apo përfaqësuesit të tij, ose të drejtorit të institucioni.

Ligji nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, parashikon:

Neni 75

Ulja e dënimit

*1. I dënuari që zbaton rregullat e brendshme të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale dhe ka një sjellje të mirë duke e treguar me pjesëmarrje aktive dhe pozitive në veprimtari të rehabilituese dhe riintegruese gjatë kryerjes së dënimit, **bazuar në raportin e vlerësimit, që përgatitet nga institucioni**, mund të përfitojë ulje dënimi deri 90 ditë në çdo vit të kryerjes së dënimit. Në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së lartë ulja e dënimit bëhet deri 45 ditë në vit.*

2. Ulja e dënimit për të dënuarit që plotësojnë kriteret e këtij neni, fillon jo më parë se 12 muaj nga fillimi i kryerjes së dënimit me burgim, në zbatim të vendimit gjyqësor penal të formës së prerë.

3. Ulje dënimi nuk mund të jepet pa kaluar të paktën 12 muaj nga ulja e fundit e përfituar.

4. Për dhënien e këtij shpërblimi të veçantë vlerësohet qëndrimi i të dënuarit nga ulja e mëparshme ose gjatë 12 muajve të fundit.

5. Ulja e dënimit bëhet me vendim të gjykatës, në bazë të kërkesës së të dënuarit, ose të përfaqësuesit të tij, ose të drejtorit të institucionit.

6. Rregullat e detajuara për kriteret, procedurën dhe formatin e raportit të vlerësimit, sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohen me urdhër të ministrit të Drejtësisë, me propozim të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

21.7. Në rastin konkret ligji i zbatueshëm për gjykatën ishte neni 75 i ligjit Nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve “. Sipas VKM nr.303 datë 25.03.2009 “Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve”, neni 43, 1. “Personeli i {...} çdo 6 muaj duhet të plotësojnë vlerësimin e sjelljes për çdo të burgosur që administrohet në dosjen psiko-sociale të tij. 2. Për seancat gjyqësore me objekt ulje dënimi, pasqyrohen në vlerësimin e sjelljes së të burgosurit, të gjitha masat disiplinore të dhëna ndaj të burgosurit për vitin e fundit të vuajtjes së dënimit. 3. Për seancat gjyqësore me objekt lirim me kusht, pasqyrohen në vlerësimin e sjelljes të gjitha masat disiplinore të dhëna ndaj të burgosurit gjatë 3 vjetëve të fundit të vuajtjes së dënimit”.

21.8. Vendimi i uljes së dënimit me 90 ditë, rezulton se është dhënë pa një raport vlerësimi nga {...} për të përfituar maksimumin për kërkuesin sipas nenit 75 të ligjit nr. 81/2020 dhe rregullores së përgjithshme të burgjeve nr.303, datë 25.3.2009, pasi i vetmi vlerësim në këtë periudhë pas vendimit të dënimit të formës së prerë është ai i periudhës si i paraburgosur 27.07.2020-27.01.2021. Nga gjykata është arsyetuar mbi një dispozitë të shfuqizuar për të përfituar në mënyrë të padrejtë këtë lloj ulje.

21.9. Megjithatë para se të depozitohet kërkesa për ulje dënimi e shtetasit {...} në datën 13.9.2021 (pasi ende nuk ishte plotësuar periudha 1 vjeçare e vuajtjes nga vendimi i dënimit të formës së prerë), shtetasi {...} ka paraqitur përsëri në datën 1.9.2021 kërkesën në bazë të nenit 64 të Kodit Penal dhe 477 të K. Pr. Penale për lirim me kusht, me pretendimin se ka plotësuar kërkesat dhe kriteret që përmban ligji, duke vuajtur masën e dënimit të kërkuar dhe me qëndrimin në institucion ka arritur rehabilitimin e plotë. Kërkesa mban shënimin me shkrim sikur është marrë në dorëzim në datën 2.9.2021 (postuar në datën 01.09.2021), ndërkohë që në gjykatë është hedhur në short në datën 13.09.2021.

21.10. Kërkesa e shtetasit {...} për lirimin me kusht, është regjistruar me nr.17/80103-00700-21-2021 Akti, datë 13.09.2021, pra, në të njëjtën datë me kërkesën për ulje dënimi regjistruar me nr. 124/80001-00723-21-2021, datë 13.09.2021, shortuar të dyja pranë gjyqtarit {...}, duke u gjykuar paralelisht nga gjyqtari {...}.

21.11. Shtetasi {...} ka paraqitur kërkesë për ulje dënimi në të njëjtën datë, pasi në datën e paraqitjes së kërkesës për lirim me kusht 13.9.2021 ende nuk ishte plotësuar koha e nevojshme e dënimit prej $\frac{3}{4}$ prej 3 vjet e 9 muaj (vetëm 3 vjet 8 muaj 12 dite). Po në datë 13.09.2021, me vendimin “Për caktimin e seancës për gjykimin çështjes penale”, gjyqtari {...} ka caktuar seancën gjyqësore të lirimimit me kusht për në datë 27.09.2021, ora 10:30 dhe ndërkohë para kësaj seance ka përfunduar menjëherë gjykimin e uljes së dënimit me 90 ditë në datën 23.9.2021 (për 10 ditë), që do të thotë se në çdo rast tashmë shtetasi {...} para seancës së lirimimit me kusht e kishte te plotësuar kohën e vuajtjes së dënimit (pasi në datën 27.9.2021 ende nuk e plotësonte këtë kohë).

21.12. Me vendimin nr. 21-2021-1771/17, datë 21.10.2021, gjyqtari {...} ka vendosur lirimim me kusht të të dënuarit {...}, duke urdhëruar pezullimin e pjesës së mbetur pavuajtur prej 1 (një) vit e 21 (njëzet e një) ditë burgim, të dënimit të dhënë me vendimin nr. 23-2020-506/98, datë 21.04.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, duke e vënë në provë të dënuarin {...} për një periudhë prej një (1) vit e 21 (njëzet e një) ditësh.

21.13. Në vendimin e lirimimit me kusht gjykata ka evidentuar se me vendimin nr. 23-2020-506/98, datë 21.04.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, kërkuesi {...} është dënuar me 5 (pesë) vjet burgim, për veprën penale të parashikuar nga neni 283/2 i K. Penal. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë me vendimin nr. 36, datë 10.09.2020. Kërkuesi është arrestuar në datën 24.11.2018 dhe deri në ditën e dhënies së këtij vendimi, i kanë mbetur pa vuajtur 1 vit e 21 ditë burgim. Në këto kushte, kërkuesi plotëson kriterin e vuajtjes së 2/3-tës së dënimit të dhënë nga gjykata.

21.14. Në këtë rast rezulton se nuk është zbatuar drejt kriteri me 2/3-tat i vuajtjes së dënimit, pasi në rastin konkret aplikohet kriteri me 3/4 e llogaritjes së dënimit të vuajtur, pra kërkuesi duhet të ketë vuajtur jo më pak se $\frac{3}{4}$ e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi mbi 5 vjet deri në maksimumin e parashikuar nga ligji. Vepra penale për të cilën kërkuesi është dënuar me 5 vjet burgim dënohet sipas nenit 283/2 të Kodit Penal nga 7 gjer në 15 vjet burgim e në këtë rast duhet që kërkuesi të ketë vuajtur 3 vjet e 9 muaj burgim të dënimit të dhënë. Me aplikimin e dispozitës në 2/3 e dënimit të dhënë prej 5 vjetësh ulet koha e vuajtjes së dënimit sipas të cilës kërkuesi duhet të ketë vuajtur 3 vjet e 4 muaj.

21.15. Në vendimin e gjykatës nuk rezulton të jenë kryer përllogaritje të tilla, duke u shprehur vetëm për kohën e mbetur pa vuajtur në ditën e dhënies së vendimit prej 1 vit e 21 ditë burgim. Për këtë gjykata është bazuar në dinamikën e vuajtjes së dënimit, dërguar gjyqtarit {...} me shkresën nr. 841 prot., datë 22.09.2021 të {...}-Tepelenë, sipas të cilës rezulton se shtetasi {...} është dënuar me 5 vjet, fituar me paraburgim 10 muaj e 23 ditë, fituar me punë 1 muaj e 18 ditë dhe deri në datën 22.09.2021 ka vuajtur 3 (tre) vite e 10 (dhjetë) muaj e 10 (dhjetë) ditë, ndërkohë që mbetet për të vuajtur 1 (një) vit e 1 (një) muaj e 20 (njëzet) ditë.

21.16. Referuar urdhërit të ekzekutimit të prokurorit sipas të cilit deri në datën 20.10.2020 kërkuesi ka vuajtur 2 vjet e 9 muaj e 20.5 ditë, nga llogaritja deri në ditën e vendimit të lirimit me kusht datë 21.10.2021, rezulton se kërkuesi ka vuajtur 3 vjet e 9 muaj e 21.5 ditë burgim (pa kohën e fituar me punë prej 1 muaj e 18 ditë), dhe i mbeten për të vuajtur 1 vit e 2 muaj e 8.5 ditë, që do të thotë se ai e ka plotësuar kohën e vuajtjes së dënimit prej $\frac{3}{4}$ të dënimit të dhënë.

21.17. Nga vendimi nuk rezulton që të jetë llogaritur dhe koha e fituar me uljen e dënimit prej 90 ditësh të dhënë po nga gjyqtari {...}.

21.18. Në vlerësimin e “arsyeve të veçanta” në funksion të edukimit dhe riintegriimit të kërkuesit në shoqëri, gjykata mban në konsideratë raportet e vlerësimit të kryera nga {...} Tepelenë dhe Shërbimi i Provës Zyra Vendore Gjirokastër, të cilët kanë vlerësuar pozitivisht sjelljen e kërkuesit në {...} gjatë kohës së dënimit, si dhe mundësinë për rehabilitim dhe risocializim në shoqëri (për më tepër shih raportet e vlerësimit të {...} dhe Shërbimit të Provës), raporte të cilat nuk janë cituar në vendim dhe as konkluzionet e tyre.

21.19. Por, sipas vlerësimeve periodike 6 mujore të {...} Tepelene kërkuesi gjatë gjithë qëndrimit në {...} nuk e ka pranuar veprën penale, ka pasur masë disiplinore, ndërsa në vlerësimin e sjelljes që është paraqitur në gjykatë me nr. 164, datë 7.10.2021, kërkuesi është vlerësuar nga institucioni i vuajtjes së dënimit negativisht dhe me qëndrim për rrëzimin e kërkesës, duke e konsideruar përsëritës. Gjithashtu, nga shërbimi i provës me raportin nr. 292, datë 11.10.2021 konkludohet se nuk për të dënuarin {...} nuk është arritur *qëllimi për riedukimin dhe rehabilitimin e tij*, duke e lenë në çmim të gjykatës, duke u shprehur se mundësia për t’u integruar në familje e shoqëri është një mundësi normale e vështirë, por edhe e mundshme.

21.20. Në të tilla kushte për kërkuesin {...} nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për përfitimin prej tij të lirimit me kusht. Përsa i përket çështjes së rehabilitimit, pasi ky shtetas ka qene me parë i dënuar për një krim me dashje, mbetet një çështje e diskutueshme në praktikën gjyqësore nëse personi i rehabilitur për efekt të nenit 64 të Kodit Penal do të konsiderohet përsëritës ose jo.

22. Me vendimin nr. 22/21-2019-2200, datë 22.11.2019 me kërkues {...}, gjyqtari {...}, ka vendosur pranimin e kërkesës së të dënuarit për lirimin me kusht, duke e vënë atë në provë për kohën e mbetur të dënimit për një periudhë prej 4 muajsh e 8 ditë. Vendimi ka marrë formë të prerë në datë 10.12.2019 pa u ankimuar nga palët.

22.1. Gjykata konstaton se kërkuesi me vendimin nr. 93, datë 14.04.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër është dënuar me 7 vjet e 6 burgim, për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikeve”, parashikuar nga neni 283/1 i K. Penal. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr. 117, datë 28.05.2014. Kërkuesi është ndaluar në datën 15.02.2014 dhe deri në ditën e dhënies së këtij vendimi, i kanë mbetur pa

vuajtur 4 muaj e 8 ditë burgim. Në këto kushte, kërkuesi plotëson kriterin e vuajtjes së 2/3-tës së dënimit të dhënë nga gjykata.

22.2. Ndërkohë sipas dinamikës së vuajtjes së dënimit të përpiluar nga {...} Tepelenë rezulton se, deri në datën e dhënies së vendimit, kërkuesit i mbeteshin për të vuajtur 4 muaj e 8 ditë burgim.

22.3. Në citimin e dispozitës së nenit 64 të Kodit Penal, Gjykata i referohet kriterit $\frac{3}{4}$ të kohës së vuajtjes së dënimit dhe më pas vijon se kërkuesi plotëson kriterin e vuajtjes së 2/3 të dënimit të dhënë. Bazuar në 2/3 kërkuesi duhet të ketë vuajtur 5 vjet burgim, ndërkohë që kriteri që duhet të aplikohet është ai i llogaritjes me $\frac{3}{4}$ pasi vepra penale për të cilën është dënuar parashikon dënim nga 5-10 vjet burgim, dhe për rrjedhojë rezulton se $\frac{3}{4}$ e 7 vjet e 6 muaj duhet që kërkuesi të ketë vuajtur 5 vjet e 7 muaj e 15 dite. Deri në datën e vendimit 22.11.2019 rezulton se kërkuesit i mbeten për të vuajtur 1 vit e 7 muaj e 1 ditë burgim dhe jo 4 muaj e 8 ditë burgim.

22.4. Sipas vendimit të gjykatës, kërkuesi është ndaluar në datën 15.02.2014 dhe deri në ditën e dhënies së këtij vendimi, i kane mbetur pa vuajtur 4 muaj e 8 ditë burgim. Nga gjykata nuk ka një përlllogaritje të kohës së vuajtjes së dënimit, por vetëm të kohës së mbetur prej 4 muaj e 8 ditë burgim deri në ditën e dhënies së vendimit të lirimit me kusht. Nga të dhënat që jepen në vendim do të rezultonte se data 15.2.2014 që është dita e ndalimit të kërkuesit deri në datën e vendimit të lirimit me kusht 22.11.2019 kërkuesi ka vuajtur 5 vjet e 10 muaj e 29 ditë dhe i mbeten për të vuajtur 1 vit e 7 muaj e 1 ditë. Në vendim nuk përmenden konkretisht konkluzionet e raporteve të {...} dhe Shërbimit të Provës.

23. Me vendimin nr. 06/21-2018-496, datë 27.03.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me kërkues {...}, me anë të të cilit është vendosur rrëzimi i kërkesës së të dënuarit për lirim me kusht.

23.1. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim, kërkuesi {...}, duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe pranimin e kërkesës. Pasi ka shqyrtuar shkaqet e ankimit, Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin e saj nr. 20-2018-396/45, datë 03.05.2018 ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. 06/21-2018-496, datë 27.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër dhe pranimin e kërkesës së të dënuarit M. Sh dhe lirimin para kohe me kusht për një kohë prove prej 6 muajsh, 22 ditë të të dënuarit”, duke konstatuar shkeljen e ligjit procedural penal, duke arsyetuar ndër të tjera se:

“Arsyetimi i përdorur nga gjykata e faktit se “mosparaqitja e asnjë prove për të provuar kushtin procedural të mospasjes së një kërkesë të rrezuar, jo me afër se 6 muaj paraqitja e kërkesës për gjykim përbën shkak procedural për rrëzimin e kërkesës” vjen në kundërshtim dhe në keqinterpretim të kërkesave procedurale që kërkon neni 477 i K.Pr.Penale. Fakti që prej të dënuarit, nuk është paraqitur ndonjë kërkesë e mëparshme para shqyrtimit të kësaj kërkesë për lirim me kusht kjo gjykate vlerëson se nga ana e kërkuesit plotësohen kushtet dhe kriteret që përcakton neni 477 i K.Pr. Penale. Kërkesa e paraqitur nga kërkuesi plotëson

kriteret ligjore qe parashikon dispozita materiale, neni 64 i K.Penal, qe ne mënyrë kumulative kërkon; a) te ketë kryer jo me pak $\frac{3}{4}$ e dënimit te dhënë b) te mos jete përsëritës për krime te kryera me dashje, si dhe te mos jete dënuar për veprat penale te parashikuara nga nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c dhe Neni 100/3 te K. Penal c) ekzistencën e arsyeve te veçanta nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi për edukimin e tij”.

24. Për sa i përket vendimeve te pranimit të kërkesave për lirim me kusht me kërkues {...}, {...}, {...}, {...} dhe në vendimet e rrëzimit të kërkesave të kërkuesve {...}, {...}, {...}, përsa janë paraqitur rrethanat e tyre në pjesën e konstatimit të fakteve nuk janë evidentuar problematika të interpretimit të gabuar të ligjit material dhe procedural dhe përfitimit ose refuzimit të padrejtë të lirit me kusht.

25. Neni 102, pika 1, shkronja “dh” e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *“Shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit janë, në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjelljet e magjistratit, si më poshtë:....[...]...dh) veprimi, mosveprimi ose sjellja e magjistratit që sjell përfitime të padrejta për palët në një proces gjyqësor në kundërshtim me ligjin”.* Ndërsa, neni 102, pika 2 shkronja “a” parashikon se a) *mosrespektimi i rëndë ose i përsëritur i legjislacionit procedural dhe material ose zbatimi i gabuar i legjislacionit procedural dhe material, kur konstatohet nga një gjykatë më e lartë.* Në këto kushte, provohet se shkelja disiplinore e parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “dh” e ligjit nr. 96/2016 është kryer nga magjistrati {...} në dhënien e vendimit nr. 13/21-2018-1692, datë 23.10.2018, për lirim me kusht të kërkuesit {...}, vendimin nr. 21-2021-1771/17, datë 21.10.2021 për lirim me kusht të kërkuesit {...}, vendimin nr. 21-2021-1574/124, datë 23.09.2021 për ulje dënimi për kërkuesin {...}, vendimin nr. 22/21-2019-2200, datë 22.11.2019 për lirim me kusht të kërkuesit {...} dhe në rastin e kërkuesit {...} është konstatuar dhe nga gjykata më e lartë shkelja e ligjit procedural penal.

26. Nga ana tjetër fakti që vendimet janë të formës së prerë nuk përbën shkak për mungesën e shkeljes disiplinore apo për mbylljen e hetimit disiplinor. Me anë të dhënies së këtij vendimi magjistrati në kundërshtim me parashikimet e nenit 64 të Kodit penal, nenit 75 të ligjit nr. 81/2020 i ndryshuar, ka sjellë një përfitim të padrejtë për kërkuesin {...}, {...}, {...}, uljen e dënimit për kërkuesin {...}.

27. Në analizë të kriterit **“shkalla e fajësisë dhe motivi”** në raport me faktet e provuara në këtë proces hetimi disiplinor parapakisht vlerësohet se faji si element i domosdoshëm i përgjegjësisë disiplinore përmban në vetvete dy momente: atë intelektual dhe atë që lidhet me vullnetin. Momenti intelektual tregon nëse magjistrati subjekt i hetimit disiplinor nga pikëpamja e ndërgjegjes ka qenë në gjendje të kuptonte nëse veprimi/mosveprimi përbën në vetvete shkelje disiplinore, të parashikonte ose jo ardhjen e pasojave, kurse momenti që është i lidhur me vullnetin tregon nëse ai dëshiron ose jo për të kryer një veprim që përbën në vetvete shkelje disiplinore dhe nëse dëshironte ardhjen e pasojës. Në varësi nga karakteri i

këtyre dy momenteve, intelektual dhe volutiv, është e mundur të bëhet dallimi i dy formave të fajësisë, të dashjes e të pakujdesisë. Shkalla më e lartë e elementit volitiv është dashja e drejtpërdrejtë, në të cilin magjistrati ka vetëdije të plotë të realitetit faktik, duke e reflektuar dhe e vënë atë në qendër të analizës psikologjike. Shkalla më e ulët e elementit volitiv është pakujdesia, në të cilën magjistrati, ndonëse nuk ka vetëdije të plotë të elementit faktik, për rrethanat e faktit dhe cilësitë e tjera të tij, ai duhet dhe mund të kishte qenë i ndërgjegjshëm, domethënë në gjendje për të parashikuar realitetin faktik dhe pasojat e sjelljes së tij.

28. *Faji* si një element i përgjegjësisë disiplinore duke qenë se ka të bëjë me qëndrimin subjektiv të magjistratit ndaj kryerjes së shkeljes disiplinore dhe pasojave të ardhura në lidhje me këtë shkelje disiplinore, nuk mund të provohet në mënyrë të drejtpërdrejtë me prova dokumentare. Për të përcaktuar praninë (*ekzistencën*) dhe formën (*shkallën*) e fajit duhet të analizohen rast pas rasti rrethanat të cilat kanë të bëjnë me kryerjen e shkeljes disiplinore.

29. Për këtë qëllim, në kuadër të kësaj procedure hetimore krahas provave të cilat pasqyrojnë fakte apo rrethana mbi kryerjen e shkeljeve disiplinore të analizuara më lart, janë administruar edhe prova të cilat pasqyrojnë fakte apo rrethana mbi të dhënat profesionale, të çështjeve disiplinore apo kriminale të magjistratit. Gjithashtu në analizë të vendimeve të tjera të magjistratit ku janë zbatuar kushtet kumulative të nenit 64 të kodit penal, çojnë në përfundimin se shkelja disiplinore e parashikuar nga neni 102, pika 1, gërma “dh” dhe neni 102, pika 2, shkronja “a” e konsumuar prej tij në vendimarrjet e analizuara më sipër në Raport, është kryer me dashje dhe me qëllimin përfitimin e padrejtë të lirimit me kusht dhe uljes së dënimit.

30. Në analizë të të dhënave profesionale, të çështjeve disiplinore apo kriminale të magjistratit, nga aktet e përcjella nga KLGJ rezulton se magjistrati {...} është emëruar gjyqtar me dekretin nr. 9244, datë 25.9.2015 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Sipas procesverbalit datë 10.1.2019 përzgjidhet në pozicionin e zv/kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Me vendimin nr. 225, datë 20.6.2022 caktohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor sipas skemës së delegimit për të gjykuar çështje në Gjykatën e Apelit Gjyqësor deri në datën 20.6.2023 dhe me vendimin nr.49, datë 27.1.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor përfundon para afatit shërbimi në skemën e delegimit.

30.1. Lidhur me vlerësimin profesional të magjistratit, nga aktet e përcjella nga KLGJ, rezulton se gjyqtari {...} nuk ka vlerësim etiko profesional”.

30.2. Nga sa më sipër, rezulton se magjistrati ka një përvojë të mjaftueshme në sistemin gjyqësor prej 8 vitesh, e cila tregon se veprimet/mosveprimet e magjistratit subjekt hetimi disiplinor përbëjnë shkelje disiplinore dhe nuk lidhen me veprimtarinë e tij profesionale dhe që mund të jenë të rëndësishme vetëm me qëllim vlerësimin etik dhe profesional të saj.

31. Nga analiza ligjore e fakteve të konstatuara gjatë hetimit disiplinor rezulton se veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e magjistratit në çështjet objekt hetimi, nuk janë kryer në kuadër të paaftësisë së tij profesionale, por si rezultat i një veprimi të drejtpërdrejtë dhe të vullnetshëm nga ana e tij.

32. Për sa më sipër, në analizë të rrethanave të kryerjes së shkeljes disiplinore rezulton se: (i) nga ana e magjistratit subjekt hetimi disiplinor janë ndërmarrë veprime/mosveprime të cilat kanë të bëjnë me mosrespektim të nenit 64 të Kodit Penal, 477 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe nenit 75 të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve” i ndryshuar (ii) nuk janë marrë prova vendimtare për zgjidhjen e çështjes duke shfaqur njëanshmëri në gjykimin e çështjes të reflektuar në dhënien e vendimit për kërkuesin {...}i{...}, {...}, {...}, me qëllim përfitimin e padrejtë (iii) nuk janë respektuar dispozitat ligjore me karakter urdhërues, të cilat parashikojnë kritere me karakter objektiv dhe subjektiv për të përfituar në mënyre të drejtë lirimin me kusht dhe lehtësisht të kuptueshme për uljen e dënimit, ku përvoja e gjatë profesionale në detyrë e magjistratit e lejon të interpretojë dhe zbatojë drejt këto dispozita; Këto veprime/mosveprime të tij janë kryer në mënyrë drejtpërdrejtë, të vullnetshme. Në këto kushte, arrihet në konkluzionin se shkeljet disiplinore janë kryer nga ana e magjistratit me “dashje direkte”.

33. Në analizë të kriterit “**pasojat e shkeljes**” në raport me faktet e provuara në këtë proces hetimi disiplinor rezulton se nga veprimet e magjistratit subjekt hetimi disiplinor në rastin e shqyrtimit të kërkesës së të dënuarit {...}, {...}, {...}, ka ardhur si pasojë lirimi me kusht dhe ulja e padrejtë e dënimit, në zbatim të gabuar të ligjit material dhe procedural, duke i sjellë përfitim të padrejtë e cila është dhe pasoja e drejtpërdrejtë e shkeljes disiplinore. Kryerja e veprimeve/mosveprimeve të para si një sjellje në tërësinë e vet nga ana e magjistratit {...} ka çënuar në mënyrë të drejtpërdrejtë qëllimin (*ratio*) e institutit të lirimimit me kusht të parashikuar nga norma ligjore.

34. Në të njëjtën kohë, ushtrimi i pa rregullt i detyrës nga ana e magjistratit ka sjellë pasoja për dhënien e drejtësisë, cenimin e prestigjit të gjyqtarit dhe humbjen e besimit ndaj tij, si dhe ka çënuar besimin e publikut te drejtësia. Besimi i publikut nuk është nocion i papërkufizuar, pasi gjen mbështetje te vlerat themelore dhe standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së magjistratëve, sipas përcaktimeve të neneve 3 dhe 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Në nenin 3, pika 5, të ligjit nr. 96/2016 është parashikuar se sjellja e magjistratit është e lidhur me garantimin e ruajtjes e forcimit të besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë. Nëse magjistratët nuk e përmbushin plotësisht rolin e tyre për dhënien e sigurimin e drejtësisë në shoqëri ekziston rreziku i humbjes së besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Besimi i publikut dhe respekti për gjyqësorin janë garanci të demokracisë dhe stabilitetit në një shoqëri demokratike.

35. Sjellja e gjyqtarëve në kontekstin profesional është shumë e rëndësishme.^[9] Referuar parimeve të Bangalores, cenimi edhe vetëm i parimeve të etikës, në marrëdhëniet e punës

[9] Standarde të sjelljes etike të gjyqtarëve janë shtjelluar shterueshëm dhe vazhdojnë të shtjellohen nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC), Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë (CCJE), si dhe organet e qeverisjes së gjyqësorit në shumicën e vendeve anëtare të Këshillit të Evropës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

apo edhe jashtë saj mund të përbëjë shkak për cenimin e besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë. Gjatë këtij procesi zbatohet testi i vëzhgimit të sjelljes së tyre duke marrë në konsideratë faktin se si do të perceptohet një sjellje e caktuar nga një individ i arsyeshëm, i paanshëm dhe i mirinformuar i shoqërisë dhe a e zvogëlon ky perceptim respektin për vetë gjyqtarin apo gjithë gjyqësorin? Referuar “*teorisë së dukjes*”, drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por edhe duhet të shihet. Në këtë kuptim, vlerësohet se ka rëndësi se çfarë veprimesh ka bërë një gjyqtar në përmbushje të detyrës së tij, por është e rëndësishme gjithashtu të vlerësohet se çfarë shoqëria mendon. Në këtë kuptim, sjellje të caktuara të gjyqtarit, konsiderohen si cenim i parimit të besimit të publikut tek drejtësia.

35.1. Në të njëjtën kohë, paraprakisht vlerësohet se ndryshe nga sa ka vepruar magjistrati subjekt hetimi disiplinor në funksion të forcimit të besimit publik, detyra e magjistratit duhet të ushtrohet me drejtësi. Kjo nënkupton se detyrat duhet të përmbushen sipas bindjes së brendshme, bazuar në një vlerësim objektiv të fakteve të provuara përballë zbatimit të saktë të ligjit në fuqi. Detyra duhet të ushtrohet në mënyrë korrekte, që është një kërkesë për të patur zgjidhje të ndershme, uniforme dhe të qëndrueshme të çështjeve që paraqiten për shqyrtim. Po ashtu, magjistrati duhet të ushtrojë detyrën në mënyrë të kujdesshme, duke marrë masat për të shmangur gabime në vlerësimin e fakteve dhe zbatimin e ligjit. Në këto kushte, arrihet në konkluzionin se veprimet/mosveprimet e magjistratit {...} kanë cenuar vlerat themelore të tij, si rrjedhojë, edhe besimin që ai duhet të përcjellë te publiku në përmbushjen e misionit dhe rolit të saj në dhënien e drejtësisë.

36. Në analizë të kriterit “**masa e ndonjë rreziku të shkaktuar nga shkelja disiplinore**” në raport me faktet e provuara në këtë proces hetimi disiplinor rezulton se sjellja e papërshtatshme e magjistratit subjekt hetimi disiplinor nuk është shtrirë vetëm tek magjistrati subjekt i hetimit disiplinor, por ka krijuar terren për sjellje të papërshtatshme edhe në rastet të tjera të ngjashme. Standardet e gabuara të vendimeve gjyqësore mund të aplikohen edhe nga magjistratë të tjerë, si dhe njëkohësisht mund të shërbejë si praktikë për edhe shumë të dënuar të tjerë me rrezikshmëri shumë të lartë shoqërore të pretendojnë në kundërshtim me parashikimet e ligjore në fuqi për lirim me kusht, pa një zbatim të saktë të ligjit material dhe procedural, fakte të cilat kane ndodhur më parë me të dënuar me rrezikshmëri të lartë shoqërore.

37. Në analizë të çështjes lidhur me **llojin e masës së disiplinore** paraprakisht vlerësohet se ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar i referohet sanksionit disiplinor me termin “*masë disiplinore*”. Sipas parashikimeve të nenit 105 të ligjit, konstatohet se kjo dispozitë në përputhje me parimin e ligjshmërisë, i cili kërkon që masa disiplinore të përcaktohet nga ligji, parashikon detyrimin për përzgjedhjen e masave disiplinore të parashikuara nga kjo dispozitë. Në të njëjtën kohë, për të mundësuar zbatimin e parimit të drejtësisë, objektivitetit, individualizmit dhe proporcionalitetit parashikon një listë prej 6 masash disiplinore (*nga më e lehta te më e rënda*), me qëllim që ndaj magjistratit të jepet ajo masë që është e domosdoshme dhe e

dobishme për arritjen e qëllimit të procedimit disiplinor ndaj tij dhe në përputhje me shkeljen disiplinore që ka kryer.

38. Qëllimi thelbësor i masës disiplinore është mbrojtja e interesit publik nëpërmjet deklarimit të përgjegjësisë disiplinore të magjistratit për shkak të shkeljes disiplinore që ai ka kryer dhe marrja e masave aktive për edukimin e magjistratit, nëse një gjë e tillë është e mundur. Në të njëjtën kohë, masa disiplinore që caktohet ndaj magjistratit përmbush edhe dy qëllime parandaluese: (i) parandalimin e posaçëm, në kuptimin që magjistrati në të ardhmen të mos kryejë më shkelje disiplinore; dhe (ii) parandalimin e përgjithshëm, në kuptimin që magjistratët e tjerë kuptojnë që një sjellje e papërshtatshme nuk duhet kryer, pasi është e ndëshkueshme me masë disiplinore.

39. Ndërkohë, në rastin kur shkelja disiplinore e kryer është aq e rëndë sa e bën magjistratin të papërshtatshëm apo të padenjë për të vazhduar funksionin e tij, atëherë masa disiplinore nuk mund të luajë më rol edukues. Në këtë rast, masa disiplinore merr përsipër të mbrojtë interesin publik, duke larguar nga detyra magjistratin dhe duke u kthyer kështu në masë me natyrë të pastër ndëshkuese ndaj tij. Kjo masë disiplinore përcaktohet pikësisht në nenin 140, pika 2, të Kushtetutës, sipas të cilit gjyqtari shkarkohet nga detyra kur: a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e tij gjatë ushtrimit të detyrës; b) është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi. Në të njëjtën kohë kjo masë parashikohet edhe në nenin 111 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ku parashikohet përgjegjësia disiplinore e magjistratit për një shkelje shumë të rëndë, që e bën atë të papërshtatshëm ose të padenjë për të vazhduar ushtrimin e funksionit. Papërshtatshmëria ose padenjësia e magjistratit për të vazhduar funksionin mund të ketë si shkak: (i) dënimin e magjistratit për kryerjen e një krimi; (ii) paaftësinë e rëndë dhe dukshme të magjistratit; ose (iii) sjellje të kryer me pakujdesi të rëndë, që shkel haptazi vlerat themelore të sistemit gjyqësor.

40. Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili ka dalë në bazë dhe në zbatim të nenit 140 të Kushtetutës, ka përcaktuar se cilat veprime/mosveprime të magjistratëve përbëjnë shkelje disiplinore, të cilat përbëjnë dhe shkak për marrjen e masës disiplinore ndaj gjyqtarit. Në të njëjtën kohë, në ligj nuk parashikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë se cilat shkelje disiplinore janë të lehta, të rënda apo shumë të rënda, por për të arritur në këtë konkluzion në lidhje me rëndësinë e shkeljes disiplinore duhet të bëhet rast pas rasti një analizë juridike dhe faktike e kriterëve për caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore të parashikuara nga neni 115 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar në raport me faktet e provuara në këtë proces hetimi disiplinor.

41. Në rastin konkret për sa është analizuar më sipër, është arritur në konkluzionin se veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e magjistratit {...} që përbëjnë shkelje disiplinore parashikuar nga neni 102 pika 1, shkronja “dh” dhe neni 102, pika 2, shkronjat “a”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përbëjnë “Shkelje shumë të rëndë disiplinore”.

42. Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon se për shkelje shumë të rënda disiplinore mund të jepet masa disiplinore “Pezullimi si masë disiplinore” apo “Shkarkimi”. Të dyja këto masa mund të jepen për shkelje shumë të rënda, por vetëm me dallimin lidhur me papërshtatshmërinë apo padenjësinë e magjistratit për të vazhduar funksionin e tij, si pasojë e kryerjes së një shkelje disiplinore që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës.

43. Në këto kushte, në rastin konkret duhet të analizohet fakti nëse veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e magjistratit {...} që përbëjnë “*Shkelje shumë e rëndë disiplinore*” përbëjnë “*akte që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit*” gjatë ushtrimit të detyrës” dhe për rrjedhojë e bëjnë atë të pa përshtatshëm apo të padenjë për të vazhduar funksionin e tij si magjistrat. Veprimet apo mosveprimet e gjyqtarit që analizohen në bazë të rrethanave të kryerjes së tyre, momenti subjektiv si dhe dëmet që i sjellin shoqërisë dhe shtetit duhet të jenë të asaj natyre që e bëjnë të pamundur kryerjen e mëtejshme të funksioneve [10].

43.1. Koncepti i shkeljeve të rënda profesionale që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit nuk është i ri në Kushtetutë. Madje, ky koncept është pasuruar edhe nga jurisprudenca kostante e Gjykatës Kushtetuese, e cila ka vënë në dukje se kjo shprehje, përmbledh në vetvete një sërë elementësh, të cilët mund të identifikohen rast pas rasti nga organi përkatës që merr vendimin për shkarkimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm. Më tej, Gjykata Kushtetuese vazhdon me arsyetimin se ato janë të lidhura me akte e sjellje të parregullta e të padenja që këta funksionarë të lartë kryejnë gjatë ushtrimit të detyrës, për shkak të saj si dhe jashtë detyrës. Këto veprime apo mosveprime që analizohen në bazë të rrethanave të kryerjes së tyre, momenti subjektiv si dhe dëmet që i sjellin shoqërisë dhe shtetit duhet të jenë të asaj natyre që e bëjnë të pamundur kryerjen e mëtejshme të funksioneve kushtetuese nga këto subjekte [11].

43.2. Në analizë të këtyre parashikimeve rezulton se aktet e sjelljet që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit kërkojnë një analizë të hollësishme, mbi vlerësimin e ekzistencës së tyre. Ky proces vlerësimi lidhet me një sërë elementesh që kanë të bëjnë me ato shkelje të dispozitave ligjore të kryera gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj. Këto shkelje marrin karakterin e rëndë të tyre lidhur ngushtë me rëndësinë e ligjit të shkelur, me pasojat e ardhura, apo që mund të vinin nga shkelja, me frekuencën e shkeljes, kohëzgjatjen e pasojave dhe të vështirësive për riparimin e tyre, si dhe me qëndrimin subjektiv që mban magjistrati kundrejt saj dhe pasojës së ardhur. Të gjitha këto parime gjejnë zbatim në dispozitat e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

[10] Vendimi Nr. 75/2002, i Gjykatës Kushtetuese; Vendimi Nr. 3/2006 i Gjykatës Kushtetuese.

[11] Shih për më tepër vendimin 11/2004

43.3. Vlerat themelore, standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes [12] kërkojnë që gjyqtarët të sillen me integritet dhe në një mënyrë të denjë për detyrën. Shkelja e ligjit nga një gjyqtar mund të dëmtojë reputacionin e funksionit si gjyqtar, të inkurajojë mosrespektimin e ligjit dhe të cenojë besimin e publikut në integritetin e vetë gjyqësorit. Një gjyqtar është i detyruar të respektojë ligjin dhe ai nuk duhet të vendoset në një pozicion konflikti me zbatimin e ligjit. Çfarë të tjerët mund të shihet si një shkelje relativisht e vogël, te gjyqtari mund të tërheqë vëmendje dhe të dëmtojë imazhin e gjyqtarit dhe të shtrojë pikëpyetje në lidhje me integritetin e tij dhe integritetin e gjyqësorit. Nga këndvështrimi i publikut, një gjykatës jo vetëm që është zotuar t'u shërbejë idealeve të drejtësisë dhe të së vërtetës, mbi të cilat është ndërtuar shteti ligjor dhe themelet e demokracisë, por edhe t'i mishërojë ato.

43.4. Kushtetuta ka parashikuar në disa norma detyrimin e gjyqtarëve për të respektuar me përpikëri Kushtetutën, ligjet dhe për të ruajtur paanësinë e figurën e pastër në funksion të dhënies së një drejtësie bindëse. Nëse konstatohen raste të inkriminimit të gjyqtarëve, akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën e figurën e gjyqtarit ose pamjaftueshmëri profesionale, organet përgjegjëse duhet të mbajnë qëndrimet e duhura deri në shkarkimin nga detyra të gjyqtarit.[13] .

43.5. Referuar parashikimeve të trajtuara më sipër kuptohet dhe del qartë rëndësia e madhe që ka respektimi i normave ligjore nga ana e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës së tij. Kjo rëndësi del qartë dhe nga fakti se pikërisht shkeljet e pajustificuara dhe të vazhduara të këtyre normave, kur kanë sjellë ose mund të sjellin pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve ose për dhënien e drejtësisë konsiderohen si akte dhe sjellje që diskreditojnë rëndë figurën e gjyqtarit.

44. Në mbështetje të nenit 3 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, një ndër vlerat themelore të deklaruara është pavarësia e magjistratit. Pavarësia në ushtrimin e funksioneve të gjyqtarit i referohet pavarësisë së brendshme dhe të jashtme. Pavarësia e brendshme lidhet me pavarësinë e çdo individi magjistrat për të ushtruar funksionet që lidhen me pozicionin e tyre. Ky parim parashikohet edhe në nenin 137 dhe 145 të Kushtetutës në lidhje me pavarësinë e gjyqtarit në dhënien e vendimeve. Gjyqtari gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrim të funksioneve të tij, përveç rasteve të dhënies qëllimisht të një vendimi si pasojë e një interesi vetjak ose keqbesimi. Ndërsa në nenin 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sanksionohet, se gjyqtarët janë të pavarur dhe i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Me këtë kuptohet pavarësia, përgjegjësia dhe kompetenca e veçantë e gjyqtarëve në dhënien e drejtësisë, nëpërmjet zgjidhjes së çështjeve konkrete.

45. Inspektori i Lartë i Drejtësisë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij kushtetuese ka detyrimin të garantojë pavarësinë e pushtetit gjyqësor, duke ushtruar këtë veprimtari pa cënuar pavarësinë e këtij pushteti dhe pa zëvendësuar një organ gjyqësor. Vendimet e një

[12] Neni 3 dhe 4 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

[13] Vendimi Nr. 11/2004, i Gjykatës Kushtetuese

gjqytari nuk mund të bëhen objekt rishikimi jashtë sistemit të apelimit siç parashikon ligji. Asnjë pushtet tjetër nuk mund të funksionojë si gjykatë dhe të ushtrojë detyrën e gjyqtarit. Askush nuk mund të ndërhyjë në dhënien e drejtësisë apo në dhënien e vendimit për çështje të caktuara. Askujt nuk i lejohet të vërë në diskutim njohjen dhe vlerën e vendimeve apo të refuzojë zbatimin e tyre, pasi ato kanë marrë formë të prerë. Vendimet gjyqësore të formës së prerë, për çështjen konkrete që zgjidhin, kanë fuqinë e ligjit. Kjo do të thotë se përsa kohë ato nuk janë prishur ose ndryshuar nga një gjykatë më e lartë, asnjë organ tjetër shtetëror nuk mund të mos përfillë përmbajtjen e tyre dhe të ngarkojë me përgjegjësi gjyqtarin e çështjes.^[14]

45.1. Ndërkohë, në përgjigje edhe të pretendimit të magjistratit nën hetim disiplinor për vendimet e dhëna që janë të formës së prerë dhe nuk është ankimuar, vlen të theksohet se referuar praktikës së Gjykatës Kushtetuese kjo mund të realizohet përjashtimisht në rastet kur dhënia e vendimit është shoqëruar me akte dhe sjellje që diskreditojnë figurën e gjyqtarit. Në Vendimin nr. 11, datë 27.05.2004, Gjykata Kushtetuese shprehet se: “...[...]*KLD-ja mund të marrë masa disiplinore pa e kushtëzuar atë me faktin nëse ky vendim ka marrë formë të prerë, vetëm për raste kur vendimet shoqërohen me akte dhe sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit dhe cenojnë në përgjithësi prestigjin dhe autoritetin e pushtetit gjyqësor*”. Po kjo gjykatë në vendimet Nr. 29, datë 30.04.2001 dhe Nr. 11, datë 02.04.2003 shprehet se: “...[...]*Përderisa vendimet nuk janë prishur ose ndryshuar nga një gjykatë më e lartë, asnjë organ tjetër disiplinore gjyqtarin e çështjes për këto vendime.....[....]....përjashtim nga rregulli i mësipërm bëhet vetëm për rastet kur vendimet janë shoqëruar me shkelje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit ...[...]*”.

45.2. Magjistrati e ushtron funksionin në mënyrë të pavarur, por ai nuk mund të veprojë në mënyrë arbitrare dhe të gjykojë rastet duke u bazuar në preferencat personale, interesi vetjak apo keqbesimi, por vetëm duke u bazuar në ligjet përkatëse dhe duke i interpretuar ato në varësi të rrethanave të veçanta të një çështjeje. Elementi i bindjes së brendshme të magjistratëve është i lidhur vetëm me interpretimin e ligjit në kontekstin e fakteve të një çështje të caktuar. Magjistrati mban përgjegjësi disiplinore për mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, për sa kohë që nga rrethanat objektive dhe subjektive rezulton se veprimet e tij mund të kenë qenë të qëllimshme dhe në kundërshtim të hapët dhe flagrant me ligjin apo me praktikat unifikuese të gjykatave më të larta. Magjistrati mban përgjegjësi sipas ligjit dhe një qasje e tillë është në përputhje me parashikimet e nenit 137, 140, pika 1, të Kushtetutës e reflektuar edhe tek përmbajtja e shkeljes disiplinore të parashikuar në nenin 102, pika 1, shkronja “dh” dhe në nenin 102, pika 2, shkronjat “a” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

45.3. Interpretimi i kësaj shkelje disiplinore në frymën e dispozitave kushtetuese, nenit 140, pika 2, shkronja “a” nënkupton konstatimin e shkeljes nga një gjykatë më e lartë gjatë

[14] Vendimi Nr. 29/2001 i Gjykatës Kushtetuese; Vendimi Nr. 11/2004 i Gjykatës Kushtetuese; Rezolutë nr. (94)12 e Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropian.

ushtrimit të kontrollit gjyqësor mbi bazë ankimi, konstatim të cilit ILD duhet t'i referohet gjatë vlerësimit të rastit nga ana e saj. Në mungesë të një ankimimi ndaj vendimit dhe për rrjedhojë edhe mungesës së kontrollit gjyqësor të vendimarrjes, konstatimi i shkeljeve nga ILD në një vendim të formës së prerë për shkak mosankimimi bëhet vetëm në rastet kur vendimarrja është shoqëruar me shkelje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës.

46. Në rastin e magjistratit {...} vendimet e dhëna prej tij me nr. 13/21-2018-1692, datë 23.10.2018, për lirim me kusht të kërkuesit {...}, vendimin nr. 21-2021-1771/17, datë 21.10.2021 për lirim me kusht të kërkuesit {...}, vendimin nr. 21-2021-1574/124, datë 23.09.2021 për ulje dënimi për kërkuesin {...}, vendimin nr. 22/21-2019-2200, datë 22.11.2019 për lirim me kusht të kërkuesit {...}, përbëjnë akte që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit. Nga ana e magjistratit {...} është zhvilluar proces gjyqësor i njëanshëm dhe në kundërshtim me ligjin material dhe procedural penal dhe ligjin nr. 81/2020, i ndryshuar.

46.1. Neni 145 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sanksionon se: “Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve”. Me këtë kuptohet pavarësia, përgjegjësia dhe kompetenca e veçantë e gjyqtarëve në dhënien e drejtësisë në zgjidhjen e çështjes konkrete. Nga ana tjetër gjyqtarët kanë detyrim të japin vendime në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet [15]. Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e vet ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme se është e një rëndësie themelore në një shoqëri demokratike që gjykatat të frymëzojnë besim te publiku dhe, mbi të gjitha, te palët në proces. Për këtë qëllim neni 42 i Kushtetutës kërkon që një gjykatë, e cila përfshihet në sferën e veprimit të tij, të jetë e paanshme. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjykimëve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njëres prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur [16]. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet.

46.2. Në nenin 3 të ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995, i ndryshuar (Kodi Penal) gjithashtu thuhet shprehimisht se: “Gjykata është e pavarur dhe vendos në bazë të ligjit; 2. Gjykata jep vendim në bazë të provave që shqyrtohen dhe verifikohen në seancë.” Në ushtrimin e funksionit për zgjidhjen e drejtë të çështjes dhe dhënien drejtësi, gjyqtarët duhet të kenë rol aktiv dhe të pandërruar nga palët në procesin e hetimit gjyqësor.

46.3 Në rastin konkret objekt hetimi disiplinor rezulton se gjatë dhënies së vendimit nr. 13/21-2018-1692, datë 23.10.2018, për lirim me kusht të kërkuesit {...}, nr. 21-2021-1771/17, datë 21.10.2021 për lirim me kusht të kërkuesit {...}, nr. 21-2021-1574/124, datë 23.09.2021 për ulje dënimi për kërkuesin {...}, nr. 22/21-2019-2200, datë 22.11.2019 për lirim me kusht të kërkuesit {...}, nr. 06/21-2018-496, datë 27.03.2018 për lirim me kusht të

[15] Shiko vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 11/2004.

[16] Shiko vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.30/2005;23/2007; 24/2007; 28/2007;42/2007; 25/2011,

kërkuesit {...}, magjistrati nën hetim {...} nuk ka zbatuar kërkesat e parashikuara në nenet 64 të kodit penal, 477 të K. PR. Penale, nenin 75 të ligjit nr. 81/2020 i ndryshuar, si dhe është bazuar në të dhëna jo të plota duke konkluduar për zgjidhjen përfundimtare të çështjes, pa hetuar provueshmërinë e kushteve që parashikon dispozita duke qenë i njëanshëm në gjykim.

47. Për sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë: (i) natyrën e shkeljes disiplinore të parashikuar nga neni 102 pika 1, shkronja “dh” dhe neni 102, pika 2, shkronjat “a”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; (ii) rrethanat e shkeljes së kryer, të cilat kanë të bëjnë me mosrespektim të përsëritur të legjisllacionit material dhe procedural penal (iii) kryerjen e shkeljes disiplinore nga ana e magjistratit me dashje direkte; (iv) përvojën e konsiderueshme të magjistratit në sistemin gjyqësor dhe mospasjen e vlerësimeve profesionale; (v) pasojat e shkeljes disiplinore lidhur me përfitimin e padrejtë të lirimit me kusht nga të dënuarit, të cilët përbëjnë rrezik për komunitetin dhe shoqërinë në kundërshtim me parashikimet legjisllacionit material dhe procedural penal (vi) cënimin e imazhit të sistemit gjyqësor dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë; (vii) ekzistencën e rrezikut të shkaktuar nga shkelja disiplinore pasi sjellja e papërshtatshme nuk shtrihet vetëm tek magjistrati subjekt hetimi disiplinor, por rrezikon të ndiqet si shembull nga magjistratë të tjerë si dhe krijon terren për sjellje të papërshtatshme dhe në raste të tjera të ngjashme; (viii), mungesën e ndonjë arsye specifike që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor, faktin që shkelja disiplinore në rastin konkret përbën “Shkelje shumë të rëndë disiplinore”; arrihet në konkluzionin se magjistrati {...} në vendimarrjet e tij ka kryer shkelje të rënda profesionale duke diskredituar rëndë figurën dhe pozitën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës.

48. Për sa sipër, duke mbajtur në konsideratë faktin se masa disiplinore është e varur nga ekzistenca e përgjegjësisë disiplinore së magjistratit, në përputhje me parimin e ligjshmërisë, duke u siguruar që masa e dhënë të jetë e parashikuar nga ligji dhe e nevojshme për të përmbushur qëllimin e ligjit; duke u bazuar në kriteret objektive lidhur me rëndësinë e shkeljes disiplinore dhe masës disiplinore; individualizmit dhe proporcionalitetit, pra që ndaj magjistratit të jepet ajo masë që është e domosdoshme dhe e dobishme, për arritjen e qëllimit të procedimit disiplinor ndaj tij, në përputhje me shkeljen disiplinore që ka kryer, paraprkisht vlerësohet se për veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e magjistratit {...} që parashikohen si shkelje disiplinore nga neni 102, pika 1, shkronja “dh” dhe neni 102, pika 2 shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, që përbëjnë “Shkelje shumë e rëndë disiplinore” dhe që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës, duhet të jepet masa disiplinore “Shkarkim nga detyra”.

IV. PARAQITJA E PRAPËSIMEVE NGA MAGJISTRATI

49. Rezulton se Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur kërkesë në KLGJ, për procedimin disiplinor, duke pretenduar shkelje procedurale të rënda, në disa vendime, me objekt “Lirim me kusht”.

49.1. Fillimisht inspektori ka analizuar se përse në disa nga çështjet e hetuara aplikohet zgjatja e afatit të hetimit nga 5 vjet në 6 vjet, me arsyetimin se jemi përpara rasteve të shkeljeve procedurale të së njëjtës natyrë. Si afat kohor të llogaritjes së parashkrimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i referohet datës **16.05.2023**¹⁷.

50. Kundërshtoj dhe në vijim arsyetoj se, çështjet e referuara nga Inspektori, jo vetëm që nuk kanë shkelje procedurale, por as edhe shkeljet e pretenduara si të tilla nga inspektori, nuk janë të njëjta dhe nuk kanë lidhje me njëra tjetrën. Inspektori bën një interpretim të gabuar, duke i vlerësuar çështjet të së njëjtës natyrë, me qëllim legjitimimin e hetimit të çështjeve, tej afatit 5 vjeçar të vendosur në nenin 117 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve e prokurorëve në RSH. Në këtë dispozitë parashikohet se “ *1. Shkeljet disiplinore parashkruhen brenda pesë vjetëve. Nëse një ankesë, sipas nenit 119, të këtij ligji, paraqitet pas 5 vjetëve nga koha kur ka ndodhur shkelja e pretenduar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk verifikon ankesën për shkak të parashkrimit. Nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë merr të dhëna, sipas nenit 124, të këtij ligji, pas 5 vjetëve nga koha kur ka ndodhur shkelja e pretenduar, ai nuk fillon hetimin për shkak të parashkrimit. 2. Afati i parashkrimit fillon nga momenti kur shkelja e pretenduar është kryer. 3. Nëse magjistrati kryen shkelje tjetër të së njëjtës natyrë brenda afatit të parashkrimit, afati zgjatet deri në një vit.*

51. Në nenin 124 të ligjit që referon dispozita e mësipërme parashikohet se “ *1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon hetimin me iniciativën e tij, bazuar në të dhëna thelbësore mbi fakte që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer. Informacionet që përftohen nga media ose nga ankues anonimë mund të shërbejnë si indicie për të filluar një hetim kryesisht nëse përmbushen kriteret e parashikuara në nenin 120, pika 1, shkronjat “b”, “ç”, “d” dhe “dh”.*

52. Në nenin 120, shkronja b, ç, d dhe dh, parashikohet se “ *1. Ankesa pranohet nëse përmbush kriteret e mëposhtme:*

b) i referohet fakteve që kanë ndodhur brenda afatit të parashkrimit për hetimin disiplinor; ç) bëhet ndaj sjelljes së magjistratit, i cili ka qenë në detyrë në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur;

d) bëhet ndaj sjelljes së magjistratit, të parashikuar si shkelje disiplinore nga ligji në fuqi në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur;

dh) bëhet ndaj sjelljes së magjistratit që, nëse provohet se është kryer, përbën shkelje disiplinore të parashikuar nga ligji.

¹⁷ Pragrafi i dytë, fjalia e fundit, faqe 4 e raportit të ILD.

53. Në zbatim të dispozitave të mësipërme, hetimi disiplinor ndaj meje ka nisur me nismë të ankuesit, siç Inspektori shprehet në Raportin për hetimin disiplinor, kur përdor shprehjen “**Mbi bazë ankese**” apo dhe në vijim që përmend dy ankimet e kryera, një nga znj. {...} {...}mi dhe tjetrin nga z. {...}.

Objekt kontrolli dhe referimi në raport, Inspektori ka marrë në shqyrtim çështjet penale:

1. Lirimi me kusht i të dënuarit {...}.
2. Lirimi me kusht i të dënuarit {...}.
3. Ulja e dënimit për të dënuarin {...}.
4. Lirimi me kusht i të dënuarit {...}.
5. Lirimi me kusht i të dënuarit {...}.

53.1. **Vendimi penal për lirimin me kusht të të dënuarit {...}** është dhënë në datën 23.10.2018. Tek Inspektori është ankuar shtetësja {...} {...}mi. Rezulton se raporti për procedimin disiplinor është i datës 16.02.2024 dhe vendimi i Inspektorit është po i datës 16.02.2024. Pra vendimi i Inspektorit për procedimin disiplinor është marrë pas 5 vjet e 4 muaj nga dhënia e vendimit objekt hetimi. Në këto kushte, procedimi disiplinor për shqyrtimin e vendimarrjes për lirimin me kusht të të dënuarit {...} është i parashkruar. Për këtë çështje, Inspektori pretendon se në vlerësimin e kriterit subjektiv “arsye të veçanta” nuk është marrë në konsideratë që i dënuari kishte një dënim të mëparshëm për kundërvajtje penale.

53.2. **Vendimi penal për lirimin me kusht të të dënuarin {...}** është dhënë në datën 22.11.2019, çka rezulton se referuar datës 16.02.2024, është brenda afatit ligjor 5 vjeçar të parashkrimit të procedimit disiplinor. Kjo çështje është hetuar kryesisht nga Inspektori.

53.3. **Vendimi penal për lirimin me kusht të të dënuarit {...}** është i datës 27.03.2018, çka rezulton se referuar datës së fillimit të hetimit disiplinor 06.05.2023, apo dhe vendimit të Inspektorit për procedim disiplinor datë 16.02.2024, ka kaluar afati 5 vjeçar i hetimit dhe për këto arsye, procedimi disiplinor për këtë çështje gjyqësore është i parashkruar. Në analizën e tij Inspektori shprehet se për këtë çështje, Gjykata e Apelit ka konstatuar shkelje procedurale, në lidhje me verifikimin e kushtit procedural të moskryerjes së një kërkesë të mëparshme të rrëzuar brenda afatit 6 mujor nga data e paraqitjes së kërkesës, mbi bazën e të cilës, gjykata vendosi lirimin me kusht. Pra shkakun e pretenduar nga Inspektori në këtë çështje, nuk ka lidhje me shkakun e pretenduar në çështjen ndaj të dënuarit {...}.

53.4 **Vendimi penal për lirimin me kusht të të dënuarit {...}** është i datës 21.10.2021, brenda afatit 5 vjeçar të hetimit. Rezulton se sipas raportit të Inspektorit, gjykata ka gabuar në vlerësimin e provave, për të përcaktuar plotësimin e kushtit subjektiv “arsye të veçanta”, pasi nuk ka analizuar drejtë sjelljen e të dënuarit gjatë pjesës së vuajtur të dënimit penal. Siç shprehet edhe Inspektori në raportin disiplinor, hetimi ka filluar mbi ankimin e shtetasit {...}.

54. Sqarohet se shtetasi {...} {...} dhe jo {...}¹⁸, siç e referon Inspektori nuk ka ushtruar asnjë ankesë ndaj meje, në lidhje me çështjen penale të lirimit me kusht të të dënuarit {...}.

55. Inspektori shprehet se shtetasi {...} ka kryer ankim për çështjen penale të lirimit me kusht, të shtetasit {...}. Ndërkohë rezulton se asnjë vendimarrje e Inspektorit nuk i është njoftuar shtetasit {...} {...}, pasi Inspektori e ka ditur se ankimi ka qenë anonim dhe jo i kryer nga shtetasi {...} {...}. Edhe në mbyllje të raportit dhe paraqitjes së kërkesës për procedim në KLGj, Inspektori shprehet për njoftimin e shtetasës {...} {...} mi dhe jo shtetasit {...}. Lind pyetja pse duhet të njoftohet vetëm shtetësja {...} {...} mi dhe jo shtetasi {...} {...}, për sa kohë të dy janë ankues për çështje të ndryshme?

56. Rezulton se tek Inspektori kam paraqitur kërkesë në datën 08.07.2022¹⁹ për procedimin disiplinor të gjyqtarës {...}, e provuar nga hetimet penale, se ka fallsifikuar ankesën/shkresën në emër të shtetasve {...} dhe avokatit {...}²⁰. Gjithashtu edhe shtetasi {...} ka paraqitur një deklaratë noteriale²¹ tek Inspektori ku shprehet se nuk ka kryer asnjë ankim ndaj gjyqtarit {...}. Pavarësisht provueshmërisë së faktit se ankesa e paraqitur nga shtetasi {...} {...} është e fallsifikuar dhe anonime, Inspektori ka filluar dhe vazhduar hetimet, në kundërshtim me nenin 119, pika “3” të ligjit nr. 96/2006 “Për statusin e gjyqtarëve e prokurorëve në RSH”, në të cilin thuhet “3. **Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka detyrimin të shqyrtojë ankesat, përveç atyre anonime.** Rasti i vetëm kur ankimet anonime mund të verifikohen nga inspektori janë ato të treguara në nenin 120 b/ç/ d/dh të ligjit 96/2016, por që kanë si qëllim verifikimin e sjelljes së gjyqtarit dhe jo vendimarrjen e tij. Ky parashikim ligjor nuk ka lidhje me çështjen e lirimit me kusht të të dënuarit {...}.

57. Vlerësoj se hetimi i ankesës anonime është kryer nga Inspektori me qëllimin që hetimi i kësaj çështje, të interpretohej si shkelje e së njëjtës natyrë dhe të kalonte afatin e parashkrimit nga 5 vjet në 6 vjet, sipas parashikimit të nenit 117 të ligjit nr. 96/2016 dhe të justifikonte hetimet për çështjet e parashkruara, të lirimit me kushte të shtetasit {...} dhe të shtetasit {...}, afati 5 vjeçar i procedimit disiplinor kishte përfunduar.

58. Ndërkohë rezulton se në Raportin e Inspektimit Tematik në Gjykatat dhe Prokuroritë e RSH²², për trajtimin e kërkesave lirim me kusht, të datës 29.12.2023 (para datës 16.02.2024 të raportit për procedim disiplinor), grupi i Inspektimit ku janë dhe dy inspektorët që kanë përpiluar raportin disiplinor kundër meje, nuk kanë konstatuar asnjë shkelje në vendimet e mësipërme, apo dhe vendime të tjera të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë²³, me arsyetime apo vendimarrje të ndryshme nga praktika gjyqësore e gjykatave të tjera, apo edhe

¹⁸ Fallsifikuesi i shkresës ka ngateruar emrin nga {...} në {...}.

¹⁹ Shkresa datë 08.07.2022 drejtuar ILD, paraqitur si provë në këtë procedim disiplinor.

²⁰ Dy ankesa të ndryshme drejtuar ILD, me të njëjtin objekt ankimi dhe shpifje ndaj meje, verifikuar që janë dorëzuar në Postën shqiptare nga i njëjti person.

²¹ Deklarata noteriale nr. 2514 rep, nr. 723 kol., datë 03.06.2023, paraqitur si provë në këtë procedim disiplinor.

²² Raporti I Inspektimit “Mbi kryerjen e Inspektimit tematik të gjykatave dhe zyrave të prokurorive pranë tyre mbi trajtimin e kërkesave me objekt “Lirim me kusht”, nr. 56/29 prot., datë 29.12.2023, njoftuar KLGJ-së dhe Gjykatave dhe Prokurorive me shkresën nr. 56/31 prot., datë 22.02.2024.

²³ Faqe 151 e Raportit Tematik në gjykata dhe prokurori për çështjet “lirim me kusht”.

e Gjykatës së Lartë. I vetmi rast që përmendet është rasti i lirimimit me kusht të {...}t, duke e referuar si rasti i vetëm ku ishte investuar Gjykata e Apelit Gjirokastër, pasi të gjitha çështjet e tjera kishin marrë formë të prerë në shkallën e parë të gjykimit.

59. Për këto arsye, kërkoj që Këshilli i Lartë Gjyqësor të konstatoj të parashkruar veprimtarinë e ILD-së për hetimin dhe fillimin e procedimit disiplinor për çështjet gjyqësore, lirimimit me kusht të shtetasve {...} dhe {...}. Të konstatojë si të filluar në kundërshtim me ligjin, mbi bazën e një ankimi anonim, hetimin dhe procedimin disiplinor të çështjes gjyqësore, për lirimimit me kusht dhe uljen e dënimit për shtetasin {...}. Të vazhdoj shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit, vetëm për çështjen penale “Lirim me kusht” për shtetasin {...}.

60. Nëse KLGJ nuk pranon kërkesën e mësipërme, po paraqes qëndrimin tim në lidhje me sa parashtron Inspektori në kërkesën për procedim disiplinor për secilën prej çështjeve gjyqësore.

61. Paraprakisht po arsyetoj dhe provoj se arsyetimi dhe vlerësimet e Inspektorit në verifikimin e këtyre çështjeve, nxjerrin në pah, shtrembërimin e fakteve dhe vlerësimin e gabuar, të njëanshëm dhe tej kompetencave që ligji u njeh, që nuk korrespondojnë me gjetjet, vlerësimet dhe rekomandimet që vetë Inspektori jep në “Raportin mbi kryerjen e inspektimit tematik të gjykatave dhe prokurorive pranë tyre, mbi trajtimin e kërkesave me objekt “Lirim me Kusht”, datë 29.12.2023.

62. Në çështjet penale të lirimimit me kusht të të dënuarit {...} dhe {...}, Inspektori shprehet se gjykata nuk ka vlerësuar drejtë **kriterin subjektiv** të nenit 64 të K.Penal²⁴ dhe konkretisht **“arsyet e veçanta”**²⁵ që justifikojnë lirimimit me kusht të të dënuarit. (*faqe 37 dhe 42 e raportit disiplinor*).

62.1. Ndërkohë që në Raportin e vlerësimit tematik të të gjitha gjykatave e prokurorive nr.“44.1 faqe 157... titulluar “Kriteri subjektiv” Inspektori është shprehur “lidhur me këtë kriter në trajtimin e vendimeve është mbajtur në konsideratë natyra subjektive e procesit të vlerësimit të gjyqtarit, e cila ka përfunduar me konkluzionin e arritur prej tij në pranimin/rrëzimin e kërkesës..... Në vendimet gjyqësore të trajtuara, konstatohet se vendimet kanë të njëjtin standard arsyetimi, duke ju referuar qëndrimin të Kolegjeve të

²⁴ Në nenin 64 të K.Penal parashikohet se “ I dënuari me burgim mund të lirohet me kusht, nga vuajtja e dënimit vetëm për **arsye të veçanta**, nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij, si dhe të ketë vuajtur:

- jo më pak se gjysmën e dënimit të dhënë për kundërvajtje penale;

- jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi gjer në pesë vjet burgim;

- jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi mbi 5 vjet deri në maksimumin e parashikuar nga ligji, me përjashtim të parashikimeve në paragrafin 3 të këtij neni.

Në masën e dënimit të vuajtur nuk llogaritet koha e përfituar me amnisti ose falje.

Nuk lejohet lirim me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje si dhe për të dënuarit për kryerjen e veprave penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c apo paragrafi i tretë i nenit 100.

Bashkuara të Gjykatës së Lartë, shprehur në vendimin nr. 2/2015, lidhur me shprehjen “arsye të veçanta”.

62.2. Arsyetoj se në këtë Raport Tematik në të gjitha gjykatat, nuk konstatohet që të ketë asnjë analizë lidhur me vlerësimin e provave nga gjykatat, në lidhje me plotësimin e standardit subjektiv, “arsye të veçanta,” arritjes së rehabilitimit të personit të dënuar.

62.3. Në kreun III, faqe 164 e Raportit Tematik në gjykata dhe prokurori, “Analiza e të dhënave të konstatuara” “Lidhur me respektimin e legjislacionit material”, Inspektori shprehet si vijon: (faqe 168. 1.1. Lidhur me zbatimin e legjislacionit material:

Referuar parashikimit të nenit 64 të K. Penal, që një i dënuar me burgim të mund të përfitojë "lirimin me kusht", duhet që të plotësohen në mënyrë kumulative kriteret e përcaktuara shprehimisht në dispozitën në fjalë. Lidhur me këto kriteret, ashtu siç është shprehur edhe Gjykata e Lartë në një sërë vendimesh të saj 159, ndërsa dy kriteret ai i vuajtjes së masës së kërkuar të dënimit dhe të mos qënurit recidivist të dënuarit për krime me dashje apo i dënuar për kryerjen e veprave penale të përcaktuara 160, janë objektive (kriteri juridik), pasi bazohen mbi fakte të ndodhura dhe të provuara në aktet përkatëse të kohëshënuesit të dënimit dhe gjendjes gjyqësore; kriteri tjetër, ai i arsyeve të veçanta (kriteri subjektiv), të cilat tregojnë rehabilitimin e të dënuarit kërkon një interpretim dhe vlerësim rast pas rasti në bazë të provave që i paraqiten gjykatës.

Kjo natyrë e kriterëve në fjalë, është vlerësuar për t'u mbajtur në konsideratë edhe në trajtimin e vendimeve gjyqësore objekte të këtij inspektimi, në drejtim të konkludimit lidhur me respektimin e legjislacionit material.

Në këtë këndvështrim, përse i përket kriterit subjektiv në vendimet e gjykatave të rretheve gjyqësore të rrëzimit/pranimit ku edhe është trajtuar, konstatohet se në përputhje me ligjin me nr. 8331, datë 21.04.1998 "Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale". i ndryshuar dhe vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë, në vendime analizohen dhe konkludohet mbi këto kriteret duke u mbështetur në provat e paraqitura nga kërkuesi, qëndrimi i prokurorit, raportet përkatëse të {...} dhe Shërbimi i Provës. Ashtu siç është orientuar edhe nga vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në qëndrimin unifikues, konstatohet se në vendimet gjyqësore objekt i këtij inspektimit, është marrë në konsideratë funksioni i secilit prej dy institucioneve në fjalë, nëpërmjet analizës së raporteve të paraqitura prej tyre dhe konkludimit mbi krijimin e bindjes nëse i dënuari, me sjelljen dhe punën e tij është riedukuar dhe se është e mundur riintegrimi i të dënuarit në shoqëri. Dhe është mbi të njëjtat prova që nga ana e Gjykatës së Apelit, është vendosur në vazhdim lënie në fuqi apo ndryshim.

Nga të gjitha vendimet e gjykatave të rretheve gjyqësore, ku është vendosur rrëzim/pranim. referuar detyrimeve ligjore sipas ligjit me nr. 8331, datë 21.04.1998 "Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale", i ndryshuar dhe qëndrimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara, vetëm në 1 rast është konstatuar mungesa e administrimit të raportit të shërbimit të provës. Bëhet fjalë për një vendim pranimi të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat ku nga ana e gjyqtarit gjatë gjykimit nuk është kërkuar dhe as administruar raporti i shërbimit të

provës, dhe as thirrur ky institucion si pjesëmarrës në gjykim. Gjithashtu në të njëjtin gjykim, megjithëse {...} ishte thirrur si pjesëmarrës në gjykim dhe i ishte marrë mendimi mbi kërkesën, nuk ishte administruar në cilësinë e provës kartela e vuajtjes së dënimit. Vendimi në fjalë, mbi bazën e ankimit të prokurorit është bërë objekt kontrolli në Gjykatën e Apelit e cila e ka konsideruar këtë si shkak. bazuar në nenin 428/ç të K. Pr. Penale për të prishur vendimin dhe kthimin e çështjes për rigjykim. Gjykata e Apelit ka argumentuar vendimarrjen e saj. duke e konsideruar vendimin gjyqësor të gjykatës së rrethit gjyqësor në moszbatim ligjit me nr. 8331, datë 21.04.1998-Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale", referuar vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë, dhe e lidhur me pasojën e një hetimi të paplotë gjyqësor për të vlerësuar mbi bazueshmërinë e kërkesës së kërkuarit. Në vendimarrjen e saj. Gjykata e Apelit i ka kushtuar rëndësi theksimit të detyrimit të gjykatës së rrethit gjyqësor, edhe për zbatimin e orientimeve të vendimit unifikues të sipërcituar.

1.1.2. Përsa i përket kritereve objektive, lidhur me: (në vijim analizohen kriteret objektive, vuajtja e masës së kërkuar të dënimit, momenti kohor i paraqitjes së kërkesës për lirim me kusht, etj)

62.4. Në gjithë raportin e inspektimit tematik, në gjykata e prokurori, sa më sipër treguar (copy paste), është gjithë analiza e Inspektorit, në lidhje me zbatimin e ligjit material, kriterin subjektiv “arsye të veçanta”, ku gjykata analizon provat e paraqitura nga {...} dhe Shërbimi i Provës, në raportet përkatëse si dhe qëndrimin e prokurorit. Nuk konstatohet që Inspektori të ketë bërë asnjë analizë lidhur me mënyrën e vlerësimit të këtyre provave në Gjykata e Prokurori.

62.5. Këtë standard Inspektori nuk e ruan në raportin disiplinor të përgatitur ndaj personit tim, ku i hyn vlerësimit të anës subjektive, provave dhe vendimarrjes së gjykatës, në kundërshtim me të drejtat dhe kompetenca që i jep ligji, apo me analizën e mësipërme në Raportin Tematik. Gjithashtu, në vijim rezulton se në Raportin disiplinor, Inspektori në paragrafin e fundit të faqes 41, është shprehur se nuk është respektuar drejt kriteri prej 2/3-tave të dënimit të dhënë pasi duhej të aplikohet kriteri prej 3/4-tat të dënimit të dhënë për veprën penale që është dënuar kërkuari. (ndonëse nga verifikimi kërkuari kishte plotësuar 3/4-tat e dënimit të dhënë).

62.6. Ndërkohë në Raportin Tematik në Gjykata, në pikën 1.1.2, është shprehur: “ Përsa i përket kritereve objektive lidhur me: a) Vuajtjen e masës së kërkuar të dënimit, konstatohet se ndeshen dy praktika në mënyrën sesi përlllogaritet kjo periudhë në drejtim të interpretimit të parashikimit të dispozitës 64/1 të K.Penal. Një praktikë konsiston në interpretimin e dispozitës në fjalë, referuar masës së dënimit që parashikon dispozita e veprës penale për të cilën kërkuari është dënuar dhe praktika tjetër konsiston në interpretimin e dispozitës në fjalë, referuar masës së dënimit të dhënë nga gjykata. Ndjekja e dy praktikave nga gjykatat e rretheve gjyqësore nuk është bërë objekt ankimi nga prokurorët e rretheve gjyqësore dhe nga vendimarrjet e të gjithave gjykatave të apeleve nuk vihet re ndonjë qëndrim i qartë në këtë drejtim. Referuar parashikimit të dispozitës në fjalë, sipas interpretimit gramatikor dhe logjik që mund të bëhen në rastin konkret, konstatohet se mund të gjejnë vend të dy praktikat

si më sipër. Kjo është evidentuar edhe nga studimi i kryer nga magistratë në vitin 2010....Aktualisht nga vendimet gjyqësore objekt shqyrtimi në Gjykatën e Lartë, (vendimi nr. 00-2022-1817) datë 03.11.2022) evidentohet një rast kur interpretimi i nenit 64 të K.Penal është bërë objekt trajtimi duke përcaktuar qartë praktikën që duhet të ndiqet sipas vendimit të trupës gjyqës. Rasti në fjalë i përket një vendimi kolegji dhe i përket shqyrtimi të kërkesës së një të dënuari për veprën penale të “ trafikimit të lëndëve narkotike” të parashikuar nga neni 283/a/1 të K.Penal, i dënuar me 4 vjet burgim, për të cilin si gjykata e rrethit gjyqësor Mat dhe Apeli Tiranë në përlllogaritjen e vuajtjes së dënimit kanë mbajtur praktikën e parë, referuar masës së dënimit që parashikon dispozita përkatëse për të cilën është deklaruar fajto dhe dënuar kërkuesi. Nga ana e gjykatës së lartë është vlerësuar se referimi sipas praktikës së parë nuk është interpretim i saktë i nenit 64 të k. Penal, pro interpretimi sipas praktikës së dytë. Një interpretim i tillë i kolegjit penal, referuar të dhënave të administruara për efekt të këtij inspektimi, përkon me praktikën e ndjekur nga një numër i vogël magistratësh dhe pavarësisht se nuk është e karakterit unifikues që mund të jetë e detyrueshme për të gjitha rastet sipas parashikimit të nenit 438/4 të K.Penal, do të ketë impaktin e saj tek magistratët e praktikës tjetër. Ky vendim i kolegjit të gjykatës së lartë do të vlerësohet nga magistratët si burim i të drejtës në drejtim të interpretimit të dispozitës në fjalë, për aq kohë sa për zgjidhjen e këtyre çështjeve, ligji është i paqartë si dhe mungojnë vendimet njësuere nga gjykata e lartë.²⁶

63. Në raportin e paraqitur kundër meje, Inspektorët kanë dalë në qëndrimin që vlerësimi im ka qenë i gabuar, pasi kam aplikuar llogaritjen e kohës së vuajtjes së dënimit, referuar masës së dënimit të dhënë nga gjykata dhe jo asaj që parashikon vepra penale, për të cilën është dënuar kërkuesi. Pra kemi dy qëndrime të ndryshme të Inspektorit për të njëjtin fakt. Një nga praktikat që aplikohet në Gjykata dhe për më tepër edhe nga Gjykata e Lartë, në Raportin Tematik nuk konsiderohet interpretim i gabuar i ligjit, ndërsa kur e zbatoj unë në çështjet e gjykuara prej meje, konsiderohet interpretim i gabuar i ligjit.

64. Në vijim Inspektorët në vlerësimin tematik në të gjitha gjykatat, kanë analizuar momentin kohor që do të merret në konsideratë referuar kohës së paraqitjes së kërkesës në gjykatë. (faqe 173 e raportit) :, Ata shprehen si vijon “ përse i përket këtij drejtimi, konstatohet se janë ndeshur dy qëndrime. Njëri sipas të cilës përlllogaritja e kohës së vuajtjes së dënimit duhet të përfshijë vetëm periudhën kohore deri në datën e paraqitjes së kërkesës dhe tjetra se në këtë përlllogaritje përfshihet jo vetëm periudha deri në datën e paraqitjes së kërkesës, për edhe periudha në vazhdim të shqyrtimit të kërkesës që përfundon me disponimin nga ana e gjykatës me vendimin përkatës. Nga vendimet gjyqësore të gjykatave të rretheve gjyqësore, konstatohet se në pjesën më të madhe nga gjyqtarët mbahet qëndrimi i dytë. Gjithashtu është për tu evidentuar se edhe në vendimarrjet e gjykatës së apelit, edhe kur nuk ka patur ankim lidhur me kushtin në fjalë, nga ana e trupave gjyqësore është arsyetuar duke u mbështetur në mënyrën e të proceduarit të përditësuar lidhur me përlllogaritjen e kohës së vuajtjes së dënimit. . Në një studim të një grupi magistratësh të

²⁶ Raporti Tematik për Inspektimet në gjykata, pjesa vlerësimet e Inspektorit, janë paraqitur si provë në këtë procedim disiplinor.

bërë në vitin 2020 arsyetohet se “.....vlerësojmë se kërkesa , pavarësisht se e bërë në një datë më të hershme se sa lejon afati ligjor, nuk mundet të përbëjë pengesë ligjore kundrejt gjykatës.... Në gjykatën e lartë, vendimi i kolegjeve nr. 00-2023-66 datë 13.01.2023, arsyetohet se shprehja “ personi lirohet me kusht” do të thotë se kërkesa pranohet dhe personi lirohet pasi të zhvillohet një hetim gjyqësor dhe të shpallët vendimi dhe jo në momentin që paraqitet kërkesa. Gjykata ka arsyetuar edhe më tej, se ky kusht i plotësimit të afateve të kërkuara për vuajtjen e dënimit nuk është ngushtësisht i karakterit formal në momentin që paraqitet kërkesa, por se gjykata deri në momentin që personi është në gjykim pranë saj do të duhet të vlerësojë sjelljen e kërkuarit deri në shpalljen e vendimit ndaj të cilit nuk duhet të jetë indiferente.”

.....referuar numrit të vendimeve, evidentohet se qëndrimi mbizotërues është ai i përlllogaritjes së kohës së vuajtjes së dënimit, për efekt të zbatimit të nenit 64 të K.Penal, deri në momentin e shpalljes së vendimit, pas shqyrtimit në themel të kërkesës për lirim me kusht. Një qëndrim i tillë megjithëse logjik dhe në funksion të qëllimit të institutit të lirim me kusht, mbart me vete kujdesin e shtuar që duhet të kenë magjistratët gjyqtarë për të shmangur zvarritjet e paarsyeshme të procesit,...Nga vendimet gjyqësore të trajtuara nuk u evidentuar zgjatje të procesit....

65. Për sa më sipër, në Raportin Tematik evidentohet që inspektorët pranojnë logjikën e përlllogaritjes së kohës së vuajtjes së dënimit në momentin e shpalljes së vendimit nga gjykata dhe jo në kohën e paraqitjes së kërkesës nga kërkuari.

66. Por në raportin e përpiluar kundër meje, shprehen se unë kam gabuar duke llogaritur kohën jo në momentin e paraqitjes së kërkesës, apo akoma më keq, (çështja e të dënuarit {...}) aluduar sikur unë kam llogaritur dhe kryer në një kohë të shpejtë një proces për ulje dënimi, për një të dënuar, i cili në kohën e paraqitjes së kërkesës, i duheshin edhe 8 ditë për të plotësuar $\frac{3}{4}$ e dënimit të kryer, pavarësisht që në vijim kanë konstatuar që ulja e dënimit të dhënë nga gjykata, nuk është aplikuar në gjykimin për lirim me kusht. Konkretisht në faqen 14, paragrafi i fundit i raportit disiplinor Inspektori shprehet “ Duke qenë se në datën e paraqitjes së kërkesës për lirim me kusht 13.09.2021 ende nuk ishte plotësuar koha e nevojshme e dënimit prej $\frac{3}{4}$ -tave prej 3 vjet e 9 muaj (vetëm 3 vjet e 8 muaj e 12 ditë) po në datën 13.09.2021 me vendimin për caktimin e seancës për gjykimin e çështjes penale, gjyqtari {...} ka caktuar seancën gjyqësore të lirim me kusht për në datën 27.09.2021, ora 10:30”. Këto janë dy qëndrime të ndryshme të Inspektorit, ku gjetjet dhe konkluzionet e Raport Tematik në Gjykata, aplikohen dhe analizohen ndryshe në Raportin disiplinor në ngarkimin tim.

67. Inspektori në Raportin e Inspektimit Tematik në Gjykata dhe Prokurori ka analizuar uljet e dënimit gjatë kohës së dënimit, por dilema ka qëndruar në lidhje me llogaritjen e punës së kryer në {...} si ulje dënimi. Në lidhje me uljen e dënimit të dhënë nga gjykata, deri në 90 ditë, sipas nenit 75 të ligjit nr. 2020 për trajtimin e të dënuarve, nuk ka patur asnjë pretendim apo vlerësim të ndryshëm nga praktika e të gjitha gjykatave.

Në vijim në raportin tematik janë analizuar kushte ndaluese.

68. Në lidhje me të qenurit përsëritës, Inspektorët në Raportin Tematik janë shprehur se në praktikë vërehen dy qëndrime, i pari që nuk e zbaton institutin e rehabilitimit dhe i quan të dënuarit përsëritës dhe i dyti që nëse i dënuari është rehabilituar, ai konsiderohet i padënuar. Qëndrimi i dytë është pranuar edhe nga Gjykata e Apelit (faqe 183 e raportit), ku Inspektori është shprehur se “ ... Në studimin pasues të vitit 2020 magjistratët duke ju referuar studimit në vitin 2010 kanë konkluduar se “...Personi i rehabilituar për shkak të ligjit, konsiderohet i padënuar dhe për rrjedhojë nuk do të mundet të interpretohet sikur është recidivisht. Kjo do të thotë se ky subjekt nuk ka ndalesë ligjore për të përfituar nga lirimi me kusht si dënim alternativ.” Pra si në praktikë ashtu edhe në studimet e kryera në këtë rast, personi i rehabilituar nuk konsiderohet përsëritës dhe nuk ka kriter ndalues për të kërkuar lirim me kusht. Në raportin në ngarkimin tij, inspektori e lë të dyshimtë vendimarrjen time për lirimin me kusht të shtetasit {...}, me pretendimin që këtë vlerësim, ende nuk e ka ndarë praktika gjyqësore.

69. Analiza e mësipërme, tregon qartë standartin e dyfishtë të mbajtur nga Inspektorët që kanë hetuar çështjen dhe në vijim Inspektori i Lartë, të cilët për të njëjtat çështje, ndryshe kanë vlerësuar në Raportin Tematik në Gjykata dhe Prokurori dhe ndryshe në procedimin disiplinor të filluar ndaj meje.

Lidhur me themelin e pretendimeve të Inspektorit :

70. Në raportin e paraqitur për masë disiplinore nga Inspektori pretendohet se prej meje në cilësinë e gjyqtarit janë ndërmarrë veprime/mosveprime **të cilat kanë sjellë përfitim të padrejtë për palët në një proces gjyqësor në kundërshtim me ligjin, si pasojë edhe e zbatimit të gabuar të ligjit material dhe procedural.** (*interpretimi i ligjit material, si më sipër analizuar nuk mund të jetë objekt kontrolli nga inspektori*)

Në mbështetje të këtij pretendimi, Inspektori ka analizuar çështjet gjyqësore si vijon:

Në lidhje me lirimin me kusht të të dënuarit {...}.

71. **Inspektori pretendon se “ Në përfundim të gjykimit është vendosur lirim me kusht i të dënuarit {...}, duke urdhëruar pezullimin e pjesës së pavuajtur të dënimit prej 3 muaj e 28 ditë dhe vënien në provë për një periudhë prej 3 muaj e 28 ditë. Vendimi ka marrë formë të prerë në datën 07.11.2018 pa u ankimuar.**

Nga aktet e përcjella nga Prokuroria Sarandë, rezulton se shtetasi {...} është dënuar për veprën penale “ Mosdhënia e mjeteve për jetesë” parashikuar nga neni 125 i K.Penal, me vendimin nr. 195 datë 21.07.2016 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër. Vendimi është

ekzekutuar nga prokurori dhe në vijim është pushuar ekzekutimi për shkak amnistie në datën 25.10.2016.

71.1 Vlerësoj se hetimi i kryer nga Inspektori për të marrë informacion nga Prokuroria e Sarandës, në lidhje me gjendjen gjyqësore të të dënuarit, kërkues në procedurën për lirim me kusht, për mua si trup gjykues të Gjykatës së Gjirokastrës, nuk është i detyrueshëm dhe as i parashikuar në ndonjë dispozitë ligjore, për sa kohë çertifikata e gjendjes gjyqësore tregonte se personi ishte i padënuar më parë. Nëse duhet të kryente ndonjë hetim më të zgjeruar lidhur me gjendjen gjyqësore në Gjykata apo Prokurori të tjera për të dënuarin kërkues, këtë veprim duhet ta kryente Prokurori dhe jo Gjykata.

71.2. Në vijim Inspektori pretendon se “ *Rezulton se i dënuari përveç dënimit për veprën penale që ishte duke vuajtur për të cilën ka kërkuar lirim me kusht, ishte dënuar më parë për kundërvajtjen penale “ Mosdhënia e mjeteve për jetesë” parashikuar nga neni 125 i K.Penal. Dënimi i mësipërm për kundërvajtjen penale nuk përbën një kusht ndaluar nga neni 64/3 të K.Penal, i cili parashikon se nuk lejohet lrimi me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje. Megjithatë, sipas Vendimit Unifikues nr. 2 datë 25.05.2015, në raste të tjera, hetimi mbi gjendjen gjyqësore të të dënuarit duhet të vlerësohet në perspektivën e rrezikut të recidivizmit të tij. Kërkuesi ka qenë i dënuar për veprën penale të dhunës në familje, e cila si në kohën e dënimit dhe aktualisht paraqet një vepër penale që ka një përhapje të gjerë në shoqëri dhe me rrezikshmëri të lartë shoqërore, në drejtim të pasojave më të rënda që vijnë prej këtyre autorëve, megjithëse të dënuarit i kishin mbetur për të vuajtur edhe 3 muaj e 28 ditë burgim nga dënimi i dhënë, pra një kohë që nuk përbën një dënim të konsiderueshëm të mbetur. Nga dosja e gjyqësore e dënimit për veprën penale të dhunës në familje rezulton se kërkuesi nuk e ka pranuar veprën penale, duke pretenduar pafajësi. Gjykata vlerëson dhe qëndrimin e të dënuarit ndaj veprës penale, viktimës apo familjes së viktimës. Sipas raportit të {...} i dënuari e pranon veprën penale, por nuk shprehet për pendesë, çfarë do të thotë se ai nuk është riedukuar, ndërsa përsa i përket normalizimit të marrëdhënieve me viktimën, në këtë rast nuk rezulton të ketë ndodhur edhe pse në zbatim të nenit 31/6 të ligjit nr. 10024, datë 27.11.2008 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”. i ndryshuar, ashtu dhe të vendimit unifikues nr. 2/2015, as raporti vlerësues i Shërbimit të Provës, dhe as vlerësimi i sjelljes nga {...} **Durrës**²⁷, nuk pasqyrojnë informacion për të konfirmuar marrëdhëniet e kërkuesit me viktimën ose me familjarët e viktimës. Gjykata duhet natyrisht ta marrë parasysh si element në favor të kërkuesit, ndërsa në vetvete normalizimi i marrëdhënieve nuk është kusht i domosdoshëm për pranimin e kërkesës për lirim me kusht.*

71.3. Në lidhje me këto pretendime, sqaroj se në dosjen gjyqësore çertifikata e gjendjes gjyqësore, tregonte se i dënuari **nuk ka qenë i dënuar më parë**. Vërtetësia e të dhënave të treguara në çertifikatën për gjendjen gjyqësore, nuk është detyrim hetimi për gjykatën, për sa kohë nuk ngrihet asnjë pretendim nga palët në seancë gjyqësore. Në Raportin për Inspektimin Tematik në Gjykata dhe Prokurori, Inspektori është shprehur se “ *Lidhur me kushtin ndalues përsëritës, verifikimi nga gjykata, referuar vendimeve është bërë duke*

²⁷ Gabim i Inspektorit, pasi i dënuari e ka vuajtur dënimit në {...} Tepelenë dhe jo Durrës

administruar vendimet e dënimit të kërkuarit të administruara nga vërtetimi i gjendjes gjyqësore. kartela personale e të dënuarit të paraqitur nga {...}, raporti i vlerësimit të Shërbimit të Provës dhe duke u mbështetur në akte për llogari të gjykimin.

71.4. Gjithsesi dënimi i mëparshëm i kërkuarit për një kundërvajtje penale, nuk e kushtëzon atë në paraqitjen e kërkesës për lirim me kusht dhe gjykata nuk mund ta konsiderojë përsëritës, në kuptim të ndalimit ligjor të parashikuar në nenin 64 të K.Penal. Sipas nenit 64 të K. Penal, konsiderohet përsëritës dhe nuk mund të përfitojë lirim me kusht, personi i cili është dënuar më parë për një krim të kryer me dashje dhe jo për kundërvajtje penale.

71.5. Në raportin disiplinor Inspektori shprehet : “ *Vendimi nr. 13/21-2018-1692, datë 23.10.2018 i dhënë nga magjistrati {...} ka sjellë përfitim të padrejtë për të dënuarin {...} me lirimin e tij me kusht, i cili nuk ka plotësuar në mënyrë kumulative kushtet objektive dhe subjektive për të përfituar. Edhe pse ka plotësuar kushtet objektive të lirit me kusht, nuk rezulton që me dënimin e vuajtur ishte arritur qëllimi për edukimin dhe integrimin e tij, të cilat duhet të vlerësoheshin nga gjykata si rrethana negative të lirit me kusht, si fakti i dënimit të tij me parë për një veprë penale në vazhdim të asaj të dhunës në familje, natyra e veprës penale të kryer, mospendimi për veprën penale, mosnormalizimin e marrëdhënieve më viktimën e veprës penale, çfarë rrit rrezikun e mosarritjes së mundësisë për integrim të tij në shoqëri dhe recidivizmit të tij për këtë veprë penale. Në bazë të rrethanave të mësipërme vuajtja e dënimit të mbetur do të kishte ndikim me pozitiv në shoqëri dhe tek personi i dhunuar.*

71.6. Sqaroj se me këtë interpretim dhe përfundim të mësipërm, Inspektori ka marrë rolin e një gjykate më të lartë, duke hyrë dhe bërë analizën e provave, plotësimin e kriterit subjektiv në kërkesën për lirim me kusht të të dënuarit {...}, ndryshe nga çfarë ka evidentuar, analizuar dhe vlerësuar në Raportin e Inspektimit Tematik në Gjykata dhe Prokurori. Në këtë raport është vlerësuar nëse gjykatat kanë administruar ose jo raportet e {...}-ve dhe Shërbimit të Provës në lidhje me kërkesën për lirim me kusht, por pa i vlerësuar këto raporte të këtyre Institucioneve, në lidhje me përmbushjen e kriterit subjektiv “arsye të veçanta”.

71.7. Qëndrimi i mësipërm i Inspektorit bie ndesh edhe me praktikën e tij në arsyetimin e vendimeve, kur vendos për arkivimin e ankesave. Konkretisht në vendimin nr. 119/1 prot datë 17.07.2023 “ për Arkivimin e Shqyrtimit Fillestar të ankesave..... Inspektori është shprehur: “ ***Shqyrtimi dhe vlerësimi i pretendimeve të palëve dhe provave gjatë një procesi gjyqësor është atribut vetëm i pushtetit gjyqësor. Vendimet gjyqësore kontrollohen vetëm nga gjykata më e lartë dhe asnjë organ tjetër nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve gjyqësore, për sa kohë ato nuk janë ndryshuar ose prishur nga një gjykatë më e lartë***”.

71.8. Ndërkohë që në vendimarrjen time, Inspektori kapërcen kompetencat e njohura me ligj dhe merr rolin e një gjykate më të lartë. Analizon veprimtarinë, vlerësimin dhe vendimarrjen e komisionit të {...}-së dhe Shërbimit të Provës, e drejtë e njohur vetëm gjykatës që shqyrton

kërkesën për lirim me kusht, ose të një gjykate më të lartë që investohet mbi ankimin e palëve ndërgjyqëse.

71.9. Sqaroj se të gjitha “gjetjet” e Inspektorit në analizimin e kushteve subjektive, i kam evidentuar, marrë në shqyrtim, analizuar dhe i kam vlerësuar sipas bindjes sime të brendshme, e pranuar nga të gjitha palët ndërgjyqëse në gjykim.

71.10. Në raportin disiplinor Inspektori gjithashtu, shprehet si vijon (faqe 18 paragrafi. 2): “ *Në bazë të vërtetimit të gjendjes gjyqësore nr. 17, datë 20.8.2018 që gjendet në dosjen e lirimimit me kusht rezulton se {...} është i padënuar, ndërkohe që përfundimi i dënimit të tij për veprën penale të "Mosdhënia e mjeteve për jetesë", konsiderohet data 19.2.2017, kur ka dalë urdhri i prokurorit për pushimin e ekzekutimit të dënimit për shkak të amnistisë. Pra, shtetasi {...} do të rezultonte i padënuar, pasi të kishte kaluar dhe periudha e rehabilitimit prej 2 vitesh nga data 19.2.2017, që do të thotë pas datës 19.2.2019.*

71.11. Sqaroj se ky interpretim i Inspektorit, jo vetëm që është në kundërshtim me ligjin, por edhe me vlerësimet që ai jep në këtë raport. Shuarja e ekzekutimit të dënimit penal me amnisti, nuk shuan dënimin penal të personit, por vuajtjen e këtij dënimi. Në këto kushte, dënimi penal “Mosdhënia e mjeteve për jetesë” të kërkuesit {...} duhet detyrimisht të ishte regjistruar në regjistrin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe çertifikata e gjendjes gjyqësore duhet ta kishte të pasqyruar këtë dënim penal. Pra gabimi që çertifikata e gjendjes gjyqësore e të dënuarit {...} tregonte i padënuar më parë, është i Institucioneve që kanë për detyrë përcjelljen e vendimit të dënimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe e kësaj të fundit për mospasqyrim në çertifikatën që lëshon. Pavarësisht kësaj, ky dënim penal për kundërvajtje penale nuk e konsideron kërkuesin {...} përsëritës në kuptim të nenit 64 të K. Penal “Lirimi me kusht”. Këtë fakt e ka konstatuar dhe shprehur Inspektori në raportin disiplinor dhe e vlerësoj të paarsyeshme dhe jo logjike llogaritjen e kohës, se kur i dënuari {...} do të konsiderohej i rehabilituar nga dënimi penal “Mosdhënia e mjeteve për jetesë”.

Në lidhje me plotësimin e kriterëve objektive:

71.12. Kërkuesi plotësonte kërkesat e nenit 477 të K.Pr.Penale, duke drejtuar kërkesën në gjykatën kompetente të vendit të ekzekutimit, si dhe nuk kishte kryer kërkesë të mëparshme për lirim me kusht, brenda afatit 6 mujor nga paraqitja e kërkesës në shqyrtim. Në lidhje me nenin 64, kërkuesi rezulton se kishte plotësuar 2/3- tat apo 3/4-tat e dënimit të dhënë nga gjykata. I dënuari nuk konsiderohet përsëritës në kuptim të nenit 64 të K. Penal. Çertifikata e gjendjes gjyqësore e paraqitur në gjykim tregonte se ka qenë i padënuar më parë. Pas hetimeve të kryera, Inspektori ka zbuluar se kërkuesi ka qenë i dënuar më parë për një kundërvajtje penale, por që sipas ligjit nuk përbën kusht ndaluar për përfitimin nga e drejta për lirim me kusht. (*shprehje e prokurorit në raport*)

71.13. Në raportin e {...} **Tepelenë** me objekt “ Lirim me kusht”, ky institucion në konkluzion është shprehur se “ *...lidhur me vlerësimin e mësipërm për sjelljen dhe qëndrimin e të dënuarit gjatë vuajtjes së dënimit, komisioni i vlerësimit të sjelljes shprehet për pranimin e kërkesës për lirim me kusht*”.

Shërbimi i Provës në raportin e vlerësimit është shprehur se “*Shërbimi i provës është dakort që nga gjykata të jepet dënimi alternativ i kërkuar lirim me kusht, sipas nenit 64 dhe 477 të K.Pr.Penale.*”

71.14. Krahas vlerësimeve pozitive të Institucioneve të mësipërme, kërkuesi paraqiti në gjykim prova se kishte krijuar një familje të re, vajza e tij në ndjekje të arsimit kishte nevojë për përkujdesje financiare, karakteristika nga Kryetari i Bashkisë Delvinë ishte pozitive, shoqëria “ Vëllezërit{...}”: merrte përsipër punësimin e tij, etj.

Në konkluzionet përfundimtare, kërkuesi kërkoi pranimin e kërkesës, {...} kërkoi pranimin e kërkesës, Shërbimi i Provës kërkoi pranimin e kërkesës, Prokurori kërkoi pranimin e kërkesës. Gjykata vendosi pranimin e kërkesës. Kundër vendimit nuk është ushtruar ankim dhe vendimi ka marrë formë të prerë.

71.15. Në lidhje me interpretimet subjektive të Inspektorit për përhapjen e fenomenit të dhunës në familje dhe masat që duhen të merren, këto qëndrim të këtij Institucioni duhet të adresohen në Institucionet kompetente të Shtetit, ekzekutiv dhe/ose legjislativ, por jo në gjykatë. Në faqen nr. 205 të Raportit për Inspektimin Tematik në Gjykata dhe Prokurori, Inspektori është shprehur se “ *Inspektori i Lartë i Drejtësisë mban në konsideratë faktin se përcaktimi i politikave penale është kompetencë ekskluzive e pushtetit legjislativ dhe për rrjedhojë parashikimi i rregullave apo normave në lidhje me institutin e lirimit me kusht, është një e drejtë e organit legjislativ. i cili gëzon një hapësirë të gjerë vlerësimi dhe është në diskrecionin e tij, brenda konceptit të politikës penale....*” Çuditërisht mënyrën dhe Institucionin që përcakton politikën penale, Inspektori e di dhe mban në konsideratë vetëm në Raportin e Inspektimit Tematik, sepse në Raportin disiplinor ndaj meje, ka një qasje të ndryshme.

71.16. Sa më sipër vlerësoj se nuk ka asnjë shkelje në gjykimin dhe vendimarrjen për lirimin me kusht të të dënuarit {...}. Nuk është shkelur asnjë kriter ligjor objektiv i parashikuar nga nenet 477 të K.Pr.Penale dhe 64 të K.Penal, si dhe në analizë të provave, gjykata ka vlerësuar se me pjesën e vuajtur të dënimit, është arritur qëllimi i rehabilitimit të të dënuarit {...}.

Në lidhje me procedurën për lirimin me kusht të të dënuarit {...}.

72. Rezulton se i dënuari {...} ka paraqitur fillimisht kërkesë për lirim me kusht në datën 28.01.2021. Ky kërkues ka hequr dorë nga kërkesa, me pretendimin se do ta ngrinte në një moment tjetër. Në këto kushte duke e vlerësuar të drejtë të kërkuesit investimin e gjykatës dhe vijimin ose jo të gjykimit, kam vendosur pushimin e gjykimit në datën 30.03.2021. Vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar.

72.1. Inspektori në analizën e tij, analizon dhe vlerëson se përse ka hequr dorë kërkuesi nga kërkesa për lirimin me kusht, dhe “ka zbuluar” se nuk plotësonte kohën e detyrueshme me ligj prej 3/4 të dënimit. Nuk gjej shkak ligjor se përse duhen analizuar shkaqet e heqjes dorë

të kërkuesit {...} nga kërkesa për lirim me kusht, kur investimi i gjykatës dhe vijimi ose jo i gjykimit, janë e drejtë ekskluzive vetëm e të dënuarit.

72.2. I dënuari {...} ka paraqitur në gjykatë në datën 02.09.2021, kërkesën për Lirim me Kusht. Ndërkohë që rezultoi se në datën 12.09.2021 ka paraqitur edhe kërkesën për “Ulje Dënimi”. Për shkak të lejes vjetore të Gjykatës, sipas Urdhërit nr. 61 datë 30.07.2021 të Drejtuesit të Gjykatës, çështjet e grumbulluara gjatë kësaj periudhe leje, janë shortuar në datën 13.09.2021. Në këto datë janë shortuar edhe kërkesa për lirim me kusht dhe ulje dënimi të kërkuesit {...}. Këto dy çështje më kanë rënë mua për gjykim, procedurë shorti e verifikuar nga Inspektori dhe për të cilën nuk ka ngritur asnjë pretendim.

Në lidhje me kërkesën për ulje dënimi të të dënuarit {...}, sqaroj si vijon:

73. I dënuari {...} ka paraqitur kërkesën me objekt: “Uljen e dënimit në masën 90 ditë”. Lidhur me këtë kërkesë, në konkluzionet përfundimtare, përfaqësuesi i {...} ka kërkuar pranimin e kërkesës, po ashtu dhe Prokurori ka kërkuar pranimin e kërkesës. Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës. Vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar nga asnjë nga palët.

73.1. Inspektori pretendon se gjykata ka arsyetuar mbi një dispozitë të shfuqizuar, nenin 63 të ligjit 9323/1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, ndërkohë që në kohën e gjykimit ka qenë në fuqi ligji nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe paraburgosurve”, neni 75. Inspektori mbi këtë konstatim shprehet se nga gjykata është arsyetuar mbi një dispozitë të shfuqizuar për të përfituar në mënyrë të padrejtë këtë lloj ulje dënimi.

73.2. Sqaroj se ky pretendim është absurd dhe i pabazuar në të dhënat e treguara në vendimin e gjykatës. Referuar vendimit të gjykatës, rezultoi se në pjesën “Ligji i zbatueshëm”, janë shënuar dy dispozita ligjore me përmbajtjen e tyre: e para neni 480 i K.Pr.Penale **dhe e dyta, neni 75 i ligjit nr. 81/2020**. Dhe në vijim të arsyetimit gjykata i është përmbajtur kriterëve të treguara në nenin 75 të ligjit 81/2020.

73.3. Në seancën e zhvilluar në KLGJ në datën 19.03.2024, Inspektori është shprehur se kriteret e analizuara nga gjykata në vendimin për ulje dënimi janë ato të parashikuara nga neni 63 i ligjit nr. 8328/1998 dhe jo ato të nenit 75 të ligjit nr. 81/2020.

73.4. Në nenin 63 të ligjit 8328/1998 parashikohej se “*Të dënuarit që zbatojnë rregullat dhe kanë pjesëmarrje shembullore në veprimtaritë trajtuese, duke dhënë prova për riintegrim në shoqëri, mund të përfitojnë një ose disa ulje, deri në 90 ditë në çdo vit të vuajtjes së dënimit....*”

Në nenin 75 të ligjit nr. 81/2020 parashikohet se “*I dënuari që zbaton rregullat e brendshme të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale dhe ka një sjellje të mirë duke e treguar me pjesëmarrje aktive dhe pozitive në veprimtaritë rehabilituese dhe riintegruese gjatë*

kryerjes së dënimit, bazuar në raportin e vlerësimit, që përgatitet nga institucioni, mund të përfitojë ulje dënimi deri 90 ditë në çdo vit të kryerjes së dënimit.....”

73.5. Vlerësoj se këto dy dispozita nuk kanë asnjë ndryshim në kriteret që duhet të plotësojë i burgosuri për të përfiturar ulje dënimi. Pretendimi i Inspektorit në seancë se janë aplikuar kriteret e nenit 63 dhe jo 75 të ligjit nuk qëndrojnë, pasi gjykata ka analizuar dhe zbatuar drejtë kriteret e parashikuar në ligj.

73.6. Ajo që vërehet në vendimin e gjykatës dhe që Inspektori e tregon në vijim, është se në rubrikën ku gjykata shprehet :

Sa më sipër:

Gjykata bazuar në nenin 480 të K.Pr.Penale dhe nenin 63 të ligjit nr. 8328/1998 “ për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”;

VENDOSI:

është referuar gabim baza ligjore neni 63 i ligjit nr. 8328/1998 (*treguar me bold më sipër*) dhe këtë gabim material Inspektori e quan shkelje të rëndë procedurale, zbatim të gabuar të ligjit, me pasojë përfitimin e padrejtë të të dënuarit {...}.

73.7. Kjo është një qasje tërësisht e gabuar e inspektorit, pasi gjetja e mësipërme është gabim material, i mbetur nga vendime të mëparshme, kur aplikohet ligji nr. 9323/1998 “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim*” Këto gabime materiale janë aq të parëndësishme, sa as palët dhe as gjykata kryesisht nuk merren me korrigjimin e tyre, sipas nenit 385 të K.Pr.Penale. Këto gabime vërehen në punën e çdo magjistrati, ashtu si edhe Inspektori ka gabuar në këtë raport disiplinor tek referimi i rastit të {...}t, ku ka referuar {...} **Durrës** dhe jo {...} Tepelenë. Gabimi material i mësipërm nuk ka asnjë rëndësi, pasi edhe nëse nuk do të ishte vendosur asnjë paragrafi i tillë në atë pjesë të vendimit, përsëri vendimi do të ishte i vlefshëm. Në arsyetim të vendimit, është përmendur dhe referuar në dispozitën e drejtë dhe në fuqi, nenin 75 të ligjit nr. 81/2020.

73.8. Në vijim inspektori në çështjen për uljen e dënimit, shprehet se “ *Shtetasi {...} ka paraqitur kërkesë për ulje dënimi në të njëjtën datë, pasi në datën e paraqitjes së kërkesës për lirim me kusht 13.9.2021 ende nuk ishte plotësuar koha e nevojshme e dënimit prej 3/4 prej 3 vjet e 9 muaj (vetëm 3 vjet 8 muaj 12 dite). Po në datë 13.09.2021, me vendimin "Për caktimin e seancës për gjykimin çështjes penale", gjyqtari {...} ka caktuar seancën gjyqësore të lirimit me kusht për në datë 27.09.2021, ora 10:30 dhe ndërkohë para kësaj seance, ka përfunduar menjëherë gjykimin e uljes së dënimit me 90 ditë në datën 23.9.2021 (për 10 ditë), që do të thotë se në çdo rast tashmë shtetasi {...} para seancës së lirimit me kusht, e kishte te plotësuar kohën e vuajtjes së dënimit (pasi në datën 27.9.2021 ende nuk e plotësonte këtë kohë).*

73.9. Sqarohet se ky është një interpretim i gabuar i Inspektori, që bie ndesh edhe me gjetjet dhe faktet që paraqet si në vijim të raportit të tij disiplinor, ashtu edhe në Raportin e Inspektimit Tematik në Gjykata dhe Prokurori.

73.10. Me marrjen e dosjeve të shortuara nga sekretaria gjyqësore kam proceduar me caktimin e seancës gjyqësore. Rezulton se të gjitha gjykimet me objekt ulje dënimi, që kam zhvilluar gjatë ushtrimit të profesionit të gjyqtarit, janë zhvilluar në afatin kohor 10 dite deri në maksimum 25 ditë nga dita e shortimit të tyre në gjykatë. Në të gjitha vendimet kam vendosur uljen e dënimit me 90 ditë. Nuk kam patur pretendime nga palët dhe nuk kam gjetur arsye ligjore dhe as ndonjë skemë ligjore vlerësimi, se përse duhet të ulja dënimin në një masë më të ulët se 90 ditë, për më tepër kur {...} shprehet për pranimin e plotë të kërkesës. Ulja e dënimit ka efekt jo vetëm human, por edhe e motivon të dënuarin dhe të dënuarit e tjerë që të sillen mirë, në vijim të kohës së vuajtjes së dënimit. Nëse gjykata do të ndërhyjë pa shkak ligjor dhe prova, atëherë do të cënonte një të drejtë të të dënuarve dhe cënonte qëllimin e këtij instituti ligjor.

73.11. Aludohet nga Inspektori se unë kam kryer me shpejtësi këtë gjykim, që i dënuari të plotësonte afatin prej 3/4 të dënimit të kryer, për të përfituar lirimin me kusht. Sqarohet se në datën e shortimit të çështjes 13.09.2021, i dënuari sipas llogaritjes së Inspektorit kishte kryer 3 vjet 8 muaj e 12 ditë burgim. Sipas Inspektorit i duheshin për të përftuar nga lirimi me kusht, kryerja e 3 vjetëve e 9 muajve, duke i llogaritur me koeficientin e 3/4-ve të dënimit që parashikon dispozita penale që është dënuar. Pra sipas Inspektorit në datën e paraqitjes së kërkesës për librim me kusht, i duheshin edhe 19 ditë që të plotësonte afatin e parashikuar në ligj. Kërkesa është paraqitur në datën 12.09.2021 dhe vendimi është shpallur në datën 21.10.2021, pra 39 ditë më pas. Në këto kushte, në datën e shpalljes së vendimit i dënuari {...} kishte kryer 3/4 e dënimit prej 5 vitesh, si dhe 20 ditë më shumë.

73.12. Në këtë qëndrim, Inspektori është në kundërshtim me gjetjet, vlerësimet dhe orientimet që jep në Raportin Tematik të Inspektimit në Gjykata për gjykimet me objekt librimin me kusht. Në këtë raport, Inspektori evidenton se ka dy qëndrime të gjykatave ku një qëndrim aplikon koeficientin 2/3 ose 3/4 mbi dënimin e dhënë nga gjykata, dhe një pjesë tjetër duke e aplikuar mbi dënimin që parashikon dispozita penale. Vetë inspektori referon se ka një vendim të Gjykatës së Lartë, që aplikon koeficientin mbi dënimin e dhënë nga gjykata dhe jo duke marrë për bazë dënimin që parashikon dispozita penale.²⁸

73.13. Gjithsesi në rastin në shqyrtim, ashtu siç u shpreh edhe Inspektori në seancën e zhvilluar në datën 19.03.2024, unë kam aplikuar koeficientin e 3/4 të dënimit dhe jo 2/3, që gjithsesi edhe nëse do të aplikohet 2/3-tat e dënimit, përsëri do të ishte në zbatim të drejtë të ligjit dhe sipas praktikës së Gjykatës së Lartë. Dy të tretat e dënimit të kryer, i dënuari {...} i kishte plotësuar në datën 11.04.2024, pra 12 ditë pasi gjykata për kërkesën e parë ka vendosur pushimin e çështjes. **Inspektori “harron” të evidentojë dhe përmend faktin, që ulja e dënimit me 90 ditë, as ka qenë e nevojshme dhe as është aplikuar/llogaritur nga**

²⁸ Faqja 169 e vijues e Raportit të Inspektimit Tematik në Gjykata dhe Prokurori.

gjkata në gjykimin dhe vendimin e dhënë për lirimin me kusht të kërkuarit {...}. Atëherë kur kjo ulje dënimi nuk ka qenë e nevojshme si dhe nuk është aplikuar, përse sipas Inspektorit duhet që gjykata kryesisht të kryente gjithë ato “manovra” të kundërligjshme, kur ishin të panevojshme?

73.14. Sqaroj se i dënuari {...} ka qenë i dënuar me 5 vite burgim. Sipas praktikës gjyqësore të ndjekur nga **Gjykata e Lartë me vendimin nr. 00-2022-1817 datë 03.11.2022**, i dënuari {...} për të përfutur lirimin me kusht, duhet të plotësonte 2/3-tat e 5 viteve burgim, të dhënë nga gjykata. Aplikuar 2/3-tat e dënimit të dhënë nga gjykata, i bie që në datën e paraqitjes së kërkesës, i dënuari duhet të kishte vuajtur 40 muaj burgim, ose 3 vjet 4 muaj burgim. Rezulton se {...} në datën e paraqitjes së kërkesës për lirim me kusht 13.09.2021, sipas llogaritjes së Inspektorit kishte vuajtur 3 vjet 8 muaj e 12 ditë. Pra 4 muaj e 12 ditë më shumë.

73.15. Gjithsesi në momentin e shpalljes së dënimit, i dënuari i kishte plotësuar edhe 3/4 e dënimit prej 5 vite burgim, plus 20 ditë burgim më tepër. Debatin juridik se cili koeficient duhet të aplikohet dhe mbi bazën e dënimit të dhënë nga gjykata apo asaj që parashikon dispozita ligjore, nuk e vendos dot as Inspektori dhe as ndonjë organ tjetër, përveç, gjykatave më të larta {...}, mundësisht Gjykata e Lartë me vendim njësuës.

Për sa kohë plotësimin e kohës së dënimit e kam vlerësuar në momentin e shpalljes së vendimit, si dhe mosaplikimin e uljes së dënimit me 90 ditë në vendimin për lirimin me kusht, atëherë çdo aludim i Inspektorit për interes në këtë çështje, është i pavërtetë.

73.16. **Por ajo që është më e çuditshme, është gjetja e Inspektorit, e treguar në paragrafin e fundit të raportit disiplinor ku shprehimish thotë “ Vendimi i uljes së dënimit me 90 ditë, rezulton se është dhënë pa një raport vlerësimi nga {...} për të përfutur maksimumin për kërkuarin sipas nenit 75 të ligjit nr. 81/2020 dhe rregullores së përgjithshme të burgjeve nr.303, datë 25.3.2009, pasi i vetmi vlerësim në këtë periudhë pas vendimit të dënimit të formës së prerë është ai i periudhës si i paraburgosur 27.07.2020-27.01.2021.**

73.17. Referuar dosjes gjyqësore, rezulton se ndodhet i administruar “ **Raport Vlerësimi me objekt Lirim me Kusht**” nr. 155 prot., datë 20.09.2021. Në këtë raport në konkluzionet përfundimtare, {...} Tepelenë është shprehur “ *Mbështetur në vlerësimin e mësipërme Komisioni i vlerësimit të sjelljes shprehet për të dënuarin se karakterizohet nga personalitet pozitiv dhe social, shprehet i motivuar dhe bashkëpunues për arritjen e objektivave të trajtimit. Komisioni për sa më sipër shprehet për pranimin e plotë të kërkesës. Pra, në procesin gjyqësor për uljen e dënimit të të dënuarit {...} është paraqitur dhe është administruar, raporti i vlerësimit i kryer nga {...}, posaçërisht për kërkesën për lirim me kusht. Bazuar në konkluzionet e raportit, Gjykata ka vendosur pranimin e plotë të kërkesës, siç e ka kërkuar edhe {...} Tepelenë.*

73.18. Theksoj se ulja e dënimit për të dënuarin {...} i është nënshtruar fillimisht shortit elektronik, është gjykuar brenda afatit të parashikuar në ligj, është gjykuar në prani të palëve të detyrueshme me ligj, janë administruar provat shkresore të nevojshme, janë dëgjuar

vlerësimet pozitive për pranimin e plotë të kërkesës nga të gjitha palët ndërgjyqëse, është shpallur vendimi përfundimtar, i cili ka marrë formë të prerë. Vlerësoj se nuk ka asnjë shkelje procedurale apo vlerësim të gabuar të të drejtës materiale.

Në lidhje me lirimin me kusht të të dënuarit {...}.

74. Inspektori shprehet se gjykata nuk ka kryer përlllogaritje të dënimit të kryer, por është bazuar vetëm në dinamikën e vuajtjes së dënimit të paraqitur nga {...}. Sipas dinamikës së vuajtjes së dënimit, {...} shprehet se të dënuarit i kanë mbetur pa vuajtur deri në datën 22.09.2021, 1 vit, 1 muaj e 20 ditë burgim. Inspektori kryen vetë llogaritjet dhe del në konkluzionin se i kanë mbetur për të vuajtur 1 vit e 2 muaj e 8.5 ditë, duke plotësuar kështu kushtin prej $\frac{3}{4}$ -ve të parashikuar në nenin 64 të K.Penal. Në këtë llogaritje Inspektori i ka ulur të dënuarit **kohën e përfituar me punë** prej 1 muaj e 18 ditë. Ky fakt jepet ne raportin disiplinor ne paragrafin 22.16 në faqen 42.

74.1. Sqaroj se për aq kohë sa i dënuari {...} plotëson kriterin e $\frac{3}{4}$ të dënimit, aq më shumë të $\frac{2}{3}$ -tave të dënimit të dhënë nga gjykata, e shoh të panevojshme dhënien e shpjegimeve në lidhje me përfshirjen ose jo të kohës së përfituar nga puna e kryer, e të dënuarit. Gjithsesi në Raportin Tematik në faqen 176, Inspektori ka evidentuar praktika të ndryshme në gjykata, ku disa gjykata lejojnë uljen e dënimit për shkak të punës së kryer dhe disa gjykata nuk e aplikojnë. Në këtë raport Inspektori shprehet se “ *... lidhur me përfshirjen e kohës së punës. konstatohet se janë evidentuar në dy raste çështje të përfshirjes së uljes së dënimit në zbatim të ligjit për trajtimin e të dënuarve. Në një rast rezulton se pretendimi është ngritur nga prokurori në gjykatën e rrethit gjyqësor dhe në një rast tjetër në Gjykatën e Apelit. Lidhur me këto dy raste, gjykatat kanë mbajtur qëndrimin e përfshirjes së uljes së dënimit në përlllogaritjen e masës së dënimit të vuajtur që kërkohet për të përfituar mundësinë e lirimit me kusht, si një përfitim që nuk përjashtohet nga ligji penal. Një nga këto raste, mbi rekursin e prokurorit është bërë objekt shqyrtimi edhe nga Gjykata e Lartë, (vendimi nr. 00-2022-1785 datë 22.12.2022) e cila ka mbajtur të njëjtin qëndrim si edhe gjykatat si më sipër, duke argumentuar se "Në zbatim të nenit 64 të Kodit Penal. Kolegji evidenton se ligji në lidhje me masën e dënimit të vuajtur parashikon vetëm se nuk përfshihet koha e përfituar nga i dënuari me amnisti apo me falje. Në rastin konkret, i dënuari rezulton se ka përfituar ulje dënimi në zbatim të ligjit për trajtimin e të dënuarve, përfitim ky që nuk përjashtohet nga ligji penal (neni 64 i cituar më lart)". Dhe në përfundim Inspektori shprehet “ **Në këto kushte është e rëndësishme autoriteti i Gjykatës së Lartë për unifikimin e vendimarrjes së gjykatave të zakonshme**”*

74.2. E referova analizën e mësipërme, vetëm për të provuar dualitetin e qëndrimeve të Inspektorit, sipas Raportit të Inspektimit Tematik dhe Raportit disiplinor në ngarkimin tim. Gjithsesi i dënuari {...}, në momentin e shpalljes së vendimit për librim me kusht, kishte plotësuar me vuajtje efektive, kohën e nevojshme maksimale prej $\frac{3}{4}$ të dënimit, pa llogaritur

punën e kryer apo uljen e dënimit me 90 ditë të dhënë nga gjykata, në të njëjtën kohë që shqyrtohej edhe kërkesa për lirim me kusht.

74.3. Inspektori në vijim shprehet se “ *Por, sipas vlerësimeve periodike 6 mujore të {...} Tepelene kërkuesi gjatë gjithë qëndrimit në {...} nuk e ka pranuar veprën penale, ka pasur masë disiplinore, ndërsa në vlerësimin e sjelljes që është paraqitur në gjykatë me nr. 164, datë 7.10.2021, kërkuesi është vlerësuar nga institucioni i vuajtjes së dënimit negativisht dhe me qëndrim për rrëzimin e kërkesës, duke e konsideruar përsëritës. Gjithashtu, nga shërbimi i provës me raportin nr. 292, datë 11.10.2021 konkludohet se për të dënuarin {...} nuk është arritur qëllimi për riedukimin dhe rehabilitimin e tij, duke e lenë në çmim të gjykatës, duke u shprehur se mundësia për t'u integruar në familje e shoqëri është një mundësi normale e vështirë, por edhe mundshme.*”

74.4. Sqaroj se ky vlerësim i Inspektori është në tejkallim të kompetencave të tij, pasi i hyn analizës së provave dhe vendimarrjes së gjykatës, në lidhje me plotësimin e kriterit subjektiv “arsye të veçanta”. Analiza e provave është atribut vetëm i gjykatës dhe mund të vlerësohet vetëm nga një gjykatë më e lartë. Kriteri subjektiv i “arsyeve të veçanta”, si vlerësim i provave nga gjykata, është pranuar nga Inspektori edhe në Raportin Tematik në gjykata, ku nuk ka asnjë analizë të mënyrës së vlerësimit të këtij kriteri nga gjykatat në RSH. (*treguar në pjesën hyrëse të këtij materiale kundërshtues*)

Rezulton se Inspektori ka tejkalluar kompetencat, duke vlerësuar provat dhe vendimarrjen e gjykatës. Për më tepër shtrembëron dhe referon gabim me dashje, provat e shqyrtuara nga gjykata dhe konkretisht:

74.5. **Në raportin e {...} Tepelenë “ Vlerësim sjellje për në gjykatë, me objekt: Lirim me kusht” nr. 164 prot., datë 07.10.2021, komisioni i {...} Tepelenë, i përbërë nga 5 anëtarë, ku kryetar është përgjegjësi i sektorit ligjor, përfaqësues i {...} edhe në seancë gjyqësore, në konkluzionet përfundimtare është shprehur : Mbështetur në vlerësimin e mësipërm, Komisioni i vlerësimit të sjelljes, shprehet për të dënuarin {...} se karakterizohet nga personalitet pozitiv dhe social, shprehet i motivuar dhe bashkëpunues për arritjen e objektivave të trajtimit. Shpreh motivim për programet e punësimit. Mundohet të ketë aftësi vetëmenaxhuese të riskut të vetë. Bazuar dhe tek dosja psiko-sociale, i dënuari ka patur sjellje dhe qëndrim korrekt. Por Komisioni për sa më sipër shprehet për rrëzimin e kërkesës, për arsyen se i dënuari është përsëritës.**

74.6. Gjykata në vendimarrje i është referuar Raportit të Vlerësimit të kryer nga Komisioni i {...} Tepelenë, në vlerësim të kërkesës për lirim me kusht, të kryer nga i dënuari {...}. Nuk ka patur asnjë shkak ligjor gjykata që të verifikojë kryesisht ndër vite sjelljen e të dënuarit dhe nëse kjo sjellje i përshtatet dhe është pasqyrim i vlerësimit përfundimtar të kryer nga {...}. Këtë detyrë e ka patur dhe e ka ushtruar {...}, e cila në vlerësimin e kryer, ka marrë në shqyrtim gjithë sjelljen në {...} të të dënuarit, duke e vlerësuar atë pozitive. Gjykata prezumon se institucioni i {...} si çdo institucion tjetër penitenciar, zbaton me korrektësi

ligjin dhe personat përgjegjës, duke patur njohurinë e duhur profesionale dhe ligjore, japin mendim të specializuar, të pandikuar nga situata jo ligjore. Asnjë nga palët në gjykim, nuk kontestoi vlerësimin e sjelljes të kryer nga {...} ndaj të dënuarit {...}.

74.7. I pyetur në gjykim se përse {...} kërkon rrëzimin e kërkesës, përfaqësuesi i {...}-së, që rezultoi se është edhe Kryetari i Komisionit Vlerësues, u shpreh se kjo kërkesë vjen si pasojë sepse ata e konsiderojnë të dënuarin përsëritës dhe jo si pasojë e sjelljes së tij në {...}, e vlerësuar prej tyre pozitive. Në kushtet kur si më sipër arsyetuar, gjykata e konsideroi të dënuarin {...}, jo përsëritës në kuptim të nenit 64 të K.Penal, atëherë raporti i vlerësimit të {...}-së do të konsiderohet pozitiv për të dënuarin, sipas vlerësimit të kryer nga Komisioni përkatës.

Inspektori shprehet se i dënuari ka patur më parë një masë disiplinore. Në lidhje me interpretimin e kushtëzimit për të përfutur lirim me kusht, për shkak të pasjes më parë të një mase disiplinore, unë kam analizuar në çështjen penale “lirim me kusht” për të dënuarin {...}. Edhe kjo çështje ka qenë objekt shqyrtimi nga Inspektori, por si duket interpretimi i gjykatës nuk i përshtatej interpretimit që duhet ti bënte masës disiplinore të dhënë ndaj të dënuarit {...}.

74.8. Në vendimin për lirim me kusht të të dënuarit {...}, hetuar nga Inspektori në kuadër të këtij procedimi, është evidentuar pasja e një mase disiplinore. Gjykata është ndalur në këtë rast dhe ka analizuar si vijon: “Rezulton se me vendimin nr. 8 datë 06.09.2017 ndaj kërkuesit {...} është dhënë masë disiplinore “Përfutur nga veprimtari të përbashkëta 10 ditë”, me motivacionin “ moszbatimi i urdhërave ose vonesa e pajustificuar në zbatimin e tyre, parashikuar nga neni 53 i ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “ Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

Rezulton se në vlerësimin e sjelljes 6-mujore, mbajtur në datën 07.11.2016, ndaj kërkuesit janë dhënë vlerësime pozitive sjelljen e tij në {...}. Të njëjtin vlerësim pozitiv ka ndaj kërkuesit edhe në vlerësimin 6-mujor të kryer në datën 07.05.2017. Vlerësim pozitiv ka patur ndaj kërkuesit edhe në vlerësimet 6-mujore të kryer në datën 07.05.2018 dhe datën 07.11.2018.

Gjykata konstaton se në nenin 54/2 të ligjit nr. nr. 8328 datë 16.04.1998 “ Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, parashikohet se “Masat disiplinore evidentohen në regjistrin e masave disiplinore, në dosjen psiko-sociale dhe në dosjen personale të të dënuarit. Ato konsiderohen të pathëna, në rast mos përsëritjeje për një periudhë 6-mujore për shkronjat “a” dhe “b”, të nenit 53, dhe për një periudhë 1-vjeçare për shkronjat “c”, “ç”, dhe “d” të nenit 53.

Në nenin 53 të ligjit të mësipërm parashikohet se “1. Për shkeljet disiplinore zbatohen këto masa: a) këshillim individual; b) Vërejtje në prani të të paraburgosurve dhe të dënuarve; c) Përfutur nga veprimtari të veçanta, të përbashkëta deri në 10 ditë; ç) Përfutur nga ajrosja në grup për jo më shumë se 20 ditë; d) Përfuturimi nga të gjitha veprimtaritë e përbashkëta deri në 20 ditë;

Rezulton se ndaj kërkuesit është dhënë masa disiplinore e parashikuar në pikën “ c” të nenit 53 të ligjit nr. 8328/1998. Sipas nenit 54/2 të po të njëjtit ligj, parashikohet se kjo masë konsiderohet e padhënë, në rast mospërsëritje për një periudhë 1 vjeçare. Rezulton se masa është dhënë në datën 06.09.2017. Deri në datën e zhvillimit të këtij gjykimi, kanë kaluar nga dhënia e masës 1 vit e 5 muaj dhe vlerësimet e mëposhme të {...} kanë qenë të gjitha pozitive.

Në këto kushte, bazuar në dispozitat ligjore të mësipërme, gjykata e konsideron masën disiplinore të dhënë ndaj kërkuesit {...} në datën 06.09.2017, si të padhënë dhe për këtë shkak, kërkuesi nuk mund të konsiderohet si i dënuar ndaj të cilit gjatë vuajtjes së dënimit nuk është dhënë ndonjë masë disiplinore.

Sa më sipër, gjykata e vlerëson pozitive sjelljen e të pandehurit në {...} Tepelenë dhe së bashku me raportin e kryer nga Shërbimi i Provës, Gjirokastër, e vlerëson pozitivisht sjelljen e kërkuesit në raport me kërkimet e ligjit, për aplikimin e lirimimit me kusht.

74.9. E ritheksoj edhe njëherë, që referuar raportit disiplinor të Inspektorit, kjo çështje ka qenë objekt inspektimi, por nuk i ka shërbyer Inspektorit që të kishte në konsideratë faktin që masat disiplinore të dhëna nga {...} ndaj të dënuarve, konsiderohen të padhëna me kalimin e afatit të parashikuar në ligj. Gjithsesi analizën e gjithë sjelljes së të dënuarit, e bën komisioni i ngritur për të përgatitur raportin e {...}-së, në lidhje me kërkesën për lirim me kusht. Vetëm në rast se ka pretendime nga palët në gjykim, lidhur me vlerësimin e kryer nga Komisioni i {...}-së, gjykata shqyrton vërtetësinë e rezultateve të komisionit në raport me sjelljen dhe vlerësimet 6 mujore të kryera më parë në kohë. Në rastin në shqyrtim, të gjitha palët ishin dakort me vlerësimin pozitiv të sjelljes së të dënuarit {...}.

74.10. Gjatë gjykimit të çështjes për lirim me kusht të të dënuarit {...}, është administruar edhe Raporti i Vlerësimit i Shërbimit të Provës, ku në rubrikën “ Konkluzione”, Shërbimi i Provës është shprehur “ **Duke analizuar, shqyrtuar dhe vlerësuar në përgjithësi e vazhdimësi të gjithë sjelljen dhe qëndrimin aktual të të dënuarit, kushtet dhe rrethanat konkrete familjare, ekonomike dhe sociale, vlerësojmë se i nëse i dënuari i plotëson kriteret formale të kërkuarra në nenin 64 të Kodit Penal për lirim me kusht, dhe në nenit 477 të Kodit të Proçedurës Penale, si dhe mbështetur në kushtet dhe rekomandimet e vendosura edhe në vendimin unifikua Nr.2, datë 25.05.2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për institutin e lirimimit me kusht i cili ka karakter riedukues, human dhe social, Shërbimi i Provës për të dënuarin {...} e le në çmimin e gjykatës për pranimin e kërkesës për "lirim me kusht" pasi mundësia për t'u integruar në familje e shoqëri është një mundësi normale e vështire por edhe e mundshme, për ti dhënë të dënuarit në bazë të ligjit edhe një mundësi edukimi dhe riintegrimi në familje e në shoqëri. Nëse do të pranohet nga Gjykata kërkesa e tij për lirim me kusht, për të arritur edukimin dhe riintegrimin e tij të plotë në familje e shoqëri, Shërbimi i Provës gjithë periudhës të provës dhe te mbikëqyrjes të të dënuarit, institucioni i Shërbimit të Provës do të asistojë dhe hartojë programe dhe plane të veçanta**

individuale të trajtimit dhe të edukimit të tij me qëllim arritjen e objektivave të trajtimit edukimit dhe riintegrimin të tij të plotë në familje, në shoqëri e komunitet. Për të siguruar dhe realizuar plotësisht qëllimin e edukimit dhe të riintegrimin të tij të plotë në familje, në jetë dhe në komunitet, mbështetur e bazuar në nenin 60/9 të Kodit Penal rekomandojmë që i dënuari menjëherë pas lirimit me kusht të detyrohet; -Të mos shoqërohet me persona të caktuar, kryesisht me të dënuar e me precedent penal apo bashkëpunëtorët e veprës penale”.

74.11. Sa më sipër, gjykata ka vlerësuar si pozitive, sjelljen e të dënuarit në {...} Tepelenë, konstatuar edhe nga Shërbimi i Provës, i cili shprehet se mundësia për tu integruar në familje e shoqëri e të dënuarit {...} është e mundshme, për t'i dhënë të dënuarit në bazë të ligjit edhe një mundësi edukimi dhe riintegrimin në familje e shoqëri. Duke hequr vetëm diskutimin nëse i dënuari është përsëritës, pjesa tjetër e vlerësimit të institucioneve të mësipërme, është konsideruar pozitive dhe pro kërkesës për lirim me kusht të të dënuarit {...}.

74.12. Në lidhje me pretendimin se i dënuari ka qenë përsëritës, është zhvilluar debat gjyqësor dhe gjykata ka dalë në përfundimin se i dënuari nuk ka pengesë ligjore sipas nenit 64 të K.Penal, pasi është i rehabilituar. Këtë qëndrim të gjykatës nuk e konteston edhe Inspektori i cili shprehet “ *Përsa i përket çështjes së rehabilitimit, pasi ky shtetas ka qenë më parë i dënuar për një krim me dashje, mbetet një çështje e diskutueshme në praktikën gjyqësore, nëse i rehabilituari për shkak të nenit 64 të K.Penal do të konsiderohet përsëritës ose jo.*” E diskutueshme kjo çështje mbetet vetëm në raportin ndaj meje, pasi në inspektimin tematik, kjo çështje është ndarë pro qëndrimit për mos konsiderimin përsëritës te të dënuarit të rehabilituar, nga një dënim i mëparshëm.

74.13 **Prokurori në gjykim u shpreh se “nuk ekzistojnë shkaqe negative. Nuk rezulton një periudhë sigurie e vendosur nga gjykata. Nuk rezulton paraqitje e një kërkesë të rrëzuar brenda 6 muajve. Plotësohet periudha e dënimit e kryer. Lidhur me rehabilitimin është fakt që është institut që e ç'bën dënimin, në kuptimin që personi quhet i padënuar, nuk quhet përsëritës me dashje. Lidhur me mundësinë e integritit, gjithë treguesit dhe sjella e tij në {...} si dhe treguesit e tjerë, predispozitat pozitive që ka patur personi do t'i shpalosi në botën e jashtme dhe me ndihmën e faktorëve të tjerë, që personi të integrohet plotësisht. Në këto kushte, shprehemi për pranimin e kërkesës për lirim me kusht.”**

Sa më sipër, vlerësoj se nuk ka asnjë shkelje ligjore të parashikuar në nenet 477 dhe 64 të K.Penal.

74.14. Në gjykim u administruan edhe “ *Karakteristikë familjar e qytetarit të Bashkisë Tepelenë, {...}*”, lëshuar nga Bashkia Tepelenë me nr. 97 prot., datë 15.01.2021, në të cilën thuhet “ *...Ati i tij, {...}, ka punuar si teknik në ndërmarrjen e SMT të qytetit, sot ka ndëruar jetë. Nëna e tij {...}, ka punuar në kooperativë, sot e papunë, shtëpiake. Ka një vëlla, {...} dhe një motër {...} e cila ka krijuar familje dhe jetojnë me ndershmëri....Pra ai vjen nga një familje tepër shembullore e qytetit të Tepelenës, ka një familje që dallon në qytet për sjellje korrekte dhe humane, si dhe lagje e qytet dhe gjithë komunitetin e qytetit. Familje me fëmijë të edukuar e të sjellshëm që e duan rregullin, qetësinë dhe marrëdhëniet humane dhe*

bashkëqytetare. Të gjithë pjesëtarët e kësaj familje nuk përbëjnë dhe nuk kanë sjellë asnjëherë shqetësime sociale apo sjellje jo korrekte dhe jo ligjore, si për komunitetin e qytetit, sjellje ën shkollë, sjelljen në punë apo në raport me shtetin”.

Sa më sipër, familja dhe sjellja në komunitet, janë vlerësuar pozitive për kërkuesin {...}.

74.15. Sipas dokumentave mjekësore të administruar në gjykim, rezulton se nëna e kërkuesit {...}, është diagnostikuar me “adenocarcinoma” në muajin Dhjetor 2019 dhe **është trajtuar me Kimioterapi që të reduktohej tumori.** (*ka rezultuar se ati i të dënuarit kishte vdekur më parë*).

Vëllai i kërkuesit, shtetasi {...}, sipas “Epikrizë përcjellëse për invalidë” **ka mungesë të dorës së majtë të lindur.....etj.**

74.16. Në këto kushte, Gjykata duke patur në konsideratë edhe rolin human të së drejtës penale, si dhe faktin që familjarët e kërkuesit të dënuar kanë nevojë për përkujdesjen e tij, e ka vlerësuar pozitive gjendjen familjare të të dënuarit {...}, në funksion të kërkesës për lirim me kusht. Gjithashtu në gjykim u paraqit edhe një deklaratë e administratores së shoqërisë “{...}” sh.p.k që merr përsipër punësimin e të dënuarit {...}.

Duke shtruar për diskutim pretendimet e kërkuesit {...}, pretendimin e {...}-së nëse i dënuari duhet ose jo të konsiderohet përsëritës, raportet e vlerësimit të {...} Tepelenë dhe Shërbimit të Provës, provat për gjendjen familjare sjellë nga kërkuesi, marrë në konsideratë edhe qëndrimin e prokurorit “Pro” kërkesës së të dënuarit, gjykata vendosi pranimin e kërkesës për lirim me kusht.

74.17. Rezulton se ky vendim ka marrë formë të prerë, pa u ankimuar nga asnjë prej palëve ndërgjyqëse. Për sa kohë nuk është bërë objekt shqyrtimi nga një gjykatë më e lartë, çdo vlerësim juridik i faktit dhe provave të shqyrtuara në gjykim, marrë për bazë nga gjykata në vendimarrjen e saj, është ekskluzivitet funksional dhe ligjor, vetëm i gjykatës.

Në lidhje me lirimin me kusht të të dënuarit {...}

75. Inspektori shprehet se deri në datën e shpalljes së vendimit për lirimin me kusht, të dënuarit i kishin mbetur për të vuajtur 7 muaj e 1 ditë dhe jo 4 muaj e 8 ditë, siç shprehet gjykata. Në vijim shprehet se në dosjen gjyqësore rezulton se është administruar dhe një vendim tjetër ulje dënimi prej 90 ditësh, e cila është përfshirë në llogaritjen e dënimit. Nuk e kuptoj se përse Inspektori duhet të plotësonte një faqe arsyetim dhe llogaritje të panevojshme, ndërkohë që edhe vetë e ka konstatuar se krahas dënimit të llogaritur mbi dinamikën e vuajtjes së dënimit të paraqitur nga {...}, kërkuesi ka paraqitur edhe një vendim gjyqësor të dhënë nga një trup tjetër gjykues, të marrë formë të prerë, i cili detyrimisht duhej dhe është llogaritur nga gjykata në uljen e dënimit.

75.1. Inspektori shprehet se në vendim nuk përmenden konkretisht konkluzionet e raporteve të {...} dhe Shërbimit të Provë, duke i hyrë arsytimit të vendimit, kompetencë të cilën nuk

e ka të parashikuar në ligj dhe për më tepër pa u konstatuar mos arsyetimi i vendimit nga një gjykate më e lartë. Referuar vendimi gjyqësor kam vlerësuar se përmendja e pozitivitetit të raporteve të {...} dhe Shërbimit të Provës, ishte i mjaftueshëm, duke u shprehur se “ Në lidhje me kushtin e tretë për ekzistencën e arsyeve të veçanta, nëse me sjelljen dhe punën e tij, i dënuari tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij gjykata vlerëson se Ligjvënësi duke përdorur shprehjen " arsye të veçanta" ka bërë një vlerësim të përgjithshëm, pa i nominuar ato e duke e lënë në vlerësim të gjykatës sipas rrethanave konkrete që i paraqiten. Megjithatë këto" arsye të veçanta" nuk janë të pavarura dhe duhet të jenë të lidhura ngushtë me qëllimin e institutit të lirim para kohe me kusht, i cili ka të bëjë me riedukimin dhe riintegrimin në shoqëri të të dënuarit. Arsyet e veçanta nuk janë gjë tjetër veçse rrethana konkrete, të cilat provojnë se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi për edukimin dhe i dënuari është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri. Ky integrim i paragrafit të parë të nenit 64 të K. Penal të çon në konkluzionin logjik se kemi të bëjmë me një kusht të vetëm dhe " arsyet e veçanta" nuk janë gjë tjetër veçse fakte të cilat provojnë se me pjesën e dënimin të vuajtur është arritur qëllimi i dënimin penal, në rastin konkret për edukimin e të dënuarit dhe ai është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri.(Vendimi Unifikues Nr. 1 i Regj. Themeltar. Nr. 2 i Vendimit i Gjykatës së Lartë).

Sa më sipër, ky trup gjykues në vlerësimin e " arsyeve të veçanta" në funksion të edukimit dhe riintegrimin të kërkuesit në shoqëri, mban në konsideratë raportet e vlerësimit të kryera nga {...} Tepelenë dhe Shërbimi i Provës Zyra Vendore Gjyrokastër, të cilat kanë vlerësuar pozitivisht sjelljen e kërkuesit në {...} gjatë kohës së vuajtjes së dënimin, si dhe mundësinë për rehabilitim dhe risocializim në shoqëri. (për më tepër shih raportet e vlerësimit të {...} dhe Shërbimit të Provës).

75.2. Vlerësoj se në kushtet kur të gjitha palët në gjykim kanë qenë dakort për pranimin e kërkesës, si pasojë dhe mospatjen e ndonjë ankimi, arsyetimi i mësipërm, vlerësuar edhe në tërësinë e arsyetimit të vendimit, ka qenë i mjaftueshëm, për të përmbushur kriterin ligjor të një vendimi të arsyetuar. Gjithsesi për sa kohë nuk është konstatuar nga një gjykata më e lartë, nuk është kompetencë e Inspektorit një vlerësim subjektiv i tillë.

75.3. Sa më sipër, vlerësoj se nuk ka asnjë shkelje ligjore në shqyrtimin dhe vendimarrjen e gjykatës për lirim me kusht të të dënuarit {...}.

Në lidhje me lirim me kusht, të të dënuarit {...}.

76. Ka rezultuar se {...} nuk ka paraqitur në gjykim prova në lidhje me provueshmërinë e kushtit formal/objektiv, se nuk kishte paraqitur kërkesë tjetër brenda 6 muajve. Në mungesë të plotësisimit të kushteve formale, të parashikuara nga neni 477 i K.Pr.Penale, gjykata nuk ka vijuar me shqyrtimin e kushteve të parashikuara në nenin 64 të K.Penal. Kundër vendimit kërkuesi ka paraqitur ankimi në Gjykatën e Apelit e cila ka vendosur, ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pranimin e kërkesës.

76.1. Inspektori referon në këtë proçedim se Gjykata e Apelit ka konstatuar shkelje të rëndë procedurale të Gjykatës së Shkallës së Parë, duke ju referuar arsytimit të gjykatës së Apelit, e cila është shprehur si vijon “ **Arsyetimi i përdorur nga gjykata e faktit se "mosparaqitja e asnjë prove për të provuar kushtin procedural te mospasjes se një kërkesë te rrezuar, jo me afër se 6 muaj paraqitja e kërkesës për gjykim përbën shkak procedural për rrëzimin e kërkesës" vjen ne kundërshtim dhe ne keqinterpretim te kërkesave procedurale qe kërkon neni 477 i K.Pr. Penale. Fakti qe prej te dënuarit, nuk është paraqitur ndonjë kërkesë e mëparshme para shqyrtimit te kësaj kërkesë për lirimin me kusht, kjo gjykate vlerëson se nga ana e kërkuarit plotësohen kushtet dhe kriteret qe përcakton neni 477 i K.Pr. Penale. Kërkesa e paraqitur nga kërkuari plotëson kriteret ligjore qe parashikon dispozita materiale, neni 64 i K. Penal, qe ne mënyrë kumulative kërkon; a) te ketë kryer jo me pak ¼ e dënimit te dhënë b) te mos jete përsëritës për krime te kryera me dashje, si dhe te mos jete dënuar për veprat penale te parashikuara nga nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c dhe Neni 100/3 te K. Penal c) ekzistencën e arsyeve te veçanta nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi për edukimin e tij".**

76.2. Rezulton se këtë çështje Inspektori e ka evidentuar dhe shprehur edhe në Raportin e Inspektimit Tematik në Gjykata dhe Prokurori, (faqe 154) është shprehur se “ Gjykata e Apelit mbi bazë të këtij ankimi ka vlerësuar të procedojë me hetim të pjesshëm në drejtim të administrimit të vërtetimit të gjykatës së rrethit gjyqësor lidhur me kërkesë të mëparshme të kërkuarit, nga i cili rezultoi se nuk kishte të tilla. Në vazhdim, gjykata pas prezantimit të këtij fakti, ka konkluduar se arsyetimi sa më sipër i gjykatës së rrethit gjyqësor lidhur me mosparaqitjen e një prove nga kërkuari për kërkesë të mëparshme, vjen në kundërshtim dhe keqinterpretim të kërkesave procedurale që kërkon neni 477 i K. Pr. Penale. **Ky konkludim nuk është shoqëruar me ndonjë arsyetim konkret** dhe gjykata e Apelit më tej ka vazhduar me arsyetimin e plotësimit të kërkesave të tjera lidhur me kriteret objektive dhe subjektive dhe në përfundim ka vendosur ndryshimin e vendimit të rrëzimit dhe pranimin e kërkesës, duke urdhëruar lirimin e menjëhershëm të të dënuarit. Me vendimin për lirimin me kusht, ka qenë dakort edhe prokurori i apelit i cili ka shprehur qëndrimin e tij gjatë seancës dhe për këtë arsye ndaj vendimit nuk ka patur rekurs.

76.3. Sqaroj se vendimi i Gjykatës së Apelit është i paarsyetur në lidhje me këtë konkluzion. Nuk ka asnjë rresht në vendim, të tregojë se përse kërkesa për provimin e faktit të mospasjes së një kërkesë të mëparshme për lirim me kusht, është në shkelje të nenit 477 të K.Pr.Penale, dispozitë që e parashikon shprehimisht në pikën 2 të tij. Në nenin 477 të K.Pr.Penale parashikohet se “ 1. Gjykata e vendit të ekzekutimit vendos për lirimin me kusht dhe revokimin e vendimit të lirit me kusht, sipas kriterëve të caktuara në Kodin Penal. 2. **Kërkesa nuk mund të përsëritet para se të kenë kaluar gjashtë muaj nga dita kur vendimi i rrëzimit të kërkesës ka marrë formë të prerë.**

76.4. Inspektori është “kujdesur” të lexojë mes rreshtave të vendimit të gjykatës për të dalë në konkluzionin e gabuar, ndonëse ka evidentuar se Gjykata e Apelit nuk ka arsyetuar se përse vendimi i shkallës së parë, kishte kryer shkelje procedurale. Inspektori gjithashtu ka

harruar apo nuk ka dashur të lexojë procesverbalin e seancave gjyqësore të zhvilluara në Gjykatën e Apelit, procesverbale që ndodhen të printuara në dosjen gjyqësore, që ka analizuar.

Konkretisht sipas procesverbalit të datës 02.05.2018, ora 10:02, rezulton se në rubrikën, ora 10:35:36, gjykata pyet: “***Është paraqitur prej jush, kërkesë për lirim me kusht para se të depozitohet kërkesa e datës 20.02.2018 dhe nëse ka një vendimarrje në lidhje me këtë kërkesë?***”

Avokati i të dënuarit përgjigjet: ***Ne mund ta paraqesim, kërkoj kohë.***

Gjykata : “***Vendim: Gjykata e këshilluar, bazuar në nenin 427 të K.Pr.Penale i lë kohë avokatit mbrojtës A.I, për të paraqitur nëse është depozituar kërkesë për lirim para kohe me kusht nga ana e kërkuarit, para se të depozitohet kërkesa për lirim me kusht e datës 20.02.2018 dhe nëse ka një vendimarrje në lidhje me këtë kërkesë. Për këtë shkak shtyn gjykimin e çështjes në datë 03.05.2018, ora 10:00.***

Në seancën e datës 03.05.2018, në orën 10:18:07, avokati shprehet : ***Në zbatim të detyrave të lëna nga gjykata ne siguroam vërtetimin që mban nr. 85 prot., datë 02.05.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, ku vërtetohet se kërkuari që nga data 01.Shtator 2017 deri 19 Shkurt 2018 nuk ka paraqitur kërkesë me objekt “ lirim me kusht”.***

Në vijim gjykata është shprehur: “***Gjykata e këshilluar vendosi të administroj me cilësinë e provës shpresore Vërtetimin nr. 85 prot., datë 02.05.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe vendos të mbyll shqyrtimin gjyqësor duke ftuar palët të japin konkluzionet përfundimtare.***

76.5. Në këto kushte, arsyetoj se Gjykata e Apelit ka gabuar kur vendimarrjen e Gjykatës së Shkallës së Parë, e ka konsideruar padrejtësisht si në keqinterpretim të nenit 477 të K.Pr.Penale, për sa kohë ka kërkuar dhe ka administruar, provën e munguar në procesin e zhvilluar prej meje në shkallë të parë. Nëse kjo provë ishte e panevojshme, atëherë nuk kishte pse t’i kërkonte avokatit shpjegime dhe paraqitjen e provës, por le të bënte interpretim të saktë të nenit 477, siç është shprehur në vendimin e saj, në pjesën që Inspektori e ka shkëputur nga e tëra dhe e referon si shkelje e rëndë procedurale, e konstatuar nga një gjykata më e lartë. Inspektori ka patur detyrë të verifikonte gjithë procesin, siç është kujdesur për të gjitha çështjet e tjera të shqyrtuara më sipër, ku ka evidentuar edhe gabimet materiale në vendim dhe pastaj të dilte në konkluzion. Për sa kohë prova e paparaqitur në gjykatën në shkallë të parë është kërkuar dhe administruar nga gjykata e apelit, vlerësoj se nuk kemi të bëjmë me çështje procedurale, por me provim të fakteve të pretenduara nga kërkuari, detyrë ekskluzive e palëve ndërgjyqëse në gjykim.

76.6. Në këto kushte, vlerësoj se nuk ka asnjë shkelje procedurale në vendimarrjen e gjykatës në lidhje me çështjen penale “ lirim me kusht” për të dënuarin {...}.

Disa konstatime të tjera, referuar Raportit Disiplinor

77. Inspektori ka vlerësuar të gjithë vendimarrjen time në lidhje me kërkesat për lirim me kusht. Ka evidentuar edhe analizuar edhe ato vendimarrje, për të cilat jo vetëm koha 5 vjeçare, por edhe ajo 6 vjeçar e verifikimit, ka përfunduar. Çështjet e hetuara jashtë afatit 6 vjeçar të parashkrimit, i ka referuar në raportin disiplinor, ndonëse shprehet se janë jashtë periudhës së verifikimit. Por çuditërisht inspektori nuk evidenton disa vendime të tjera me objekt “Lirim me kusht”, ku kërkesat e të dënuarve nuk janë pranuar nga gjykata. Si duket rëndësi ka vetëm zbatimi i ligjit kur personi lirohet me kusht dhe jo kur i rrezohet kërkesa nga gjykata.

77.1. Në këto vendime gjykata ka disponuar me vendime rrëzimi të kërtimeve²⁹ pasi:

1. Në vendimin nr. 11 datë 06.07.2021, gjykata ka evidentuar se i dënuari nuk ka patur qëndrim pozitiv gjatë vuajtjes së dënimit. {...} është paraqitur me raport negativ. {...} dhe Prokurori janë shprehur për mospranimin e kërkesës. Gjukata ka vendosur rrëzimin e kërkesës.
2. Në vendimin nr. 21 datë 27.12.2018, i dënuari kërkues, ishte dënuar për veprën penale “ Vjedhja me armë” dhe dënuar me 12 vite burgim. Ndonëse të gjitha palët ndërgjyqëse kanë kërkuar pranimin e kërkesës, gjykata ka analizuar llogaritjen e paraburgimit në shtetin e Greqisë, jo si paraburgim, por si periudhë vuajtes dënimi, duke konkluduar se i dënuari nuk plotëson kriterin e ¾-ve të dënimit të dhënë nga gjykata. Gjithashtu ka patur në konsideratë edhe natyrën e rrezikshme të veprës penale të kryer. Gjukata ka vendosur rrëzimin e kërkesës.
3. Në vendimin nr. 02 datë 18.01.2019, gjykata ka konstatuar se i dënuari ishte dënuar për veprën penale “ Vrasja” parashikuar nga neni 76 dhe 22 të K.Penal, të kryer ndaj bashkëjetueses duke e goditur 6 herë me thikë dhe në ikje e sipër u ka dërguar “sms” personave të tretë, duke i thënë, që e vrava. {...} dhe Shërbimi i Provës kanë qenë për pranimin e kërkesës, Prokurori për rrëzimin e kërkesës. Gjukata ka analizuar rrezikshmërinë e veprës penale dhe autorit, mënyrën e kryerjes së veprës penale, si dhe rrethana të tjera dhe në përfundim ka vendosur rrëzimin e kërkesës. (*Këtu ku është zbatuar politika penale për dhunën në familje etj, Inspektori nuk e konsideron dhe nuk e përfshin në raportin e tij disiplinor*).
4. Në vendimin nr. 05 datë 09.02.2017, kërkuesi ka qenë i dënuar me 8 vjet e 6 muaj burgim, si dhe është vendosur periudha e sigurisë, për të mos përfituar lirim me kusht pa kryer 7 vite burgim. Kërkuesi ka paraqitur kërkesë duke pretenduar vuajtjen e më shumë se 7 vite burgim. Gjukata ka konstatuar se i dënuari kishte llogaritur në kërkesën e tij edhe 1 (një) vit ulje dënimi të përftuar me amnisti, çka është e ndaluar nga neni 64 i K.Penal. Sipas llogaritjes, kërkuesi nuk kishte vuajtur efektivisht 7 vite burgim, çka binte ndesh me vendimin e tij të dënimit. Në këto kushte, gjykata vendosur rrëzimin e kërkesës

²⁹ Paraqitur si prova bashkë me raportin kundërshtues.

77.2. Sqaroj se vendimet e mësipërme, sigurisht që kanë qenë objekt shqyrtimi nga Inspektori pasi janë brenda periudhës së inspektimit. Disa nga këto janë përmendur edhe në Raportin e Inspektimit Tematik në Gjykata dhe Prokurori, por çuditërisht nuk janë përmendur në Raportin disiplinor. Në këtë raport janë përmendur vendime, hetimi i të cilave është parashkruar, por jo këto vendime që janë brenda afatit të parashkrimit.

77.3. Siç e treguam më sipër, Inspektori është kujdesur të evidentojë deri në gabimet materiale të gjykatës, pa bërë një analizë të plotë të të gjitha çështjeve. Marrja në konsideratë e ankesave anonime, të cilat që në përmbajtje duket që tregojnë dashakeqësi, si dhe vlerësimi i rasteve të ngjashme me dy standarte të ndryshme vlerësimi, tregojnë për një vlerësim jo objektiv të kryer nga Inspektori.

77.4. Në përfundim vlerësoj:

1. Inspektori ka verifikuar çështje, për të cilat ka kaluar afati 5 vjeçar i verifikimit. Nuk rezulton që të ketë apo pretendohet se ka shkelje të njejta në mënyrë të përsëritur, për të shtuar afatin e parashkrimit të parashikuar në nenin 117 të ligjit nr. 96/2006 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH.”
2. Shtetasi {...} nuk ka kryer asnjë ankim ndaj meje pranë ILD-së, në lidhje me lirimin me kusht të të dënuarit {...}. Këtë ja kam provuar Inspektorit që me paraqitjen e kërkesës për procedimin disiplinor të gjyqtarës {...}, në datë 02.07.2022, bashkangjitur aktet dhe provat e marra nga Prokuroria si dhe me deklaratën noteriale dërguar Inspektorit nga shtetasi {...} {...}. Bazuar në nenin 119/3 të ligjit nr. 96/2006 “Për statusin e gjyqtarëve e prokurorëve në RSH Inspektori nuk duhet të shqyrtonte një ankesë anonime. Çuditërisht ndaj shtetasit {...} {...} nuk ka asnjë njoftim të kryer nga Inspektori, si gjatë hetimit ashtu edhe për raportin përfundimtar.
3. Të gjitha vendimet gjyqësore të referuara nga Inspektori janë të formës së prerë dhe si të tilla vendimarrja, arsyetimi dhe zbatimi i ligjit material janë atribut vetëm i gjykatës.
4. Në të gjitha lirimet me kushte, nuk konstatohet asnjë shkelje procedurale e neneve 477 të K.Pr.Penale dhe 64 të K.Penal. Vlerësimi i provave dhe vendimarrja e gjykatës në lidhje me plotësimin e kushtit të “Arsye të veçanta” për të përfutur lirim me kusht, nuk mund të jenë objekt shqyrtimi nga ILD, pasi kemi të bëjmë me interpretim dhe vlerësim të provave nga gjykata.
5. Rasti i pretenduar për konstatim të shkeljes procedurale nga Gjykata e Apelit, nuk qëndron dhe duhet të ngarkojë me përgjegjësi gjyqtarët e Gjykatës së Apelit që arsyetojnë vendimet në kundërshtim me procedurën gjyqësore dhe provat e administruara në gjykimin që kanë zhvilluar.
6. Vlerësimi në tërësi i të gjitha vendimeve për lirim me kusht të dhëna prej meje gjatë periudhës së inspektimit, si në rastet e pranimit të kërkesës, ashtu edhe të rrëzimit të saj, tregojnë plotësisht respektim të plotë të ligjit nga gjykata.

78. Për sa më sipër, kundërshtoj kategorisht çdo vlerësim subjektiv dhe në kundërshtim me ligjin dhe detyrën funksionale të ILD-së të paraqitur në Raportin Disiplinor në ngarkimin tim dhe për këto arsye, kërkoj Rrëzimin e Kërkesës.

V. LIGJI I ZBATUESHËM:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

79. Neni 137 parashikon se: “Gjyqtari gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrimin e funksioneve të tij, përveç rasteve të dhënies qëllimisht të një vendimi, si pasojë e një interesi vetjak ose keqbesimi.”

80. Në nenin 147, pika 1 sanksionohet se: “1. Këshilli i Lartë Gjyqësor siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë....”

81. Neni 147/d përcakton se Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve, sipas procedurës së përcaktuar me ligj.

Ligji “Për Statusin”

82. Neni 100 i ligjit përcakton se: 1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshillat, për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në këtë pjesë, udhëhiqen dhe synojnë zbatimin e përshtatshëm dhe në mënyrë të balancuar të parimeve të mëposhtme: a) e drejta për një proces të rregullt, duke përfshirë dhe marrjen e një vendimi brenda një afati të arsyeshëm; b) parimin e ligjshmërisë, në kuptimin që organi kompetent ka detyrimin të hetojë nëse ka shkaqe të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur një shkelje disiplinore, **si dhe parimin e “mosdënimit pa ligj”;**

83. Neni 138 i ligjit përcakton momentin e fillimit të procedimit disiplinor. Në këtë dispozitë të titulluar “Fillimi i procedurës disiplinore”, parashikohet shprehimisht se: “1. Përveç parashikimeve të nenit 152, të këtij ligji, nëse ka dyshime të arsyeshme që magjistrati ka kryer shkelje disiplinore, Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon procedimin disiplinor, duke paraqitur raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore... .”³⁰

84. Në nenin 139 parashikohet mbyllja e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore. Sipas kësaj dispozite Këshilli vendos mbylljen e procedimit disiplinor pa zhvilluar seancë dëgjimore nëse: a) shkelja disiplinore është parashkruar në kohën kur ka filluar hetimi, sipas parashikimeve të nenit 117 të këtij ligji; b) çështja ka qenë objekt i procedimit disiplinor që

³⁰Neni 138, ndryshuar me ligjin Nr. 15/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare nr.140, datë 30 Korrik 2020.

është zgjidhur me vendim të formës së prerë; c) ka arsye të tjera për të mbyllur procedimin, në përputhje me parashikimet e nenit 134, pika 1, shkronjat “ç” dhe “d”; ç) raporti i hetimit është depozituar pa u arsyetuar. Në këtë nen të ligjit parashikohet shprehimisht se dorëheqja e magjistratit nuk ndalon fillimin ose vazhdimin e procedimit disiplinor.

85. Neni 146 i ligjit parashikon se: “1. Këshilli merr çdo vendim në lidhje me: a) angazhimin e ekspertëve dhe përcaktimin e detyrave të tyre; b) shtyrjet e seancave; c) pranueshmërinë e provave; ç) zgjidhjen e çështjes; d) çdo çështje tjetër që Këshilli e vlerëson të nevojshme ose të përshtatshme në trajtimin e çështjes. 2. Pas shqyrtimit të fakteve dhe provave, Këshilli: **a) rrëzon kërkesën për procedim disiplinor, për shkak se faktet e pretenduara nuk kanë ndodhur ose ato nuk përbëjnë shkelje disiplinore;** b) pranon kërkesën dhe vendos një ose më shumë masa disiplinore. 3. Këshilli nuk është i detyruar t’i qëndrojë masës disiplinore të propozuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe jep vendim të arsyetuar me shkrim të paktën brenda dy javëve nga përfundimi i seancës.”

V. VLERËSIMI I KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

86. Pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave është një element thelbësor i shtetit të së drejtës. Gjykata Kushtetuese³¹ ka theksuar se parimi i pavarësisë, i deklaruar në disa dispozita të Kushtetutës, kërkon, në radhë të parë, që gjyqtarët dhe gjykatat ndërsa japin drejtësi, tu nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve³². Bazuar në parashikimet kushtetuese pushteti gjyqësor, përveç pavarësisë së jashtme (*pavarësia nga pushtetet e tjera*), ka edhe një pavarësi të brendshme (*gjyqtarët i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve*)³³.

87. Përveç organeve të reja të qeverisjes së sistemit gjyqësor, ndryshimet e fundit kushtetuese parashikojnë dhe krijimin e Inspektorit të Lartë i Drejtësisë, si organi kushtetues përgjegjës, për të hetuar shkeljet disiplinore të gjyqtarëve si dhe për inspektimin e gjykatave të të gjitha niveleve, brenda kufijve të të drejtave dhe procedurës së parashikuar në ligj.

88. Dispozitat kushtetuese dhe ato ligjore përcaktojnë, pa asnjë dyshim, në mënyrë të ndarë fazat e procesit disiplinor ndaj gjyqtarëve, të cilat janë hetimi disiplinor, i cili realizohet nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe procedimi disiplinor, i cili do të shqyrtohet dhe vendoset vetëm nga Këshilli, si një organ vendim-marrës kolegjial.

89. Neni 140 i Kushtetutës parashikon se gjyqtari mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit. Në këtë zbatim të këtij parashikimi kushtetues është miratuar ligji “Për Statusin”, i cili normon parimet e procedimit disiplinor, llojet e shkeljeve dhe të masave disiplinore që mund të caktohen ndaj magjistratit, si dhe procedurat hetimore dhe disiplinore që ndiqen ndaj tij nga ILD dhe Këshilli.

³¹Shih vendimin nr. 5, datë 16.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese.

³²Neni 145, pika 1 e Kushtetutës – “1. Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve...”

³³Shih vendimin nr. 40, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese.

90. Bazuar në këto dispozita kushtetuese dhe ligjore, Këshilli vlerëson se një masë disiplinore ndaj një gjyqtari duhet të jepet, gjithnjë dhe vetëm, në kuadër të një procedimi disiplinor, të filluar nga organi kompetent, dhe të shqyrtuar sipas procedurave të parashikuara në ligjin “Për Statusin”, në funksion të garantimit të një procesi të rregullt ligjor dhe të parimeve të procedimit disiplinor të tilla si: parimi i ligjshmërisë, akuzës, barazisë para ligjit, prezumimit të pafajësisë, proporcionalitetit etj.

91. Këshilli pasi dëgjoi pretendimet dhe prapësimet e palëve në proces, analizoi provat e paraqitura në funksion të zgjidhjes së drejtë të çështjes, në respektim të parimit të ligjshmërisë, paanësisë, kontradiktoritetit, proporcionalitetit dhe barazisë së armëve në proces., vlerëson si vijon:

91.1. Këshilli arsyeton se dispozitat e ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin” (neni 100 e vijues) duhen interpretuar në tërësi dhe jo të shkëputura nga njëra tjetra.

91.2. Pra, nenet 101 dhe 102 duhen interpretuar në përputhje me parashikimet e nenit 100 pika 1, shkronja “b” të ligjit Për Statusin, 1. *Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshillat, për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në këtë pjesë, udhëhiqen dhe synojnë zbatimin e përshtatshëm dhe në mënyrë të balancuar të parimeve të mëposhtme: b) parimin e ligjshmërisë, në kuptimin që organi kompetent ka detyrimin të hetojë nëse ka shkaqe të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur një shkelje disiplinore, si dhe parimin e “mosdënimit pa ligj”;*

91.3. Gjithashtu Këshilli ka vlerësuar se në mënyrë që të pranohet një kërkesë për caktim mase disiplinore, duhet të plotësohen në mënyrë kumulative 3 kushte:

1. Të evidentohet q{...}zi fakti nëse shkelja është bërë me qëllim dhe kundër ligjit material apo procedural;
2. Magjistrati të ketë shkelur kërkesat rigoroze të ligjit;
3. Pasojat e ardhura nga veprimet apo mosveprimet e magjistratit (në raport me vendimarrjen) të jenë serioze.

92. Përpara se të vlerësojë ekzistencën ose jo të kushteve të mësipërme, Këshilli paraprakisht mori në shqyrtim, kërkesën e magjistratit për parashkrim të procedimit administrativ.

92.1. Në lidhje me kërkesën për parashkrim të procedimit disiplinor, Këshilli konstaton se në nenin 117 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, parashikohet se “ 1. *Shkeljet disiplinore parashkruhen brenda pesë vjetëve. Nëse një ankesë, sipas nenit 119, të këtij ligji, paraqitet pas 5 vjetëve nga koha kur ka ndodhur shkelja e pretenduar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk verifikon ankesën për shkak të parashkrimit. Nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë merr të dhëna, sipas nenit 124, të këtij ligji, pas 5 vjetëve nga koha kur ka ndodhur shkelja e pretenduar, ai nuk fillon hetimin*

për shkak të parashkrimit. 2. Afati i parashkrimit fillon nga momenti kur shkelja e pretenduar është kryer. 3. Nëse magjistrati kryen shkelje tjetër të së njëjtës natyrë brenda afatit të parashkrimit, afati zgjatet deri në një vit.

92.2. Në analizë të dispozitës së mësipërme Këshilli arsyeton se afati i parashkrimit të procedimit disiplinor fillon në momentin e ndodhjes së shkeljes së pretenduar nga magjistrati dhe do të vazhdojë deri në momentin që Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendim, fillon hetimin disiplinor ndaj magjistratit. Procedura e mëtejshme hetimore apo eventualisht paraqitja e kërkesës në KLGJ për fillimin e procedimit disiplinor dhe kohëzgjatja për procedimin disiplinor të zhvilluar nga KLGJ është jashtë parashkrimit ligjor të treguar në nenin 117 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve e prokurorëve në RSH”.

92. Referuar çështjes në shqyrtim, Këshilli në lidhje me kërkesën për parashkrim të procedimit disiplinor, do të vlerësoj si datë për llogaritjen e afatit të parashkrimit, datën 16.05.2023, në të cilën Inspektori ka marrë vendimin për fillimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit.

92.1. **Vendimi penal për lirimin me kusht të shtetasit {...}** është i datës 23.10.2018. Deri në datën e fillimit të hetimit disiplinor 16.05.2018 nuk është plotësuar afati 5 vjeçar i parashkrimit dhe në këto kushte, Këshilli vlerëson se hetimi dhe procedimi disiplinor në lidhje me vendimarrjen e gjykatës për lirimin me kusht të shtetasit {...} është brenda afatit të parashkrimit.

92.2. **Vendimi penal për lirimin me kusht të shtetasin {...}** është i datës 22.11.2019. Llogaritur afati i parashkrimit deri në datën 23.10.2018, rezulton që hetimi disiplinor dhe në vijim procedimi disiplinor janë brenda afatit të parashkrimit.

92.3. **Vendimi penal për lirimin me kusht të shtetasit {...}** është i datës 27.03.2018, çka rezulton se referuar datës së fillimit të hetimit disiplinor 06.05.2023, ka kaluar afati 5 vjeçar i hetimit dhe për këto arsye, procedimi disiplinor për këtë çështje gjyqësore është i parashkruar. Pretendimi i Inspektorit se kemi të bëjmë me shkelje të kryera për çështje me të njëjtën natyrë, është i papranueshëm pasi nuk rezulton që më parë të ketë ndonjë vendimarrje të Këshillit për konstatimin e ndonjë shkelje të magjistratit në gjykimet e zhvilluara pre tij me objekt “Lirim me kusht”. Gjithashtu edhe nga çështjet e parashtruara nga Inspektori në këtë procedim disiplinor, nuk rezulton që të ketë shkelje të së njëjtës natyrë. Tek çështja penale me objekt lirim me kusht të shtetasit {...} pretendohet shkelje procedurale në zbatim të nenit 477 të K.Pr.Penale, shkelje e papretenduar në asnjë nga çështjet e tjera të parashtruara nga Inspektori.

92.3.1. **Në këto kushte, Këshilli vendos mos shqyrtimin e kërtimeve të Inspektorit lidhur me çështjen penale “Lirim me kusht” të shtetasit {...}, si të parashkruar.**

92.4. Në lidhje me pretendimin në ankesën drejtuar ILD lidhur me lirim me kusht të

shtetasit {...}, Këshilli vlerëson se verifikimi i çështjes ka nisur mbi një shkresë ankesë, ku krahas pretendimeve të tjera, Inspektori ka vlerësuar të verifikojë pretendimin objekt i veprimtarisë së tij, hetimin e lirimit me kusht të shtetasit {...}. Hetimi i vendimarrjes së gjykatës lidhur me lirimin me kusht të shtetasit {...}, krahas ankimit të paraqitur nga shtetasi {...}, vjen edhe si pasojë e Inspektimit tematik të kryer në gjithë veprimtarinë gjyqësore të magistratit, në lidhje me çështjet e gjykuara prej tij me objekt “Lirim me kusht”.

92.5. Në këto kushte, Këshilli do të marrë në shqyrtim pretendimet e Inspektorit lidhur me veprimtarinë gjyqësore të magistratit, në çështjet penale me objekt:

- i) Lirimin me kusht të shtetasit {...}
- ii) Uljen e dënimit për shtetasin {...}.
- iii) Lirimin me kusht të shtetasit {...}
- iv) Lirimin me kusht të shtetasit {...},

93. Këshilli përpara se të shprehet në lidhje me pretendimet e Inspektorit në çështjet objekt hetimi disiplinor, vlerëson ti referohet praktikës gjyqësore të Gjykatave dhe Prokurorive në Republikën e Shqipërisë, të evidentuara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në Raportin e Inspektimit “Mbi kryerjen e Inspektimit tematik të gjykatave dhe zyrave të prokurorive pranë tyre mbi trajtimin e kërkesave me objekt “Lirim me kusht”, nr. 56/29 prot., datë 29.12.2023, njoftuar KLGJ-së dhe Gjykatave dhe Prokurorive me shkresën nr. 56/31 prot., datë 22.02.2024.

94. Në këtë Raport, Inspektori pasi ka marrë në shqyrtim vendimarrjet e Gjykatave dhe Prokurorive në RSH në lidhje me çështjet me objekt “Lirim me kusht” ka evidentuar gjetjet, ka bërë vlerësimet e tij, si dhe rekomandimet drejtuar Institucioneve kompetente. Disa nga gjetjet e Inspektorit në këtë Inspektim Tematik, do të merren në konsideratë për vlerësim nga Këshilli edhe në çështjen në shqyrtim.

95. Referuar Raportit të Inspektimit Tematik,³⁴ në rubrikën “Analiza e të dhënave të konstatuara” “Lidhur me zbatimin e legjislacionit material”, Inspektori shprehet si vijon:

Referuar parashikimit të nenit 64 të K. Penal, që një i dënuar me burgim të mund të përfitojë "lirimin me kusht", duhet që të plotësohen në mënyrë kumulative kriteret e përcaktuara shprehimisht në dispozitën në fjalë. Lidhur me këto kriteret, ashtu siç është shprehur edhe Gjykata e Lartë në një sërë vendimesh të saj 159, ndërsa dy kriteret ai i vuajtjes së masës së kërkuar të dënimit dhe të mos qënurit recidivist të dënuarit për krime me dashje apo i dënuar për kryerjen e veprave penale të përcaktuara 160, janë objektivë (kriteri juridik), pasi bazohen mbi fakte të ndodhura dhe të provuara në aktet përkatëse të kohëshënuesit të dënimit dhe gjendjes gjyqësore; kriteri tjetër, ai i arsyeve të veçanta (kriteri subjektiv), të cilat

³⁴ Faqe nr. 164 e Raportit të Inspektimit Tematik

tregojnë rehabilitimin e të dënuarit kërkon një interpretim dhe vlerësim rast pas rasti në bazë të provave që i paraqiten gjykatës.

Kjo natyrë e kritereve në fjalë, është vlerësuar për t'u mbajtur në konsideratë edhe në trajtimin e vendimeve gjyqësore objekte të këtij inspektimi, në drejtim të konkludimit lidhur me respektimin e legjislacionit material.

Në këtë këndvështrim, **përsa i përket kriterit subjektiv** në vendimet e gjykatave të rretheve gjyqësore të rrëzimit/pranimi ku edhe është trajtuar, konstatohet se në përputhje me ligjin me nr. 8331, datë 21.04.1998 "Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale". i ndryshuar dhe vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë, në vendime analizohen dhe konkludohet mbi këto kritere duke u mbështetur në provat e paraqitura nga kërkuesi, qëndrimi i prokurorit, raportet përkatëse të {...} dhe Shërbimi i Provës. Ashtu siç është orientuar edhe nga vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në qëndrimin unifikues, konstatohet se në vendimet gjyqësore objekt i këtij inspektimit, është marrë në konsideratë funksioni i secilit prej dy institucioneve në fjalë, nëpërmjet analizës së raporteve të paraqitura prej tyre dhe konkludimit mbi krijimin e bindjes nëse i dënuari, me sjelljen dhe punën e tij është riedukuar dhe se është e mundur riintegrimi i të dënuarit në shoqëri. Dhe është mbi të njëjtat prova që nga ana e Gjykatës së Apelit, është vendosur në vazhdim lënie në fuqi apo ndryshim.

Përsa i përket kritereve objektive, lidhur me: Vuajtjen e masës së kërkuar të dënimit, konstatohet se ndeshen dy praktika në mënyrën sesi përllogaritet kjo periudhë, në drejtim të interpretimit të parashikimit të dispozitës 64/1 të K. Penal - jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi deri në pesë vjet burgim; - jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi mbi 5 vjet deri në maksimumin e parashikuar nga ligji, me përjashtim të parashikimeve në paragrafin 3 të këtij neni" dhe në drejtim të shtrirjes së periudhës referuar kohës së paraqitjes së kërkesës.

Në drejtim të interpretimit të parashikimit të dispozitës së sipërpërmendur. një praktikë konsiston në interpretimin e dispozitës në fjalë referuar masës së dënimit që parashikon dispozita e veprës penale për të cilën kërkuesi është dënuari dhe praktika tjetër konsiston në interpretimin e dispozitës në fjalë referuar masës së dënimit të dhënë nga gjykata...

Referuar parashikimit të dispozitës në fjalë, sipas interpretimit gramatikor dhe logjik që mund të bëhen në rastin konkret, konstatohet se mund të gjejnë vend të dy praktikat si më sipër. Kjo është evidentuar edhe nga studimi i kryer nga magjistratë në vitin 2010. Sipas këtij studimi. që vjen pas ndryshimeve të rëndësishme të ndodhura në ligjin për ekzekutimin e vendimeve penale, me anë të të cilit është krijuar për herë të parë Institucioni Shtetëror i Shërbimit të Provës, konstatohet se është vënë re se në grupin e gjyqtarëve dhe prokurorëve janë ndeshur dy grupe mendimesh që përkrijnë me dy praktikat sa më sipër. Referuar këtij konstatimi, mendimi i përllogaritjes së kohës së dënimit sipas masës së dënimit të dhënë, përkrahet nga një grup i vogël i gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Lidhur me parashikimin e dispozitës në fjalë, në drejtimin e përllogaritjes së kohës së vuajtjes së dënimit objekt i këtij shqyrtimi, ka edhe një qëndrim nga një grup tjetër magjistratësh, në

vitin 2020. Ky grup magjistratësh kanë shprehur qëndrimin e tyre që përkon me praktikën e referimit në masën e dënimit që parashikon ligji për veprën penale të kryer³⁵, ndërsa nuk është evidentuar praktika konkrete që është hasur nga vendimarrjet të cilat janë shqyrtuar për efekt të analizës.

Ndjekja e dy praktikave të para, nga gjykatat e rretheve gjyqësore nuk është bërë objekt ankimi nga prokurorët e rretheve gjyqësore dhe nga vendimarrjet e të gjithë gjykatave të apeleve nuk vihet re ndonjë qëndrim i qartë në këtë drejtim. Nga këto vendimarrje, evidentohet se ka trupa gjykatash të cilët përdorin arsyetim të qartë lidhur me praktikën që ndiqet, duke u ndalur në mënyrë konkrete në interpretimin e dispozitës në fjalë referuar masës së dënimit që parashikon dispozita, ndërsa ka trupa të tjerë të cilët nuk shprehin saktësisht lidhur me interpretimin që ndjekin, por që pranojnë arsyetimin e gjykatës së rrethit gjyqësor që ka pranuar përllogaritjen përkatëse në të dy praktikat.

Aktualisht nga vendimet gjyqësore objekt shqyrtimi në Gjykatën e Lartë (**vendimi 00-2022-1817 datë 03.11.2022**) evidentohet 1 rast kur interpretimi i nenit 64 në drejtimin në fjalë, është bërë objekt trajtimi duke përcaktuar qartë praktikën që duhet të ndiqet sipas vendimit të trupës gjyqësore. Rasti në fjalë i përket një vendimi kolegësh dhe i përket shqyrtimit të kërkesës së një të dënuari për veprën penale të "Trafikimit të lëndëve narkotike të parashikuar nga neni 283/a/1 i K. Penal i dënuar me 4 vjet burgim, për të cilën si **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat dhe Apeli Tiranë në përllogaritjen e vuajtjes së dënimit kanë mbajtur praktikën e parë referuar masës së dënimit që parashikon dispozita përkatëse për të cilën është deklaruar fajtor dhe dënuar kërkuesi. Ndërsa nga ana e Gjykatës së Lartë është vlerësuar se referimi sipas praktikës së parë, nuk është interpretim i saktë i nenit 64 të K. Penal, interpretimi sipas praktikës së dytë. Kolegji penal ka mbështetur këtë arsyetim në interpretimin ndryshe të dispozitës.**

96. Manuali mbi Dënimet Alternative në Republikën e Shqipërisë, viti 2020

5.2.2. Përllogaritja e vuajtjes së dënimit³⁶

Kodi Penal, në paragrafin e parë të nenit 64, parashikon se periudha minimale e detyrueshme e vuajtjes së dënimit me burgim është: - jo më pak se gjysmën e dënimit të dhënë për kundërvajtje penale; - jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi gjer në pesë vjet burgim; - jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi mbi 5 vjet deri në maksimumin e parashikuar nga ligji. Kjo do të thotë se për veprat penale për të cilat dispozitat e posaçme kanë parashikuar dënime që shkojnë deri në dy vjet – e për rrjedhojë sipas paragrafit të dytë të nenit 32 të Kodit Penal janë kundërvajtje penale, – periudha e detyrueshme dhe minimale e vuajtjes së dënimit me burgim do të jetë jo më pak se gjysma e dënimit të dhënë nga gjykata. Kjo do të thotë se ligji penal

³⁵ Konstatim i gabuar i Inspektorit, pasi grupi i magjistratëve në punimin e kryer në vitin 2020 janë përllogaritjen e kohës së burgimit mbi masën e dënimit të dhënë nga gjykata dhe jo mbi masën e dënimit që parashikon dispozita penale për të cilën është dënuar personi. Në vijim në këtë vendim jepet edhe mendimi i grupit të magjistratëve i vitit 2020 në lidhje me problematikat e konstatuara në çështjet penale me objekt "Lirim me kusht".

³⁶ Faqe nr.239 e "Manual për Dënimet Alternative në Republikën e Shqipërisë"

ka parashikuar mundësinë e pezullimit maksimumi të gjysmës së dënimit me burgim për kundërvajtje penale të dhënë nga gjykata. Duhet të mbahet parasysh se ka dy momente vlerësimi për zbatimin e saktë të këtij rregullimi ligjor. Së pari, duhet të dallohet se për efektet e përcaktimit të periudhës minimale të përgjithshme apo teorike të vuajtjes së dënimit me burgim, nuk do të merret masa e dënimit me burgim e dhënë nga gjykata në vendimin përfundimtar të dënimit. Përkundrazi, për këtë kriter të zbatimit të premisë fillestare të hipotezës së normës (praemisa majore), do të merret marzhi maksimal i parashikuar apriori në ligj për veprën e kryer. Pasi konkludohet se kemi të bëjmë me kundërvajtje penale, sikurse ka kualifikuar gjykata veprën në vendimin përfundimtar, atëherë mbi këtë dënim të individualizuar do të zbatohet periudha minimale e vuajtjes së dënimit me burgim (praemisa minor). Nga ana tjetër, për dënimet me burgim deri në 5 vjet, kërkesa për lirim me kusht nuk mundet të ushtrohet dhe se ky dënim alternativ mundet të jepet nga gjykata pasi të kenë kaluar jo më pak se dy të tretat e masës së dënimit me burgim të individualizuar në vendimin përfundimtar të gjykatës. Fillimisht duhet të mbahet parasysh se pika e dytë e këtij parashikimi ligjor ka të bëjë ekskluzivisht vetëm për dënimet me burgim të dhëna për krimet. Kundërvajtjet penale janë të përjashtuara apriori nga pika e parë e rregullimit dhe nga fakti se maksimumi i dënimit me burgim për to shkon deri në dy vjet. **Për rrjedhojë konkludojmë se, për krimet të cilat gjykata ka individualizuar një dënim nga 5 ditë deri në 5 vjet, pavarësisht llojit të figurës së veprës penale për të cilën autori është dënuar, periudha minimale e dënimit me burgim që duhet të vuhet në mënyrë që të aksesohet lirimi me kusht, është masa e dy të tretave të dënimit të individualizuar në vendimin e gjykatës.**

97. Në Inspektim Tematik në Gjykata dhe Prokurori, Inspektori në lidhje me momentin kohor³⁷ që do të merret në konsideratë, referuar kohës së paraqitjes së kërkesës për lirim me kusht, shprehet si vijon:

Gjithashtu një çështje e rëndësishme e evidentuar gjatë trajtimit të vendimarrjeve objekt i këtij inspektimi, lidhur me përlllogaritjen e kohës së vuajtjes së dënimit të detyrueshëm për të patur të drejtë përfitimi të lirimit me kusht, është edhe momenti kohor që do të merret në konsideratë referuar kohës së paraqitjes së kërkesës.

Përsa i përket këtij drejtimi, konstatohet se janë ndeshur dy qëndrime. Njëri sipas të cilës përlllogaritja e kohës së vuajtjes së dënimit duhet të përfshijë vetëm periudhën kohore deri në datën e paraqitjes së kërkesës dhe tjetra se në këtë përlllogaritje përfshihet jo vetëm periudha deri në datën e paraqitjes së kërkesës, por edhe periudha në vazhdim të shqyrtimit të kërkesës që përfundon me disponimin nga ana e gjykatës me vendimin përkatës.

Përkrahësit e qëndrimit të parë, në vendimarrjet e tyre arsyetojnë duke u nisur nga interpretimi i ngushtë i dispozitës, sipas të cilit të dënuarit i lind e drejta për të paraqitur kërkesë për lirim me kusht, nëse më parë ka përmbushur periudhën minimale dhe të detyrueshme të vuajtjes së dënimit me burgim. ndërsa përkrahësit e qëndrimit të dytë arsyetojnë duke u nisur nga një interpretim më i zgjeruar në funksion të qëllimit të këtij

³⁷ Faqe 173 e Raportit të Inspektimit Tematik

instituti sipas të cilit përmbushja e këtij kushti do të konsiderohet i përmbushur në kohën e shqyrtimit të kërkesës të të dënuarit nga gjykata, dhe jo në kohën e përpilimit të kërkesës.

Nga vendimet gjyqësore të gjykatave të rretheve gjyqësore, konstatohet se në pjesën më të madhe nga gjyqtarët mbahet qëndrimi i dytë. Qëndrimi i parë, konstatohet se është mbajtur: nga 1 gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë: 1 gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, nga 1 gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, nga të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, nga 2 gjyqtarë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier në disa vendime dhe të cilët më pas kanë kaluar në ndjekjen e qëndrimit të dytë, nga 2 gjyqtarë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat dhe nga 1 gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Ndërsa qëndrimi i dytë, konstatohet se është mbajtur nga të gjithë gjyqtarët e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Elbasan. Krujë. Gjirokastrë, Lezhë. Tropojë. Shkodër.

Nga vendimet gjyqësore të Apelit, për rastet që ka shqyrtuar ankimet e prokurorëve ndaj vendimeve të pranimit të gjykatave të rretheve gjyqësore me objekt "lirim me kusht", ku ndër të tjera nga ana e prokurorëve është pretenduar për mospërmbushje të kushtit të plotësimit të kohës së vuajtjes së dënimit deri në datën e paraqitjes së kërkesës, nuk është evidentuar ndonjë rast për ndryshimin e vendimit për shkaqe të përllogaritjes së kohës së vuajtjes së dënimit në mënyrë të përditësuar. Raste të tilla, janë vënë re kryesisht në Gjykatën e Apelit Korçë ku të gjithë prokurorët që kanë përfaqësuar prokurorinë në kërkesa me objekt "lirim me kusht", kanë mbështetur ankimin e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Korçë për përllogaritjen e kohës minimum deri në datën e paraqitjes së kërkesës. Dhe po kështu edhe në 1 rast në Gjykatën e Apelit Durrës, ku prej prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është ushtruar ankim pikërisht lidhur me këtë kriter objektiv. Në Gjykatën e Apelit Vlorë, është vënë re në rastet e ankimeve të tre prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, të cilët janë shprehur gjithmonë në qëndrimet e tyre para gjykatës për përllogaritje të masës së dënimit të vuajtur deri në datën e paraqitjes së kërkesës. Për këto raste, ashtu si edhe në rastet e Gjykatës të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe të Apelit Korçë, këto qëndrime të këtyre prokurorëve nuk janë pranuar.

Nga vendimet gjyqësore të Apelit, për rastet që ka shqyrtuar ankimin e kërkuetit ndaj vendimeve të rrëzimit të gjykatave të rretheve gjyqësore me objekt "lirim me kusht, ku shkak i rrëzimit ka qenë pikërisht mospërmbushja e kohës së vuajtjes së dënimit deri në datën e paraqitjes së kërkesës, janë evidentuar në tre raste qëndrimi. një i Gjykatës së Apelit Durrës dhe dy të Gjykatës së Apelit Korçë mbi konkludimin prej saj, të përmbushjes së këtij kriteri me vazhdimin e gjykimit.

Gjithashtu është për t'u evidentuar se edhe në vendimarrjet e Gjykatës së Apelit edhe kur nuk ka patur ankim lidhur me kushtin në fjalë, nga ana e trupave gjyqësore është arsyetuar duke u mbështetur në mënyrën e të proceduarit të përditësuar lidhur me përllogaritjen e kohës së vuajtjes së dënimit.

Lidhur me parashikimin e dispozitës në fjalë, në drejtimin e përllogaritjes së kohës së vuajtjes së dënimit objekt i këtij shqyrtimi, ka edhe një qëndrim nga një grup tjetër magjistratësh, në një studim të bërë në vitin 2020. Ky grup magjistratësh kanë shprehur qëndrimin e tyre që përkon me përllogaritjen e përditësuar të vuajtjes së dënimit me burgim. Lidhur me këtë qëndrim, autorët arsyetojnë se "... megjithëse është korrekt me shkronjën e ligjit, nuk i

shërben as miradministrimit të drejtësisë penale, as vetë ratio-s së institutit, as gjykatës, as të dënuarit dhe aq më pak shoqërisë. Ndaj vlerësojmë se kërkesa, pavarësisht se e bërë në një datë më të hershme se sa lejon afati ligjor, nuk mundet të përbëjë pengesë ligjore kundrejt gjykatës që - në rast se në momentin e shqyrtimit vlerëson se afati është plotësuar të vendosë pranimin e saj për shqyrtim në zgjidhjen në themel të kërkesës.... sakaq konstatohet se kjo mënyrë formaliste interpretimi detyron vuajtjen e dënimit me burgim edhe me gjashtë muaj për një të dënuar që potencialisht nuk duhet të vuajë më dënim me burgim. Rezultati i këtij interpretimi është padyshim antikushtetues dhe i paligjshëm".

Aktualisht nga vendimet gjyqësore objekt shqyrtimi në Gjykatën e Lartë evidentohet 1 (një) rast kur interpretimi i nenit 64 të K. Penal në drejtimin në fjalë, është bërë objekt trajtimi duke përcaktuar qëndrimin e saj. Rasti në fjalë i përket një vendimi kolegjesht" dhe jo unifikues, (**Vendimi Nr. 00-2023-66 Datë 13.01.2023. ku është arsyetuar se shprehja "personi lirohet me kusht do të thotë se, kërkesa pranohet dhe personi lirohet pasi të zhvillohet një hetim gjyqësor dhe të shpallet vendimi dhe jo në momentin që paraqitet kërkesa. Gjykata ka arsyetuar edhe më tej se ky kusht i plotësimit të afateve të kërkuara për vuajtjen e dënimit nuk është ngushtësisht e karakterit formal në momentin që paraqitet kërkesa, por se gjykata deri në momentin që personi është në gjykim pranë saj, do të duhet të vlerësojë sjelljen e kërkuarit deri në shpalljen e vendimit ndaj të cilit nuk duhet të jetë indiferente.**

Ndërkohë që rezulton se **në vendime të mëparshëm të kolegjeve, Gjykata e Lartë argumenton plotësimin e kohës minimum të vuajtjes së dënimit duke e lidhur përllogaritjen me momentin e depozitimit të kërkesës. Kështu në vendimin nr. 00-2017-576 datë 05.07.2017 kolegji shprehet se: "Plotësimi i kalimit të periudhës përkatëse të vuajtjes së dënimit me burgim, është një element ligjor që duhet të verifikohet nga ana e gjykatës në çastin e paraqitjes së kërkesës, dhe në nr. 00-2021-1066. i vendimit (125) datë 07.12.2021, kolegji argumenton se: Në lidhje me vendimin e rekursuar. Kolegji vlerëson se Gjykata e Apelit Durrës ka disponuar në kundërshtim me kërkesat e ligjit penal material. Neni 64 i Kodit Penal parashikon se të dënuarit i lind e drejta për të kërkuar lirin me kusht, kur plotëson apo ka vuajtur më shumë se 3/4% e dënimit të caktuar ndaj tij. Në rastin konkret, rezulton se në datë 20.06.2016, kur është paraqitur kërkesa e të dënuarit për "lirim me kusht, nuk plotësuar një nga kushtet ligjore të parashikuara në këtë dispozitë vuajtja e të dënimit të dhënë ndaj tij, me 25 vjet burgim.... Ne rrethanat e sipërcituara. Kolegji çmon se në rastin konkret nuk plotësohet kushti i përcaktuar në nenin 64 të Kodit Penal vuajtja e jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë, kusht ky që duhet të jetë plotësuar në momentin e depozitimit të kërkesës.**

Grupet e magjistratëve, gjyqtarë dhe prokurorë, përkrahës të dy qëndrimeve, siç evidentohen në aktet procedurale përkatëse, mbështeten në arsyetimet e tyre në argumente ligjore si në drejtim të interpretimit literal të dispozitës, ashtu edhe në drejtim të qëllimit të vetë institutit. Këto qëndrime, janë bërë objekt diskutimi si në drejtim të shqyrtimit procedural ashtu edhe studimor, dhe aktualisht duke iu referuar edhe numrit të vendimeve, **evidentohet se qëndrimi mbizotërues është ai i përllogaritjes së kohës së vuajtjes së dënimit për efekt të zbatimit të**

nenit 64 të Kodit Penal, deri në momentin e shpalljes së vendimit, pas shqyrtimit në themel të kërkesës "lirim me kusht". Një qëndrim i tillë megjithëse logjik dhe në funksion të qëllimit të institutit të lirimit me kusht, mbart me vete kujdesin e shtuar që duhet të kenë magistratët gjyqtarë që gjykojnë këto çështje për të shmangur zvarritjet e paarsyeshme të procesit, të cilat mund të bëhen "të qëllimshme" për të arritur gjatë procesit limitin kohor të përmbushjes së afatit minimum dhe të detyrueshëm të kohës së përfitimit të vuajtjes dënimit nga i dënuari që kërkon lirimin me kusht. Nga vendimet gjyqësore të trajtuara nuk u evidentuan zgjatje të procesit, të tilla që të mund të përmbushnin të gjitha kriteret ligjore të parashikuar në nenin 124 të ligjit me nr. 96/2016 të ndryshuar, për t'u proceduar më tej me fillimin e një hetimi disiplinor.

Lidhur me qëndrimet sa më sipër, në konsideratat që edhe midis vendimeve të kolegjeve të Gjykatës së Lartë ka qëndrim të ndryshëm, vlerësohet si e rëndësishme autoriteti i Gjykatës së Lartë për unifikimin e vendimarrjes së gjykatave të zakonshme.

98. Manuali mbi “Dënimet Alternative në Republikën e Shqipërisë”, viti 2020

v) Përlllogaritja e përditësuar e periudhës së vuajtjes së dënimit me burgim³⁸.

Një çështje tjetër që mund shkaktojë diskutim është edhe pyetja nëse gjykata do të duhet ta përlllogarisë periudhën minimale dhe të detyrueshme të vuajtjes së dënimit me burgim në momentin e paraqitjes së kërkesës për lirim me kusht në gjykatë, apo do të duhet të ushtrojë një kontroll të përditësuar të kësaj periudhe edhe gjatë ekzekutimit dhe deri në momentin e dhënies së vendimit përfundimtar mbi kërkesën.

Jurisprudenca Italiane ka mbajtur qëndrimin se, për efekt të përlllogaritjes së afatit minimal të dënimit me burgim që duhet të vuhet nga të dënuarit me burgim të përjetshëm, para se atyre t'u lindë e drejta të kërkojnë lirimin me kusht, gjykata do të duhet t'i referohet datës kur është paraqitur kërkesa dhe jo një date të mëvonshme.

Megjithatë vlerësojmë se, një formalizëm i tillë, megjithëse është korrekt me shkronjën e ligjit, nuk i shërben as miradministrimit të drejtësisë penale, as vetë ratio-s së institutit, as gjykatës, as të dënuarit dhe aq më pak shoqërisë. Ndaj vlerësojmë se kërkesa, pavarësisht se e bërë në një datë më të hershme se sa lejon afati ligjor, nuk mundet të përbëjë pengesë ligjore kundrejt gjykatës që - në rast se në momentin e shqyrtimit vlerëson (Shih Vendimin nr. 35648, datë 01.10.2001 të Seksionit Penal të Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë.) se afati është plotësuar – të vendosë pranimin e saj për shqyrtim dhe zgjidhjen në themel të kërkesës. Një qëndrim i tillë formal do të detyronte që minimumi edhe 6 muaj i dënuari të qëndrojë sërish në burgim, vetëm për faktin se neni 477, pika 2, e Kodit të Procedurës Penale parashikon se kjo kërkesë nuk mundet të paraqitet pa kaluar një afat prej gjashtë muajsh nga momenti që vendimi i rrëzimit të kërkesës të ketë marrë formë të prerë. Sakaq konstatohet se kjo mënyrë formaliste interpretimi detyron vuajtjen e dënimit me

³⁸ Faqe nr. 242 e “Manual mbi Dënimet Alternative në Republikën e Shqipërisë”

burgim edhe me gjashtë muaj për një të dënuar që potencialisht nuk duhet të vuajë më dënim me burgim.

Rezultati i këtij interpretimi është padyshim antikushtetues dhe i paligjshëm. Në praktikën gjyqësore të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit, të cilat janë studiuar për qëllimet e këtij studimi, është konstatuar se është pranuar në mënyrë konstante dhe të përgjithshme se afati i periudhës minimale të vuajtjes së dënimit me burgim për qëllimet e akordimit të lirimit para kohe me kusht përllogaritet në mënyrë të përditësuar, deri në momentin e dhënies së vendimit përfundimtar.

Ndryshe ka qenë qëndrimi i prokurorisë në këto seanca gjyqësore, e cila ka kërkuar që gjykata të mbajë qëndrimin formal të përllogaritjes së plotësimit apo jo të kësaj periudhe sipas datës së dorëzimit në gjykatë të kërkesës. Sigurisht kjo mënyrë interpretimi shmang formalizmat e tepruara dhe garanton më shumë aksesin e të dënuarve tek ky lloj dënimi alternativ, duke i dhënë më shumë përparësi themelit të kushteve apo kriterëve ligjore sesa aspekteve formale. Për më tepër, në rastin e Shqipërisë këtë mënyrë vlerësimi të përditësuar të përllogaritjes së periudhës minimale të vuajtjes së dënimit me burgim, e kushtëzon edhe sentenca e dytë nomofilatike e Vendimit Unifikues 2/2015 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Në këtë pjesë të vendimit është unifikuar praktika gjyqësore duke vendosur se: “Në rastin kur gjykata pranon kërkesën e të dënuarit për lirim para kohe me kusht, në mbështetje të nenit 64 të Kodit Penal dhe të ligjit nr.8331, datë 21.04.1998 “Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale” ajo cakton një periudhë kohe ku i dënuari detyrohet të mbajë kontakte me shërbimin e provës si dhe vendos, sipas rastit, një ose më shumë detyrime në bazë të nenit 60 të Kodit Penal. Në mungesë të një rregullimi të saktë ligjor, koha e provës do të jetë e barabartë me kohën e mbetur të masës së dënimit me burgim për të dënuarin që lirohet me kusht.”. Për rrjedhojë konkludojmë se gjykata e ka detyrë ligjore që të kontrollojë dhe të përllogarisë afatin e periudhës së vuajtur të dënimit në mënyrë të përditësuar dhe deri në momentin e vendimarrjes përfundimtare, pasi vetëm në këtë mënyrë ajo do të jetë në gjendje që të përcaktojë me saktësi se sa është periudha e mbetur e dënimit me burgim, e cila do të pezullohet dhe që do të shërbejë për të përcaktuar kohëzgjatjen e dënimit alternativ të lirimit me kusht. Për rrjedhojë konkludojmë se, gjykatat janë të detyruara të përllogarisin në mënyrë të përditësuar kohën e vuajtur dhe të mbetur të dënimit me burgim dhe se kjo përllogaritje do të duhet të bëhet deri në momentin e dhënies së vendimit përfundimtar mbi kërkesën e lirimit me kusht.

99. Në rubrikën “Konkluzione”, Inspektori në Raportin Tematik në Gjykata dhe Prokurori, shprehet³⁹:

Gjykatat e rretheve gjyqësore, në përgjithësi, në përllogaritjen e periudhës minimum të vuajtjes së dënimit në drejtim të interpretimit të parashikimit të dispozitës 64/1 të K. Penal "- jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi deri në pesë vjet burgim: - jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi mbi 5 vjet deri në maksimumin e parashikuar nga ligji, me përjashtim të parashikimeve në paragrafin

³⁹ Faqe nr. 217 e Raportit të Inspektimit Tematik

3 të këtij neni", evidentohet se kanë ndjekur dy praktika në mënyrën sesi përllogaritet kjo periudhë: një praktikë konsiston në interpretimin e dispozitës në fjalë referuar masës së dënimit që parashikon dispozita e veprës penale për të cilën kërkuesi është i dënuari dhe praktika tjetër konsiston në interpretimin e dispozitës në fjalë referuar masës së dënimit të dhënë nga gjykata.

Në ndjekjen e këtyre praktikave, referuar vendimeve gjyqësore rezulton se gjyqtarët mbështeten në të njëjtën bazë ligjore, por duke konkluduar ndryshe, pa ndonjë analizë arsyetim konkret, lidhur me referimin përkatës. Praktika e parë rezulton të jetë ndjekur nga pjesa më e madhe e gjyqtarëve të gjykatave të rretheve gjyqësore. Ndjekja e dy praktikave, nga gjykatat e rretheve gjyqësore nuk është bërë objekt ankimi nga prokurorët e rretheve gjyqësore dhe nga vendimarrjet e të gjithë gjykatave të apeleve nuk vihet re ndonjë qëndrim i qartë në këtë drejtim. **Nga këto vendimarrje të gjykatave të apelit, evidentohet se ka trupa gjykatash të cilat përdorin arsyetim të qartë lidhur me praktikën që ndiqet, duke u ndalur në mënyrë konkrete në interpretimin e dispozitës në fjalë referuar masës së dënimit që parashikon dispozita, ndërsa ka trupa të tjerë të cilët nuk shprehen saktësisht lidhur me interpretimin që ndjekin. por që pranojnë arsyetimin e gjykatës së rrethit gjyqësor që ka pranuar përllogaritjen përkatëse në të dy praktikat.**

Referuar praktikave sa më sipër, aktualisht është vetëm një vendim i Gjykatës së Lartë, ku Kolegji ka mbajtur qëndrimin e ndjekjes së praktikës së përllogaritjes referuar masës së dënimit të dhënë nga gjykata...

Gjykatat e rretheve gjyqësore në përgjithësi në përllogaritjen periudhës minimum e vuajtjes së dënimit në drejtim të kohës referuar datës së paraqitjes evidentohen se kanë mbajtur dy qëndrime. Njëri sipas të cilës përllogaritja e kohës së vuajtjes së dënimit duhet të përfshijë vetëm periudhën kohore deri në datën e paraqitjes së kërkesës dhe tjetra se në këtë përllogaritje përfshihet jo vetëm periudha deri në datën e paraqitjes së kërkesës, por edhe periudha në vazhdim të shqyrtimit të kërkesës që përfundon me disponimin nga ana e gjykatës me vendimin përkatës. Nga vendimet gjyqësore të gjykatave të rretheve gjyqësore. konstatohet se në pjesën më të madhe nga gjyqtarët mbahet qëndrimi i dytë.

Nga vendimet gjyqësore të Apelit. për rastet që ka shqyrtuar ankimet e prokurorëve ndaj vendimeve të pranimit të gjykatave të rretheve gjyqësore me objekt "lirim me kusht", ku ndër të tjera nga ana e prokurorëve është pretenduar për mospërmbushje të kushtit të plotësimit të kohës së vuajtjes së dënimit deri në datën e paraqitjes së kërkesës, nuk është evidentuar ndonjë rast për ndryshimin e vendimit për shkaqe të përllogaritjes së kohës së vuajtjes së dënimit në mënyrë të përditësuar. **Madje në tre prej vendimeve është analizuar mbi mbështetjen e qëndrimit sipas të cilit përllogaritja e dënimit minimum të vuajtur do të shtrihet përgjatë periudhës së gjykimit deri në momentin e shpalljes së vendimit përfundimtar.**

Nga vendimet e Gjykatës së Lartë, kolegje të ndryshme që kanë shqyrtuar vendimet objekt të këtij inspektimi, evidentohen të dy qëndrimet sa më sipër.

100. Në rubrikën “Rekomandimet” drejtuar Gjykatës së Lartë, Inspektori në raportin tematik shprehet:

Për Gjykatën e Lartë⁴⁰:

Raporti i këtij inspektimi t'i njoftohet Gjykatës së Lartë në kuadër të vlerësimit të çështjeve të regjistruara mbi bazë rekursi që kanë objekt "lirim me kusht" për zhvillimin/njësimin/ndryshimin e praktikës gjyqësore në drejtim të:

- i. përcaktimit të periudhës kohore referuar datës së paraqitjes së kërkesës "lirim me kusht"/datës së gjykimit që do të merret në konsideratë në përllogaritjen e periudhës minimum të vuajtjes së dënimit, për efekte të përfitimit të lirimit me kusht.*
- ii. përcaktimit të mënyrës së interpretimit të parashikimit të dispozitës 64/1 i K. Penal jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi deri në pesë vjet burgim: jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi mbi 5 vjet deri në maksimumin e parashikuar nga ligji. me përjashtim të parashikimeve në paragrafin 3 të këtij neni", referuar qëndrimeve të konstatuar sipas dënimit të dhënë nga gjykata apo dënimit që parashikon dispozita penale për të cilën është deklaruar fajtor dhe dënuar kërkuesi.*
- iii. lidhur me përfshirjen e kohës së punës në përllogaritjen e masës së dënimit të vuajtur e cila i jep mundësi kërkuetit të përfitojë lirin me kusht:*
- iv. interpretimit të kushtit ndalues "përsëritës të parashikuar në nenin 64/3 të K. Pr. Penal në këndvështrim të institutit të rehabilitimit referuar parashikimeve të nenit 69/a të Kodit Penal.*
- v. përcaktimit të kohës së kushtit.*

101. Verifikimi i pretendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në çështjen penale me objekt “Lirim me kusht” të shtetasit {...}.

Rezulton se Gjykata me vendimin nr. 13/21-2018-1692 datë 23.10.2018 ka vendosur :

1. Pranimin e kërkesës. 2. Bazuar në nenin 64 të K.Penal, lirin e të dënuarit {...}, duke urdhëruar pezullimin e pjesës së mbetur pavuajtur prej 3 (tre) muaj e 28 (njëzet e tetë) ditë burgim, të dënimit të dhënë me vendimin nr. 394, datë 23.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, duke e vënë në provë të dënuarin {...}, për një periudhë prej 3 (tre) muaj e 28 (njëzet e tetë) ditë. 3. Urdhërohet i dënuari {...} që gjatë kësaj periudhe prove, të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës që mbulon vendbanimin e tij. 4. Në aplikim të nenit 60/9 të K.Penal, urdhërohet të mos shoqërohet me persona të dënuar. 5. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të dënuarit {...}, nëse nuk mbahet I ndaluar për ndonjë shkak tjetër ligjor

⁴⁰ Faqe nr. 223 e Raportit të Inspektimit Tematik

Në arsyetimin e vendimit gjykata shprehet si vijon: ...” Në funksion të dhënies së një vendimi të drejtë , Gjkata vlerëson, se përpara saj shtrohen për shqyrtim këto çështje:

1. A plotëson kërkuesi kushtet procedurale të parashikuara në nenin 477 të K.Pr.Penale?
2. A plotëson kërkuesi kushtet materiale për të përfituar lirim me kusht, parashikuar në nenin 64 të K.Penal?

Në lidhje me pyetjen e parë, Gjkata konstaton se në nenin 477 të K.Pr.Penale janë parashikuar kushtet procedurale, të nevojshme për plotësim nga kërkuesi, që më pas gjykata të mund të marrë në shqyrtim plotësimin ose jo, të kushteve materiale parashikuar në nenin 64 të K.Penal.

Në nenin 477 të K.Pr.Penale parashikohet se “1. Gjkata e vendit të ekzekutimit vendos për lirimin me kusht dhe revokimin e vendimit të lirimit me kusht, sipas kriterëve të caktuara në Kodin Penal. 2. Kërkesa nuk mund të përsëritet para se të kenë kaluar gjashtë muaj nga dita kur vendimi i rrëzimit të kërkesës ka marrë formë të prerë.

Në interpretim të dispozitës së mësipërme, kërkohet që i dënuari të plotësojë kumulativisht këto kushte:

1. Të paraqesë kërkesë në Gjykatën e vendit të ekzekutimit.
2. Të mos ketë paraqitur më parë kërkesë për lirim me kusht, e cila të jetë rrëzuar nga gjykata, jo më afër se 6 muaj nga paraqitja e kërkesës në shqyrtim.

Në lidhje me pikën e parë, Gjkata konstaton se kërkuesi është dënuar me 15 muaj burgim, dënim që është duke e vuajtur në {...} Tepelenë. {...} Tepelenë është nën juridiksionin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër dhe në këto kushte kjo gjykatë ka kompetencë tokësore, lëndore dhe funksionale për gjykimin e kërtimeve bazuar në nenin 477 të K.Pr.Penale.

Në lidhje me pikën e dytë, rezulton se sipas Vërtetimit nr. 1581 prot., datë 23.10.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, provohet se kërkuesi nuk ka paraqitur kërkesë me objekt lirim me kusht për periudhën Janar – 20 Shtator 2018. Në këto kushte, gjykata vlerëson se plotësohet edhe kushti i dytë për mos paraqitjen dhe rrëzimin nga gjykata, brenda 6 muajve nga paraqitja e kërkesës në shqyrtim, të një kërkesë të mëparshme për lirim me kusht nga kërkuesi {...}.

Për sa më sipër Gjkata vlerëson se nga kërkuesi plotësohen kumulativisht kushtet e vendosura në nenin 477 të K.Pr. Penale dhe do të proçedoj me marrjen në shqyrtim të kushteve materiale të vendosura në nenin 64 të K.Penal.

Në lidhje me pyetjen e dytë, gjykata konstaton se në nenin 64 të K.Penal parashikohet se “I dënuari me burgim mund të lirohet me kusht, nga vuajtja e dënimit vetëm për arsye të veçanta, nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij, si dhe të ketë vuajtur:

- jo më pak se gjysmën e dënimit të dhënë për kundërvajtje penale;

- jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi gjer në pesë vjet burgim;

- jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi mbi 5 vjet deri në maksimumin e parashikuar nga ligji, me përjashtim të parashikimeve në paragrafin 3 të këtij neni.

Në masën e dënimit të vuajtur nuk llogaritet koha e përfituar me amnisti ose falje.

Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje si dhe për të dënuarit për kryerjen e veprave penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c apo paragrafi i tretë i nenit 100.

Në interpretim të dispozitës së mësipërme, gjykata vlerëson që nga kërkuesi duhet të plotësohen kumulativisht këto kushte:

1. Të ketë kryer jo më pak se 3/4-tat e dënimit të dhënë.
2. Të mos jetë përsëritës për krime të kryera me dashje, si dhe të mos jetë dënuar për veprat penale, të parashikuara nga nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c dhe 100/3 të K.Penal.
3. Ekzistencën e arsyeve të veçanta, nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij.

Në lidhje me kushtin e parë gjykata konstaton se kërkuesi {...} me vendimin nr. 23-2016-2524 (394) datë 23.12.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, kërkuesi {...} është dënuar me 15 muaj burgim.. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr. 20-2017-303/81 datë 18.04.2017. Vendimi i mësipërm i gjykatës është ekzekutuar në datën 21 Nëntor 2017, që është data e llogaritjes së vuajtjes së dënimit. Sipas dinamikës së vuajtjes së dënimit, deri në datën 24.09.2018, i dënuari ka vuajtur 10 muaj e 3 ditë burgim. I mbeten për të vuajtur 4 muaj e 27 ditë. Ndërkohë që në ditën e shpalljes së vendimit, i mbeten pa vuajtur 3 muaj e 28 ditë burgim. Kryerja e 11 muajve e 3 ditëve burgim, në 15 muaj dënim, plotëson kriterin e parashikuar nga ligji, të 2/3-tave të dënimit të kryer.

Në lidhje me kushtin e dytë, gjykata konstaton se kërkuesi {...}, sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore, nr. 17 prot., datë 20.08.2018 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, rezulton se është i padënuar më parë.

Në lidhje me kushtin e tretë për ekzistencën e arsyeve të veçanta, nëse me sjelljen dhe punën e tij, i dënuari tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij gjykata vlerëson se Ligjvënësi duke përdorur shprehjen “ arsye të veçanta” ka bërë një vlerësim të përgjithshëm , pa i nominuar ato e duke e lënë në vlerësim të gjykatës sipas rrethanave konkrete që i paraqiten. Megjithatë këto “ arsye të veçanta” nuk janë të pavarura dhe duhet të jenë të lidhura ngushtë me qëllimin e institutit të lirimut para kohe me kusht, i cili ka të bëjë me riedukimin dhe riintegrimin në shoqëri të të dënuarit. Arsyet e veçanta nuk janë gjë tjetër veçse rrethana konkrete, të cilat provojnë se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi për edukimin dhe i dënuari është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri. Ky integrim i paragrafit të parë të nenit 64 të K. Penal të çon në konkluzionin logjik se kemi të bëjmë me një kusht të vetëm dhe “ arsyet e veçanta” nuk janë gjë tjetër veçse fakte të cilat provojnë se me pjesën e dënimit të vuajtur është arritur qëllimi i dënimit penal , në rastin konkret për edukimin e të dënuarit dhe ai është i gatshëm të ri integrohet në shoqëri.(Vendimi Unifikues Nr. 1 i Regj.Themeltar, Nr. 2 i Vendimit i Gjykatës së Lartë).

Sa më sipër, ky trup gjykues në vlerësimin e “ arsyeve të veçanta ” në funksion të edukimit dhe riintegrit të kërkuesit në shoqëri, mban në konsideratë raportet e vlerësimit të kryera nga {...} Tepelenë dhe Shërbimi i Provës Zyra Vendore Gjirokastër, të cilat kanë vlerësuar pozitivisht sjelljen e kërkuesit në {...} gjatë kohës së vuajtjes së dënimit si dhe mundësinë për rehabilitim dhe risocializim në shoqëri.(për më tepër shih raportet e vlerësimit të {...} dhe Shërbimit të Provës).

Nga kërkuesi krahas vlerësimit pozitiv të kryer nga {...} Tepelenë dhe Shërbimi i Provës Gjirokastër, u paraqitën dhe shkaqe familjare për të mbështetur kërkesën për lirimin me kusht. Kërkuesi ka nisur një jetë të re, duke paraqitur edhe një kontratë bashkëjetese me shtetasen H.N, formalizuar nga noteri me aktin nr. 1315/718 datë 22.12.2017. Nëpërmjet vërtetimit datë 03.10.2017, administratori i shoqërisë “ Vëllezërit{...}” marrin përsipër punësimin e kërkuesit. Sipas karakteristikës familjare, kryer nga Kryetari i Bashkisë Delvinë, rezulton se familja e kërkuesit shqyhet për qëndrim korrekt në komunitet. Vajza e tij vazhdon studimet universitare dhe është në vështirësi ekonomike për shkak të burgimit të të atit, si dhe nëna e tij, ka probleme me shëndetin.

Gjykata, në analizë të fakteve treguar në aktet e vlerësimit të {...} Tepelenë dhe Shërbimit të Provës, Zyra Vendore Gjirokastër, faktit se gjatë gjithë periudhës së vuajtjes së dënimit kërkuesi ka treguar një sjellje të mirë, vlerëson se me pjesën e vuajtur të dënimit i është arritur qëllimit për edukimin, rehabilitimin dhe risocializimin e të dënuarit {...}.

Në këto kushte plotësohet edhe kushti i arsyeve të veçanta ku me punën dhe sjelljen e tij dhe pritshmëritë për të ardhmen, kërkuesi tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij.

Sa më sipër gjykata vlerëson se kërkuesi {...} plotëson kriteret e vendosura nga neni 64 i K.Penal për të përfitur lirimin me kusht për pjesën e pavuajtur të dënimit”⁴¹

102. Bazuar në arsyetimin e mësipërm të gjykatës, në raport me provat e shqyrtuara dhe administruara në gjykimin e çështjes, Këshilli vlerëson arsyetim të saktë dhe respektim të kriterëve ligjore të parashikuara në nenet 477 të K.Pr.Penale dhe 64 të Kodit Penal.

103. Inspektori në lidhje me këtë çështje, pretendon se shtetasi {...} ka qenë i dënuar më parë për veprën penale “ *Mosdhënie e mjeteve për jetesë*” parashikuar nga neni 125 i K.Penal, me vendimin nr. 195 datë 21.07.2016 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

103.1. Këshilli vlerëson se në gjykimin e çështjes është paraqitur certifikatë e gjendjes gjyqësore e të dënuarit, i cili rezultonte i padënuar më parë. Asnjë nga palët pjesëmarrëse në gjykim nuk ka pretenduar ekzistencën e një dënimi të mëparshëm të personit. Akti zyrtar i lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve lidhur me gjendjen gjyqësore të personit, është akt me fuqi të plotë provuese dhe as gjykata dhe as ndonjë institucion tjetër, nuk ka detyrimin që kryesisht të verifikojë vërtetësinë e të dhënave të treguara në këtë akt, pa një

⁴¹ Këtë strukturë arsyetimi të vendimit gjyqësor, Këshilli e konstaton në të gjitha vendimet objekt shqyrtimi në këtë procedim disiplinor.

pretendim të personave të interesuar. Në rastin në shqyrtim rezulton se as {...}, as Shërbimi i Provës dhe as Prokurori i çështjes nuk kanë pretenduar ekzistencën e një dënimi të mëparshëm penal për të dënuarin kërkues.

103.2. Gjithashtu Këshilli evidenton se dënimi i mëparshëm i shtetasit {...} për një kundërvajtje penale, nuk përbën kusht ndalues për të qenë subjekt dhe përfitues nga neni 64 i K.Penal. Neni 64 i K.Penal ndalon lirimin me kusht për të dënuarin për krime të kryera me dashje dhe jo për kundërvajtje penale.

103.3. Lidhur me pretendimin e Inspektorit se dënimi penal i mëparshëm i kërkuesit, në vlerësim me provat e tjera duhet ta kishin çuar gjykatën në një vendim tjetër, atë të rrëzimit të kërkesës, Këshilli arsyeton se **shqyrtimi dhe vlerësimi i pretendimeve të palëve dhe provave gjatë një procesi gjyqësor është atribut vetëm i pushtetit gjyqësor. Vendimet gjyqësore kontrollohen vetëm nga gjykata më e lartë dhe asnjë organ tjetër nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve gjyqësore, për sa kohë ato nuk janë ndryshuar ose prishur nga një gjykatë më e lartë**".

103.4. **Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. Vendimin nr.11, datë 27.05.2004 është shprehur se “ KLD-ja mund të marrë masa disiplinore ndaj gjyqtarëve pa e kushtëzuar atë me faktin nëse ky vendim ka marrë formë të prerë,⁴² vetëm për raste kur vendimet shoqërohen me akte dhe sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit dhe cënojnë në përgjithësi prestigjin dhe autoritetin e pushtetit gjyqësor.**

103.5. Në respektim të vendimarrjes së mësipërme të Gjykatës Kushtetuese, Këshilli analizon se në çështjen në shqyrtim, në kushtet kur vendimi është i formës së prerë, kërkohet ekzistenca e shkeljeve ligjore që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit dhe cënojnë në përgjithësi prestigjin dhe autoritetin e pushtetit gjyqësor.

103.6. Referuar fakteve objekt shqyrtimi, Këshilli nuk konstaton asnjë shkelje të dispozitave ligjore nga magjistrati {...} në gjykimin dhe vendimarrjen për lirimin me kusht të shtetasit {...}. Gjatë gjykimin të kësaj çështje konstatohet interpretim i saktë i dispozitave procedurale të treguara në nenin 477 të K.Pr.Penale si dhe të atyre materiale të parashikuara në nenin 64 të K.Penal.

103.7. Për sa më sipër, në lidhje me pretendimin e Inspektorit për shkelje të dispozitave ligjore me pasojë lirimin e padrejtë të shtetasit {...}, Këshilli vlerëson se nga ana e magjistratit, “ **nuk ka asnjë shkelje ligjore**”.

104. **Në lidhje me çështjen penale me objekt “ Ulje dënimi” të shtetasit {...}, Këshilli konstaton se i dënuari {...} ka paraqitur kërkesë për “Uljen e dënimit”, regjistruar me nr. regj Them. 124/80001-00723-21-2021, datë regj.13.09.2021. Me vendimin nr. 21-2021-1574/124, datë 23.09.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, është vendosur ulja e dënimit me 90 (nëntëdhjetë) ditë, të dhënë me vendimin nr.23-2020-506/98 datë 21.04.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, lënë në fuqi me vendimin nr. 36, datë 30.09.2021 të**

⁴² Vendim nr.29, datë 30.04.2001 i Gjykatës Kushtetuese

Gjykatës së Apelit Gjirokastër, për periudhën e vuajtjes së dënimit, nga data 11.09.2020 deri në datën 12.09.2021.

104.1. Në gjykimin e kësaj kërkesë, në konkluzionet përfundimtare, përfaqësuesi i {...} ka kërkuar pranimin e kërkesës, Prokurori ka kërkuar pranimin e kërkesës dhe Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës. Vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar nga asnjë nga palët.

104.2. Inspektori pretendon se gjykata ka arsyetuar mbi një dispozitë të shfuqizuar, nenin 63 të ligjit 8328/1998 “ *Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim*”, ndërkohë që në kohën e gjyimit ka qenë në fuqi ligji nr. 81/2020 “ *Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe paraburgosurve*”, neni 75.

104.2.1. Këshilli konstaton se referuar vendimit të gjykatës, rezulton se në pjesën “Ligji i zbatueshëm”, janë shënuar dy dispozita ligjore me përmbajtjen e tyre: **e para neni 480 i K.Pr.Penale dhe e dyta, neni 75 i ligjit nr. 81/2020.**

104.3. Në seancën e zhvilluar në KLGJ në datën 19.03.2024, Inspektori është shprehur se kriteret e analizuar nga gjykata në vendimin për ulje dënimi, janë ato të parashikuara nga neni 63 i ligjit nr. 8328/1998 dhe jo ato të nenit 75 të ligjit nr. 81/2020.

104.4. Në lidhje me këtë pretendim, Këshilli arsyeton se në nenin 63 të ligjit 8328/1998 të shfuqizuar parashikohet se “ *“Të dënuarit që zbatojnë rregullat dhe kanë pjesëmarrje shembullore në veprimtaritë trajtuese, duke dhënë prova për riintegrim në shoqëri , mund të përfitojnë një ose disa ulje , deri në 90 ditë në çdo vit të vuajtjes së dënimit....”*

104.5. Në nenin 75 të ligjit nr. 81/2020 parashikohet se “ *I dënuari që zbaton rregullat e brendshme të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale dhe ka një sjellje të mirë duke e treguar me pjesëmarrje aktive dhe pozitive në veprimtaritë rehabilituese dhe riintegruese gjatë kryerjes së dënimit, bazuar në raportin e vlerësimit, që përgatitet nga institucioni, mund të përfitojë ulje dënimi deri 90 ditë në çdo vit të kryerjes së dënimit.....”*

104.6. Këshilli vlerëson se këto dy dispozita nuk kanë asnjë ndryshim në kriteret që duhet të plotësojë i burgosuri për të përfituar ulje dënimi. Konstatohet se formulimi në thelb është i njëjtë, ku në të dyja dispozitat parashikohet që i dënuari zbaton rregullat e institucionit dhe merr pjesë në veprimtari rehabilituese, riintegruese. Në këto kushte, analiza e kriterëve të kryera nga gjykata në vendimin për uljen e dënimit për shtetasin “ {...}” konsiderohet se është kryer në përputhje me ligjin në fuqi, nenin 75 të ligjit nr. 81/2020 “ *Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*” .

104.7. Përveç konstatimit të mësipërm, Këshilli vlerëson se interpretimi i ligjit është atribut vetëm i gjykatës. Legjislatori nxjerr ligje, por se çfarë ka dashur të thotë legjislatori në ligj, e thotë gjykata në vendimarrjet e saj. Interpretimi i gabuar i ligjit nga gjykata mund të konstatohet vetëm nga një gjykatë më e lartë.

104.8. Në vijim të shqyrtimit të pretendimeve të Inspektorit, konstatohet se Inspektori pretendon se “ *Vendimi i uljes së dënimit me 90 ditë, rezulton se është dhënë pa një raport vlerësimi nga {...} për të përfutur maksimumin për kërkuesin sipas nenit 75 të ligjit nr. 81/2020 dhe rregullores së përgjithshme të burgjeve nr.303, datë 25.3.2009, pasi i vetmi vlerësim në këtë periudhë pas vendimit të dënimit të formës së prerë është ai i periudhës si i paraburgosur 27.07.2020-27.01.2021.*

104.9. Referuar dosjes gjyqësore, rezulton se ndodhet i administruar “ **Raport Vlerësimi me objekt Lirim me Kusht**” nr. 155 prot., datë 20.09.2021. Në këtë raport në konkluzionet përfundimtare, {...} Tepelenë është shprehur “ *Mbështetur në vlerësimin e mësipërme Komisioni i vlerësimit të sjelljes shprehet për të dënuarin se karakterizohet nga personalitet pozitiv dhe social, shprehet i motivuar dhe bashkëpunues për arritjen e objektivave të trajtimit. Komisioni për sa më sipër shprehet për pranimin e plotë të kërkesës.*

104.10. Pra, në procesin gjyqësor për uljen e dënimit të të dënuarit {...} është paraqitur dhe është administruar, raporti i vlerësimit i kryer nga {...}, posaçërisht për kërkesën për lirim me kusht.

Ajo që vërehet në vendimin e gjykatës është se në rubrikën ku gjykata shprehet :

Sa më sipër:

Gjykata bazuar në nenin 480 të K.Pr.Penale dhe nenin 63 të ligjit nr. 8328/1998 “ për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”;

VENDOSI:

është referuar gabim baza ligjore neni 63 i ligjit nr. 8328/1998 (*treguar me bold më sipër*).

104.11. Këshilli këtë gjetje e konsideron gabim material në vendimin e gjykatës, por që nuk ka asnjë ndikim në vendimarrjen e gjykatës, e cila si më sipër analizuar ka gjykuar dhe vendosur mbi dispozitën e saktë të ligjit në fuqi në kohën e gjykimit, nenin 75 të ligjit nr. 81/2020 “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*”.

104.12. Konstatimi i mësipërm Konsiderohet nga Këshilli si parregullsi në vendim, por jo si shkelje e dispozitave ligjore me pasojë përfitimin e kundërligjshëm të uljes së dënimit për shtetasin {...}.

104.13. **Përfundimisht, në lidhje me çështjen penale “ Ulje dënimi” për shtetasin {...}, Këshilli nuk konstaton asnjë shkelje ligjore, por vetëm parregullsi në formën e gabimit material, në vendim.**

105. **Në lidhje me çështjen penale me objekt “Lirim me kusht” të dënuarit {...}.**

105.1. Rezulton se shtetasi {...} ka paraqitur kërkesë për lirim me kusht, regjistruar në gjykatë në datën 28.01.2021. Në seancën e datës 30.03.2021, kërkuesi ka hequr dorë nga

kërkesa duke kërkuar pushimin e çështjes. Gjykata duke analizuar se investimi i gjykatës është e drejtë ekskluzive e kërkuarit dhe kusht themelor për zhvillimi e gjykimit, ka vendosur “ *Pushimin e gjykimit të çështjes nr. 6 datë 28.01.2021 me kërkuar {...} dhe objekt “ Lirim me kusht”*. Vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar nga palët ndërgjyqëse.

Këshilli në lidhje me këtë vendimarrje të gjykatës, nuk konstaton asnjë parregullsi.

105.2. Në datë 02.09.2021, sipas shënimit të sekretarisë gjyqësore, shtetasi {...} ka paraqitur kërkesë për lirim me kusht. Kjo çështje së bashku me çështjet e tjera të dorëzuara gjatë periudhës së pushimeve vjetore të gjykatës, është shortuar në shortin e parë të zhvilluar në gjykatë, në datën 13.09.2021. Nuk rezulton të ketë konstatim të ndonjë shkelje ligjore në regjistrimin dhe shortimin e çështjes. Shorti elektronik i zhvilluar ka përzgjedhur si gjyqtar, magjistratin {...} me ngarkesë në short 75%, për shkak të ushtrimit të detyrës së zv/kryetarit/drejtuesit të gjykatës.

105.3. Gjithashtu, rezulton se pasi janë zhvilluar disa seanca gjyqësore, në seancën e datës 21.10.2021, gjykata ka vendosur “ *1. Pranimin e kërkesës. 2. Bazuar në nenin 64 të K.Penal, lirimin e të dënuarit {...}, duke urdhëruar pezullimin e pjesës së mbetur pavuajtur prej 1 (një) vit e 21 (njëzet e një) ditë burgim, të dënimit të dhënë me vendimin nr.23-2020-506/98, datë 21.04.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, duke e vënë në provë të dënuarin {...}, për një periudhë prej 1 (një) vit e 21 (njëzet e një) ditësh. 3. Urdhërohet i dënuari {...} që gjatë kësaj periudhe prove, të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës, që mbulon vendbanimin ose vendqëndrimin e tij. 4. Në aplikim të nenit 60/9 të K.Penal, urdhërohet të mos shoqërohet me persona të dënuar. 5. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të dënuarit {...}, nëse nuk mbahet i ndaluar për ndonjë shkak tjetër ligjor.*”

105.4. Në arsyetimin e vendimit, gjykata është shprehur: “ *Në funksion të dhënies së një vendimi të drejtë, Gjykata vlerëson, se përpara saj shtrohen për shqyrtim këto çështje:*

- 1. A plotëson kërkuari, kushtet procedurale të parashikuara në nenin 477 të K.Pr.Penale?*
- 2. A plotëson kërkuari, kushtet materiale për të përfituar lirim me kusht, parashikuar në nenin 64 të K.Penal?*

Në lidhje me pyetjen e parë, Gjykata konstaton se në nenin 477 të K.Pr.Penale janë parashikuar kushtet procedurale, të nevojshme për plotësim nga kërkuari, që më pas gjykata të mund të marrë në shqyrtim plotësimin ose jo, të kushteve materiale parashikuar në nenin 64 të K.Penal.

Në nenin 477 të K.Pr.Penale parashikohet se “1. Gjykata e vendit të ekzekutimit vendos për lirimin me kusht dhe revokimin e vendimit të lirimit me kusht, sipas kritereve të caktuara në Kodin Penal. 2. Kërkesa nuk mund të përsëritet para se të kenë kaluar gjashtë muaj nga dita kur vendimi i rrëzimit të kërkesës ka marrë formë të prerë.

Në interpretim të dispozitës së mësipërme, kërkohet që i dënuari të plotësojë kumulativisht këto kushte:

3. Të paraqes kërkesë në Gjykatën e vendit të ekzekutimit.
4. Të mos ketë paraqitur më parë kërkesë për lirim me kusht, e cila të jetë rrëzuar nga gjykata, jo më afër se 6 muaj nga paraqitja e kërkesës në shqyrtim.

Në lidhje me pikën e parë, Gjykata konstaton se kërkuesi është dënuar me 5 vjet burgim, dënim që është duke e vuajtur në {...} Tepelenë. {...} Tepelenë është nën juridiksionin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër dhe në këto kushte kjo gjykatë ka kompetencë tokësore, lëndore dhe funksionale për gjykimin e kërtimeve bazuar në nenin 477 të K.Pr.Penale.

Në lidhje me pikën e dytë, rezulton se sipas Vërtetimit nr.11-10 prot., datë 11.10.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, provohet se kërkuesi nuk ka paraqitur kërkesë me objekt lirim me kusht, për periudhën 31 Mars 2021 - 09 Tetor 2021. Në këto kushte, gjykata vlerëson se plotësohet edhe kushti i dytë për mos paraqitjen dhe rrëzimin nga gjykata, brenda 6 muajve nga paraqitja e kërkesës në shqyrtim, të një kërkesë të mëparshme për lirim me kusht nga kërkuesi {...}.

Për sa më sipër Gjykata vlerëson se nga kërkuesi plotësohen kumulativisht kushtet procedurale të vendosura në nenin 477 të K.Pr. Penale dhe do të procedoj me marrjen në shqyrtim të kushteve materiale të vendosura në nenin 64 të K.Penal.

Në lidhje me pyetjen e dytë, gjykata konstaton se në nenin 64 të K.Penal parashikohet se “I dënuari me burgim mund të lirohet me kusht, nga vuajtja e dënimit vetëm për arsye të veçanta, nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij, si dhe të ketë vuajtur:

- jo më pak se gjysmën e dënimit të dhënë për kundërvajtje penale;
- jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi gjer në pesë vjet burgim;
- jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi mbi 5 vjet deri në maksimumin e parashikuar nga ligji, me përjashtim të parashikimeve në paragrafin 3 të këtij neni.

Në masën e dënimit të vuajtur nuk llogaritet koha e përfituar me amnisti ose falje.

Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje si dhe për të dënuarit për kryerjen e veprave penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c apo paragrafi i tretë i nenit 100.

Në interpretim të dispozitës së mësipërme, gjykata vlerëson që nga kërkuesi duhet të plotësohen kumulativisht këto kushte:

3. Të ketë kryer jo më pak se 3/4-tat e dënimit të dhënë.
4. Të mos jetë përsëritës për krime të kryera me dashje, si dhe të mos jetë dënuar për veprat penale, të parashikuara nga nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c dhe 100/3 të K.Penal.
5. Ekzistencën e arsyeve të veçanta, nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij.

Në lidhje me kushtin e parë gjykata konstaton se kërkuesi {...} me vendimin nr.23-2020-506/98, datë 21.04.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, është dënuar me 5 (pesë)

vjet burgim, për veprën penale të parashikuar nga neni 283/2 i K.Penal. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. 36, datë 10.09.2020.

Kërkuesi është arrestuar në datën 24.11.2018 dhe deri në ditën e dhënies së këtij vendimi, i kanë mbetur pa vuajtur 1 vit e 21 ditë burgim. Në këto kushte, kërkuesi plotëson kriterin e vuajtjes së 2/3-tës së dënimit të dhënë nga gjykata.

Në lidhje me kushtin e dytë, gjykata konstaton se kërkuesi {...}, sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore, nr. 11 prot., datë 29.07.2021, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, rezulton se është i padënuar më parë. Dënimi i mëparshëm i të dënuarit është shuar për shkak rehabilitimi. Rehabilitimi është një proces dhe jo status i të dënuarit dhe shënimin në certifikatën gjyqësore të këtij fakti me shënimin “I rehabilituar” është një gabim i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Në lidhje me kushtin e tretë për ekzistencën e arsyeve të veçanta, nëse me sjelljen dhe punën e tij, i dënuari tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij, gjykata vlerëson se Ligjvënësi duke përdorur shprehjen “arsye të veçanta” ka bërë një vlerësim të përgjithshëm, pa i nominuar ato e duke e lënë në vlerësim të gjykatës sipas rrethanave konkrete që i paraqiten. Megjithatë këto “arsye të veçanta” nuk janë të pavarura dhe duhet të jenë të lidhura ngushtë me qëllimin e institutit të lirim para kohe me kusht, i cili ka të bëjë me riedukimin dhe riintegrimin në shoqëri të të dënuarit. Arsyet e veçanta nuk janë gjë tjetër veçse rrethana konkrete, të cilat provojnë se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi për edukimin dhe i dënuari është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri. Ky integrim i paragrafit të parë të nenit 64 të K. Penal të çon në konkluzionin logjik se kemi të bëjmë me një kusht të vetëm dhe “arsyet e veçanta” nuk janë gjë tjetër veçse fakte të cilat provojnë se me pjesën e dënimit të vuajtur është arritur qëllimi i dënimit penal, në rastin konkret për edukimin e të dënuarit dhe ai është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri. (Vendimi Unifikues Nr. 1 i Regj. Themeltar, Nr. 2 i Vendimit i Gjykatës së Lartë).

Sa më sipër, ky trup gjykues në vlerësimin e “arsyeve të veçanta” në funksion të edukimit dhe riintegrimin të kërkuesit në shoqëri, mban në konsideratë raportet e vlerësimit të kryera nga {...} Tepelenë dhe Shërbimi i Provës Zyra Vendore Gjirokastrë, të cilat kanë vlerësuar pozitivisht sjelljen e kërkuesit në {...} gjatë kohës së vuajtjes së dënimit si dhe mundësinë për rehabilitim dhe risocializim në shoqëri. (për më tepër shih raportet e vlerësimit të {...} dhe Shërbimit të Provës).

Nga kërkuesi, krahas vlerësimit të kryer nga {...} Tepelenë dhe Shërbimi i Provës Gjirokastrë, u paraqitën dhe fakte të tjera, në të cilat kërkuesi mbështet kërkesë për lirim me kusht. Kërkuesi paraqiti:

- 1- Certifikatë e përbërjes familjare, nxjerrë në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, ku tregohet se familja e kërkuesit përbëhet nga tre persona, nga kërkuesi, nëna e tij {...} Pata dhe vëllai i tij i quajtur {...}.
- 2- Shkresë me nr. 97 prot., datë 15.01.2021, e Bashkisë Tepelenë, në të cilën pasqyrohet gjendja familjare dhe vlerësimi i bërë, në raport me komunitetin, për kërkuesin {...} dhe familjen e tij, e cila karakterizohet nga një sjellje shembullore në komunitetin ku jetojnë.

- 3- Epikrizë mjekësore për shtetasen {...} , nënën e kërkuesit , në të cilën tregohen të dhënat mjekësore të saj , rezulton se ajo është me tumor dhe trajtohet me kimiterapi.
- 4- Epikrizë përcjellëse për invalidët, në të cilën tregohet se vëllai i kërkuesit rezulton me problem shëndetësore të cilat mund ta çojnë atë në invaliditet.
- 5- Deklaratë Noteriale nr. 97 rep., nr.39 kol., datë 22.01.2021, e lëshuar nga Administratorja e Shoqërisë {...} shpk, e cila deklaron se merr përsipër punësimin e kërkuesit.

Gjykata, në analizë të fakteve treguar në aktet e vlerësimit të {...} Tepelenë dhe Shërbimit të Provës, Zyra Vendore Gjyrokastër, faktit se gjatë gjithë periudhës së vuajtjes së dënimit, kërkuesi ka treguar një sjellje të mirë, vlerëson se me pjesën e vuajtur të dënimit i është arritur qëllimit për edukimin, rehabilitimin dhe risocializimin e të dënuarit.

Në këto arsye, plotësohet edhe kushti i arsyeve të veçanta ku me punën dhe sjelljen e tij dhe pritshmëritë për të ardhmen, kërkuesi tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij.....”

105.5. Këshilli konstaton se pretendimet e Inspektorit për shkelje ligjore me dashje të magjistratit me pasojë lirimin e kundërligjshëm të të dënuarit {...} nuk kanë asnjë mbështetje ligjore dhe faktike.

105.6. Rezultoni se sipas Dinamikës së Vuajtjes së Dënimit të hartuar nga {...} Tepelenë, deri në datën 22.09.2021, i dënuari {...} ka vuajtur 3 vjet 10 muaj e 10 ditë burgim, duke i mbetur për të vuajtur 1 vit, 1 muaj e 20 ditë burgim. I dënuari ka fituar me paraburgim 10 muaj e 23 ditë burgim dhe ka fituar me punë 1 muaj e 8 dite burgim.

105.7. Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen përlllogaritje duke mos përfshirë ditët e fituara me punë nga i dënuari dhe duke i atribuar gjyqtarit të çështjes, faktin e mospërlllogaritjes prej tij të dënimit të kryer nga i dënuari.

105.8. Këshilli vlerëson se nuk është në kompetencat dhe misionin e ILD-së të vlerësojë nëse në kohën e llogaritjes së dënimit të kryer, duhet të përfshihet edhe përfitimi nga puna e kryer nga i dënuari në {...}, ose jo. Siç e ka evidentuar vetë ILD në Inspektimin Tematik të kryer në Gjykata dhe Prokurori, ka praktikë të ndryshme që ndiqen në gjykatat shqiptare lidhur me konvertimin e punës në {...} nga të burgosurit me ulje dënimi. Siç rekomandon edhe Inspektori kjo çështje duhet të zgjidhet me vendim unifikues nga Gjykata e Lartë.

105.9. Këshilli konstaton se pavarësisht pretendimit të mësipërm, në datën e shpalljes së vendimit, i dënuari {...} sipas vendimit të gjykatës, ka kryer 3/4 e dënimit të dhënë nga gjykata.

105.10. Në lidhje me pretendimin, nëse gjykata duhet të aplikojë koeficientin e dënimit të kryer prej 2/3-ve ose 3/4-ve mbi dënimin e dhënë nga gjykata, apo mbi dënimin që parashikon dispozita që është dënuar kërkuesi, kjo çështje mbetet për tu vendosur nga Gjykata e Lartë me vendim unifikues. Siç edhe Inspektori e evidenton në Inspektimin Tematik të kryer në Gjykata dhe Prokurori, ka dy praktika gjyqësore që ndiqen nga gjykatat e të gjitha niveleve,

duke përfshirë edhe Gjykatën e Lartë. Në këto kushte del e nevojshme unifikimi i praktikës nga Gjykata e Lartë.

105.11. Gjithsesi, Këshilli konstaton se magjistrati në vendimin për lirimin me kusht të shtetasit {...} ka aplikuar të njëjtin qëndrim që ka edhe Inspektori, duke aplikuar koeficientin mbi masën e dënimit që parashikon dispozita penale. Në pjesën arsyetuese të vendimit, gjykata ka ngritur pyetjen, nëse nga kërkuesi ishte plotësuar vuajta e 3/4 të dënimit.

105.12. Në vijim të arsytimit konstatohet se gjykata është shprehur “ *Në këto kushte, kërkuesi plotëson kriterin e vuajtjes së 2/3-tës së dënimit të dhënë nga gjykata. Kjo kundërthënie e gjykatës, do të konsiderohet nga Këshilli si gabim material, pasi konstatohet se ky gabim material (e njëjtë fjali) është “copy paste” në të tre vendimet e analizuara në këtë vendim, dhe konkretisht “lirimin me kusht të shtetasve, {...}, {...} dhe {...}”*. Kjo gjetje, çon në konkluzionin se është një gabim material në vendim dhe jo një zbatim i ndryshëm, i gabuar, apo çdo pretendim tjetër i Inspektorit.

105.13. Inspektori në këtë çështje, pretendon se në kushtet kur i dënuari {...} në ditën e paraqitjes së kërkesës nuk plotësonte 3/4 e dënimit të kryer, ka paraqitur kërkesën për uljen e dënimit, kërkesë të cilën gjykata e ka gjykuar me shpejtësi, me qëllim që i dënuari të plotësonte kërkesat e ligjit dhe të përfitonte lirimin me kusht.

105.14. Në lidhje me këtë pretendim, Këshilli arsyeton se referuar Raportit Tematik të ILD në lidhje me lirimet me kusht në Gjykata dhe Prokurori, konstatohen dy praktika gjyqësore në gjykatat e të gjitha niveleve, duke përfshirë edhe Gjykatën e Lartë. Një praktikë ecën në interpretim dhe zbatim të ligjit, që kriteri ligjor i kohës së dënimit të vuajtur llogaritet në momentin e shpalljes së vendimit dhe një praktikë tjetër e cila e llogarit në momentin e paraqitjes së kërkesës në gjykatë nga i dënuari. Praktika të ndryshme në zbatim, konstatohen edhe në seksione penale të ndryshme të Gjykatës së Lartë, të cilës i lind nevoja për unifikim.

105.15. Për sa kohë interpretimi dhe zbatimi i ligjit mbi momentin e llogaritjes së periudhës së burgimit të kryer nga kërkuesi, nuk është ndarë ende me vendim unifikues, nuk është as në kompetencat dhe as në misionin e ILD-së apo dhe KLGj-së që të ndajë se cila praktikë gjyqësore është e saktë dhe cila e gabuar.

105.16. Në kushtet kur magjistrati {...} në lirimin me kusht ka zbatuar një nga praktikat gjyqësore që ndiqet në shumicë nga gjykatat, deri dhe nga Gjykata e Lartë, atëherë vendimmarrja e tij në lidhje me momentin e llogaritjes së dënimit të kryer nga i dënuari {...}, nuk do të konsiderohet shkelje e ligjit material, nenit 64 të K.Penal.

105.17. Në lidhje me pretendimin se magjistrati {...} ka kryer me shpejtësi gjykimin e çështjes me objekt “Ulje dënimi” që i dënuari të plotësonte afatin e parashikuar në ligj për të përfituar lirimin me kusht, Këshilli e gjen këtë pretendim të pabazuar në asnjë nga provat e shqyrtuara nga gjykata fillimisht, ILD në vijim dhe KLGJ në përfundim.

105.18. Magjistrati {...} paraqiti so prova në Këshill, disa vendime me objekt “Ulje dënimi” të cilat ishin gjykuar dhe përfunduar gjykimi në vetëm një seancë gjyqësore, të zhvilluar në

një afat nga 10 ditë në maksimum 25 ditë nga dita e shortimit në gjykatë. Në të gjitha vendimet gjyqtari ka vendosur uljen e dënimit me 90 ditë. Gjykimi i kërkesës së të dënuarit {...} për ulje dënimi, nuk konstatohet të ketë asnjë ndryshim nga vendimarrjet e mëparshme të gjyqtarit, si në kohëzgjatjen e gjykimit, ashtu edhe në vendimarrjen përfundimtare.

105.19. Për më tepër që pretendimi i Inspektorit nuk qëndron, pasi konstatohet se në vendimin përfundimtar të lirimit me kusht të të dënuarit {...}, nuk është aplikuar ulja e dënimit me 90 ditë, që gjykata kishte vendosur me parë për të dënuarin {...} dhe që rezulton se kishte marrë formë të prerë, përpara shpalljes së vendimit për lirim me kusht. Mospërfshirja e 90 ditëve në vendimin e lirimit me kusht, duke i caktuar si kohë prove të dënuarit {...} një kohë më të gjatë sesa ajo që duhej t'i caktohej pas aplikimit të uljes së dënimit, është një parregullsi e gjykatës që ka cënuar një të drejtë të të dënuarit {...}, por nga ana tjetër, rrëzon plotësisht çdo pretendim të Inspektorit në lidhje me investimin e kundërligjshëm të gjyqtarit, në mënyrë që shtetasi {...} të lirohej padrejtësisht nga burgu.

105.20. **Inspektori në vijim shprehet se** “ *Por, sipas vlerësimeve periodike 6 mujore të {...} Tepelene kërkuesi gjatë gjithë qëndrimit në {...} nuk e ka pranuar veprën penale, ka pasur masë disiplinore, ndërsa në vlerësimin e sjelljes që është paraqitur në gjykatë me nr. 164, datë 7.10.2021, kërkuesi është vlerësuar nga institucioni i vuajtjes së dënimit negativisht dhe me qëndrim për rrëzimin e kërkesës, duke e konsideruar përsëritës. Gjithashtu, nga shërbimi i provës me raportin nr. 292, datë 11.10.2021 konkludohet se për të dënuarin {...} nuk është arritur qëllimi për riedukimin dhe rehabilitimin e tij, duke e lenë në çmim të gjykatës, duke u shprehur se mundësia për t'u integruar në familje e shoqëri është një mundësi normale e vështirë, por edhe mundshme.*”

105.21. Këshilli konstaton se në gjykimin e çështjes për lirim me kusht të të dënuarit {...}, janë paraqitur edhe raportet e vlerësimit nga {...} dhe Shërbimi i Provës, në kuadër të shqyrtimit të kërkesës për lirim me kusht.

105.22. Në raportin e {...} Tepelenë “ **Vlerësim sjellje për në gjykatë, me objekt: Lirim me kusht**” nr. 164 prot., datë 07.10.2021, komisioni i {...} Tepelenë, i përbërë nga 5 anëtarë, ku kryetar është përgjegjësi i sektorit ligjor, përfaqësues i {...} edhe në seancë gjyqësore, në konkluzionet përfundimtare është shprehur : *Mbështetur në vlerësimin e mësipërm, Komisioni i vlerësimit të sjelljes, shprehet për të dënuarin {...} se karakterizohet nga personalitet pozitiv dhe social, shprehet i motivuar dhe bashkëpunues për arritjen e objektivave të trajtimit. Shpreh motivim për programet e punësimit. Mundohet të ketë aftësi vetëmenaxhuese të riskut të vetë. Bazuar dhe tek dosja psiko-sociale, i dënuari ka patur sjellje dhe qëndrim korrekt. Por Komisioni për sa më sipër shprehet për rrëzimin e kërkesës, për arsyen se i dënuari është përsëritës.*

105.23. I pyetur në gjykim, se përse {...} kërkon rrëzimin e kërkesës, përfaqësuesi i {...}-së, që rezulton se është edhe Kryetari i Komisionit Vlerësues, u shpreh se kjo kërkesë vjen

si pasojë sepse ata e konsiderojnë të dënuarin përsëritës dhe jo si pasojë e sjelljes së tij në {...}, e vlerësuar prej tyre pozitive.

105.24. Rezulton se gjykata ka analizuar se përse një person i rehabilituar nga një dënim i mëparshëm penal, nuk do të konsiderohet përsëritës në kuptim të nenit 64 të K.Penal. Gjykata ka arsyetuar se rehabilitimi është një proces ligjor dhe jo një status i të dënuarit. Dakort me këtë arsyetim të gjykatë rezulton se ka qenë edhe prokurori i çështjes.

105.25. Rezulton se Inspektori nuk ka ngritur ndonjë pretendim në lidhje me këtë arsyetim të gjykatës, duke u shprehur se është e nevojshme investimi i Gjykatës së Lartë në lidhje me interpretimin nëse një i rehabilituar nga një vendim i mëparshëm penal mund të jetë përfutues sipas nenit 64 të K.Penal.

105.26. Në vijim konstatohet se Shërbimi i Provës në raportin e paraqitur në gjykatë është shprehur se “ “ *Duke analizuar, shqyrtuar dhe vlerësuar në përgjithësi e vazhdimësi të gjithë sjelljen dhe qëndrimin aktual të të dënuarit, kushtet dhe rrethanat konkrete familjare, ekonomike dhe sociale, vlerësojmë se i nënë i dënuari i plotëson kriteret formale të kërkuara në nenin 64 të Kodit Penal për lirimin me kusht, dhe në nenit 477 të Kodit të Proçedurës Penale, si dhe mbështetur në kushtet dhe rekomandimet e vendosura edhe në vendimin unifikua Nr.2, datë 25.05.2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për institutin e lirimit me kusht i cili ka karakter riedukues, human dhe social, Shërbimi i Provës për të dënuarin {...} e le në çmimin e gjykatës për pranimin e kërkesës për "lirim me kusht" pasi mundësia për t'u integruar në familje e shoqëri është një mundësi normale e vështirë por edhe e mundshme, për ti dhënë të dënuarit në bazë të ligjit edhe një mundësi edukimi dhe riintegrimi në familje e në shoqëri. Nëse do të pranohet nga Gjykata kërkesa e tij për lirimin me kusht, për të arritur edukimin dhe riintegrimin e tij të plotë në familje e shoqëri, Shërbimi i Provës gjithë periudhës të provës dhe te mbikëqyrjes të të dënuarit, institucioni i Shërbimit te Provës do të asistojë dhe hartojë programe dhe plane të veçanta individuale të trajtimit dhe të edukimit të tij me qëllim arritjen e objektivave të trajtimit edukimit dhe riintegrimin të tij të plotë në familje, në shoqëri e komunitet. Për të siguruar dhe realizuar plotësisht qëllimin e edukimit dhe të riintegrimin të tij të plotë në familje, në jetë dhe në komunitet, mbështetur e bazuar në nenin 60/9 të Kodit Penal rekomandojmë që i dënuari menjëherë pas lirimit me kusht të detyrohet; -Të mos shoqërohet me persona të caktuar, kryesisht me të dënuar e me precedent penal apo bashkëpunëtorët e veprës penale”.*

105.27. Në gjykim është administruar edhe “ Karakteristikë familjare e qytetarit të Bashkisë Tepelenë, {...}”, lëshuar nga Bashkia Tepelenë me nr. 97 prot., datë 15.01.2021, në të cilën thuhet “Ati i tij, {...}, ka punuar si teknik në ndërmarrjen e SMT të qytetit, **sot ka ndërruar jetë**. Nëna e tij {...}, ka punuar në kooperativë, **sot e papunë, shtëpiake**. Ka një vëlla, {...} dhe një motër {...} e cila ka krijuar familje dhe jetojnë me ndershmëri....**Pra ai vjen nga një familje tepër shembullore e qytetit të Tepelenës**, ka një familje që dallon në qytet për sjellje korrekte dhe humane, si dhe lagje e qytet dhe gjithë komunitetin e qytetit. Familje me fëmijë

të edukuar e të sjellshëm që e duan rregullin, qetësinë dhe marrëdhëniet humane dhe bashkëqytetare. Të gjithë pjesëtarët e kësaj familje nuk përbëjnë dhe nuk kanë sjellë asnjëherë shqetësime sociale apo sjellje jo korrekte dhe jo ligjore, si për komunitetin e qytetit, sjellje ën shkollë, sjelljen në punë apo në raport me shtetin”.

105.28. Sipas dokumentave mjekësore të administruar në gjykim, rezulton se nëna e kërkuesit {...}, është diagnostikuar me “adenocarcinoma” në muajin Dhjetor 2019 dhe **është trajtuar me Kimioterapi që të reduktohej tumori.** (*ka rezultuar se ati i të dënuarit kishte vdekur më parë*).

Vëllai i kërkuesit, shtetasi Domerio Pata, sipas “ Epikrizë përcjellëse për invalidë” **ka mungesë të dorës së majtë të lindur.....etj.**

Gjithashtu në gjykim u paraqit edhe një deklaratë e administratores së shoqërisë “{...}” sh.p.k që merr përsipër punësimin e të dënuarit {...}.

105.29. Këshilli vlerëson, se analiza e plotësimit të kriterit subjektiv, “ **arsye të veçanta**” nëse me pjesën e vuajtur të dënimit i është arritur qëllimit, rehabilitimit dhe risocializimit të personit, është vlerësim i provave të shqyrtuara në gjykim nga gjykata. Vlerësimi i provave nga gjykata, nuk mund të jetë objekt kontrolli nga asnjë institucion administrativ, por vetëm nga një gjykatë më e lartë. Mungesa e provave mund të çonte në një vlerësim të ndryshëm nga Këshilli, por kur evidentohet se janë marrë dhe shqyrtuar provat e nevojshme, atëherë analizimi dhe vlerësimi i tyre nga gjykata nuk mund të jetë objekt kontrolli. **Shqyrtimi dhe vlerësimi i pretendimeve të palëve dhe provave gjatë një procesi gjyqësor është atribut vetëm i pushtetit gjyqësor.**

105.30. Në konkluzion në lidhje me çështjen penale me objekt “ Lirim me kusht” të shtetasit {...}, Këshilli nuk konstaton asnjë shkelje ligjore procedurale dhe materiale. Konstaton respektim të kriterëve të vendosura në nenin 477 të K.Pr.Penale dhe 64 të K.Penal, administrim të provave të nevojshme dhe vlerësim të tyre, sipas bindjes së brendshme të gjyqtarit. Në këtë vendim të gjykatës, Këshilli konstaton vetëm një parregullsi, mosaplikimi i uljes së dënimit me 90 ditë në vendimin e gjykatës për lirimin me kusht, të shtetasit {...}. Kjo parregullsi nuk ka lidhje me asnjë nga pretendimet e Inspektorit, përkundrazi, rrezon çdo pretendim të tij në lidhje me përfshirjen e kundërligjshme të gjyqtarit, me qëllim lirimin e padrejtë nga burgu të shtetasit {...}.

106. **Në lidhje me çështjen penale me objekt “ Lirim me kusht” të shtetasit {...},** konstatohet se me vendimin nr. 22/21-2019-2200 datë 22.11.2019 Gjykata ka vendosur “ 1. *Pranimin e kërkesës.* 2. *Bazuar në nenin 64 të K.Penal, lirimin e të dënuarit {...}, duke urdhëruar pezullimin e pjesës së mbetur pavuajtur prej 4 (katër) muaj e 8 (tetë) ditë burgim, të dënimit të dhënë me vendimin nr. 93, datë 14.04.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, duke e vënë në provë të dënuarin {...}, për një periudhë prej 4 (katër) muaj e 8 (tetë) ditë.* 3. *Urdhërohet i dënuari {...} që gjatë kësaj periudhe prove, të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës që mbulon vendbanimin ose vendqëndrimin e tij.* 4. *Në aplikim të*

nenit 60/9 të K.Penal, urdhërohet të mos shoqërohet me persona të dënuar. 5. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të dënuarit {...}, nëse nuk mbahet i ndaluar për ndonjë shkak tjetër ligjor.”

106.1. Arsyetimi i vendimit të gjykatës, rezulton se ka të njëjtën strukturë me vendimet e tjera të analizuara në këtë vendim të Këshillit.

106.2. Inspektori shprehet se deri në datën e shpalljes së vendimit për lirimin me kusht, të dënuarit i kishin mbetur për të vuajtur 1 vit 7 muaj e 1 ditë dhe jo 4 muaj e 8 ditë, siç shprehet gjykata.

106.3. Këshilli konstaton se në dosjen gjyqësore, gjendet e administruar nga gjykata “Dinamika e vuajtjes së dënimit” e hartuar nga {...} Tepelenë në datën 23.10.2019. Sipas këtij dokumenti rezulton se shtetasi {...} është dënuar me 7 vjet e 6 muaj burgim. Ka fituar 1 muaj e 22 ditë me paraburgim, ka fituar 90 ditë ulje me vendimin e gjykatës nr. 755 datë 10.06.2015, ka fituar 90 ditë ulje dënimi me vendimin nr. 606 datë 12.07.2016, ka fituar 90 ditë ulje dënimi me vendimin nr. 678 datë 12.07.2017 dhe ka fituar 90 ditë ulje dënimi me vendimin nr. 817 datë 12.10.2018. Këto vendime gjyqësore ndodhet të administruara në dosjen gjyqësore, pasi janë sjellë nga {...} Tepelenë së bashku me aktet e tjera.

106.4. Këshilli evidenton se këto vendime gjyqësore që kanë ulur 360 ditë burgim për shtetasin {...} Ruku, nuk janë verifikuar dhe nuk janë marrë në konsideratë nga Inspektori, në përlllogaritjen e kohës së dënimit të vuajtur nga i dënuari. Gjithashtu rezulton se gjatë gjykimit të kërkesës për lirim me kusht, i dënuari ka paraqitur edhe një vendim tjetër ulje dënimi me 90 ditë, vendim i cili konstatohet se është administruar nga gjykata dhe zbatuar në llogaritjen e kohës së dënimit të pakryer nga i dënuari.

106.5. Këshilli konstaton përlllogaritje të saktë nga gjykata, të kohës së vuajtjes së dënimit të kryer dhe atij të mbetur për tu kryer nga i dënuari, në gjykimin e çështjes për lirimin me kusht të shtetasit {...}, duke mos konstatuar asnjë shkelje ligjore.

106.6. Inspektori shprehet se në vendim nuk përmenden konkretisht konkluzionet e raporteve të {...} dhe Shërbimit të Provës.

106.7. Referuar vendimit gjyqësor konstatohet se gjykata ka arsyetuar se “ *Në lidhje me kushtin e tretë për ekzistencën e arsyeve të veçanta, nëse me sjelljen dhe punën e tij, i dënuari tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij gjykata vlerëson se Ligjvënësi duke përdorur shprehjen " arsye të veçanta" ka bërë një vlerësim të përgjithshëm, pa i nominuar ato e duke e lënë në vlerësim të gjykatës sipas rrethanave konkrete që i paraqiten. Megjithatë këto " arsye të veçanta" nuk janë të pavarura dhe duhet të jenë të lidhura ngushtë me qëllimin e institutit të lirim para kohe me kusht, i cili ka të bëjë me riedukimin dhe riintegrimin në shoqëri të të dënuarit. Arsyet e veçanta nuk janë gjë tjetër veçse rrethana konkrete, të cilat provojnë se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi për edukimin dhe i dënuari është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri. Ky integrim i paragrafit*

të parë të nenit 64 të K. Penal të çon në konkluzionin logjik se kemi të bëjmë me një kusht të vetëm dhe "arsyet e veçanta" nuk janë gjë tjetër veçse fakte të cilat provojnë se me pjesën e dënimit të vuajtur është arritur qëllimi i dënimit penal, në rastin konkret për edukimin e të dënuarit dhe ai është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri. (Vendimi Unifikues Nr. 1 i Regj. Themeltar. Nr. 2 i Vendimit i Gjykatës së Lartë).

Sa më sipër, ky trup gjykues në vlerësimin e "arsyeve të veçanta" në funksion të edukimit dhe riintegrimin të kërkuesit në shoqëri, mban në konsideratë raportet e vlerësimit të kryera nga {...} Tepelenë dhe Shërbimi i Provës Zyra Vendore Gjyrokastër, të cilat kanë vlerësuar pozitivisht sjelljen e kërkuesit në {...} gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, si dhe mundësinë për rehabilitim dhe risocializim në shoqëri. (për më tepër shih raportet e vlerësimit të {...} dhe Shërbimit të Provës).

106.8. Konstatohet se një interpretim i tillë i gjykatës është edhe në vendimin për lirimin me kusht të të dënuarit {...}, ku Inspektori nuk ka ngritur asnjë pretendim në lidhje me arsyetimin e vendimit.

106.9. Këshilli arsyeton se, arsyetimi i vendimit gjyqësor për lirimin me kusht të shtetasit {...} është i plotë, ku janë evidentuar faktet, ligji i zbatueshëm, janë ngritur çështjet për shqyrtim dhe bërë analizë e plotë e kriterëve ligjore dhe plotësueshmërisë së tyre nga i dënuari, kërkues. Nuk është në funksionet e ILD-së dhe çdo institucionit tjetër administrativ, përveç se nga një gjykatë më e lartë, vlerësimi nëse arsyetimi i vendimit përmbush kriteret ligjore për vlefshmërinë apo pavlefshmërinë e tij. Në kushtet kur vendimi për lirimin me kusht të shtetasit {...} është i njëjtë me vendimet e tjera të shqyrtuara në këtë procedim disiplinor, Këshilli vlerëson se nuk ka shkelje ligjore.

VI. KONKLuzionet e Këshillit të Lartë Gjyqësor

107. Këshilli, në zbatim të funksioneve të tij kushtetuese, në interpretim dhe vlerësim të drejtë, si dhe në respektim të kriterëve ligjore materiale dhe procedurale në çështjet e shqyrtuara në këtë vendim, vlerëson se nga ana e magjistratit {...} nuk ka asnjë shkelje të ligjit procedural dhe material, për të mbështetur kërkesën e Inspektorit për caktim mase disiplinore ndaj magjistratit. Gjyqtari ka zbatuar me korrektësi ligjin procedural, ka kryer gjykim publik, në prezencë të palëve të detyrueshme me ligj për të qenë pjesëmarrës në gjykim, ka kërkuar, mbledhur dhe administruar provat e nevojshme, si dhe ka vendosur drejtë, sipas bindjes së tij të brendshme, e ndikuar vetëm nga analiza e provave të marra në gjykim. Parregullsitë në vendim, të konsideruara si gabime materiale, nuk kanë asnjë pasojë ligjore dhe nuk kanë ndikuar në vendimarrjen e gjykatës, por këto parregullsi/gjetje duhet të jenë objekt shqyrtimi nga Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Vepimtarisë Profesionale, në kuadër të vlerësimit etiko-profesional që do ti bëhet gjyqtarit.

108. Në këto kushte, në lidhje me kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për caktim mase disiplinore ndaj magjistratit {...}, Këshilli do të vendosë "**Rrëzimin e kërkesës**".

PËR KËTO ARSYE:

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 147, 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 146, pika 2, shkronja “a” të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 86, shkronja “e”, nenet 97, 98 dhe 100 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 104 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi sipas ligjit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese, afat i cili fillon nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
3. Një kopje e vendimit të arsyetuar t’u njoftohet subjekteve të procedimit disiplinor, magistratit z. {...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

MENDIM PARALEL

Në çështjen me kërkues Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, i cili kërkoi fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, pasi veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e gjyqtarit {...} parashikohen si shkelje disiplinore nga neni 102, pika 1, shkronja “dh” dhe neni 102, pika 2 shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, përbëjnë “*Shkelje shumë e rëndë disiplinore*” dhe diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës, e si të tilla duhet të jepet masa disiplinore “*Shkarkim nga detyra*, pajtohemi me vendimin e shumicës për pranimin e kërkesës, por kemi mendim të ndryshëm për sa i takon arsyeve për këtë qëndrim, ndaj e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim paralel.

Në rastin në shqyrtim, pajtohemi me Vendimin e shumicës me numër 208, date 18.04.2024 “*Për rrëzimin e kërkesës së inspektorit të lartë të drejtësisë për caktim mase disiplinore ndaj gjyqtarit z. {...}*”, por ndajmë një arsyetim të ndryshëm me qëndrimin ndryshe në raport me vlerësimin e disa rrethanave që nuk ndikon në vendimin për rrëzimin e kërkesës

Duke marrë në konsideratë sa më lart gjatë gjithë procedurës administrative “quasi gjyqësorë” Këshilli i ka mundësuar palëve në proces, në mënyrë të veçantë magjistratit, njohjen paraprake të personit ndaj të cilit kërkohet të merret masa e shkarkimit me materialet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i të drejtës për t’u dëgjuar dhe mbrojtur si me anën e dhënies së sqarimeve paraprake ashtu dhe gjatë shqyrtimit të çështjes, aplikimit të parimit të prezumimit të pafajësisë duke respektuar elementet bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilitdo për një proces të rregullt, e drejtë themelore e tij. Duke qenë se shkarkimi nga detyra është një masë ekstreme e procedurave disiplinore, ajo duhet të merret pas një vlerësimi të kujdesshëm jo vetëm të provave por edhe të disa elementeve të zhvilluara në jurisprudencën Gjykatë Kushtetuese, sipas së cilës kuptimi i saktë dhe i drejtë i konceptit shkelje e rëndë e ligjit vlerësohet në tërësinë e tij nga disa faktorë, të cilët kanë të bëjnë me rëndësinë e ligjit të shkelur, pasojat e ardhura nga shkelja e tij, kohëzgjatjen e këtyre pasojave si dhe vetë qëndrimin subjektiv që mban personi konkret ndaj shkeljes së kryer (*shih vendimet nr.15, datë 03.05.2011; nr.15, datë 08.06.2009; nr.22, datë 07.10.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

Natyrisht në vlerësimin e rastit “de qua’ është treguar kujdes që analiza të mos interferojë me vendimmarrjen gjyqësorë pasi tashmë jurisprudenca kushtetuese në raste të ngjashme ka sanksionuar se “...omissis...Çdo veprimtari gjyqësorë, duke përfshirë edhe vendimmarrjen, është objekt i kontrollit nga një gjykatë më e lartë nuk mund të përbëjë lëndë shqyrtimi për Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Një qëndrim i kundërt do të përbënte shkelje të parimit kushtetues të pavarësisë së gjyqtarit”. Një ndalim i tillë është parashikuar edhe në nenin 72 pika 4 e Ligjit Për Statusin.

Në një shtet demokratik të sunduar nga ligji gjyqtari përmbush një funksion shumë të rëndësishëm. Roli i tij dhe i gjykatave në një shtet të tillë është, që ndërsa ushtrojnë funksionin e drejtësisë, ata duhet të sigurojnë zbatimin e normave të shprehura në Kushtetutë, të ligjeve dhe akteve të tjera ligjore, të garantojnë shtetin e së drejtës dhe të mbrojnë të drejtat dhe liritë e njeriut. Sjellja e gjyqtarëve në kontekstin profesional është shumë e rëndësishme. Referuar parimeve të Bangalores, cënimi edhe vetëm i parimeve të etikës, në marrëdhëniet e punës apo edhe jashtë saj mund të përbëjë shkak për cënimin e besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë. Referuar “teorisë së dukjes”, drejtësia jo vetëm duhet të bëhet por edhe duhet të shihet. Në këtë kuptim, vlerësohet se ka rëndësi se çfarë veprimesh ka bërë një gjyqtar në përmbushje të detyrës së tij, por është e rëndësishme gjithashtu të vlerësohet se çfarë shoqëria mendon. Në këtë kuptim, sjellje të caktuara të gjyqtarit konsiderohen si cënim i parimit të besimit të publikut tek drejtësia

Drejtësia përfaqëson një komponent esencial të shoqërisë demokratike. Ajo synon të zgjidhë konfliktin ndërmjet palëve nëpërmjet vendimeve të cilat kanë një rol të dyfishtë “normative “dhe “edukative” duke i mundësuar publikut të marrë informacion, njohuri dhe siguri për atë që ligji rregullon dhe zbatimin konkret të tij. Gjykatat konsiderohen si vendi i duhur për të mbrojtur të drejtat, respektuar detyrimet e zgjidhur konfliktet. Roli dhe funksioni i gjykatës është që nëpërmjet vendimeve të transformojë dispozitat ligjore nga abstrakte-metafizike, në substanciale dhe konkrete, duke i garantuar mbrojtje situatave juridike në të cilat ndodhen individët dhe garantuar në këtë mënyrë shtetin e së drejtës. Në këtë kontekst publiku ka një pritshmëri të lartë në pushtetin gjyqësorë si vendi i fundit ku ata gjejnë mbrojtje për të drejtat e tyre. Kjo pasi vendimi gjyqësor synon të japë efekte sigurie për individin dhe të konfirmojë se shoqëria drejtohet nga ligji, promovon dhe mbron të drejtat e individit si edhe interpreton ligjin në mënyrë të pavarur.

Në vendimmarrjen e Inspektorit pasqyrohet ndër të tjera e sintetizuar se “..omissis..veprimet e magjistratit subjekt hetimi disiplinor në rastin e shqyrtimit të kërkesës së të dënuarit {...}, {...}, {...}, ka ardhur si pasojë lirimi me kusht dhe ulja e padrejtë e dënimit, në zbatim të gabuar të ligjit material dhe procedural, duke i sjellë përfitim të padrejtë e cila është dhe pasoja e drejtpërdrejtë e shkeljes disiplinore. Kryerja e veprimeve/mosveprimeve të para si një sjellje në tërësinë e vet nga ana e magjistratit {...} ka cënuar në mënyrë të drejtpërdrejtë qëllimin (ratio) e institutit të lirimimit me kusht të parashikuar nga norma ligjore.

Në të njëjtën kohë, ushtrimi i pa rregullt i detyrës nga ana e magjistratit ka sjellë pasoja për dhënien e drejtësisë, cenimin e prestigjit të gjyqtarit dhe humbjen e besimit ndaj tij, si dhe ka cënuar besimin e publikut te drejtësia. Besimi i publikut nuk është nocion i papërkufizuar, pasi gjen mbështetje te vlerat

themelore dhe standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së magistratëve, sipas përcaktimeve të nenëve 3 dhe 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Në nenin 3, pika 5, të ligjit nr. 96/2016 është parashikuar se sjellja e magistratit është e lidhur me garantimin e ruajtjes e forcimit të besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë. Nëse magistratët nuk e përmbushin plotësisht rolin e tyre për dhënien e sigurimin e drejtësisë në shoqëri ekziston rreziku i humbjes së besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Besimi i publikut dhe respekti për gjyqësorin janë garanci të demokracisë dhe stabilitetit në një shoqëri demokratike..” .

Jurisprudenca e konsoliduar Kushtetuese por dhe Gjykatës së Lartë, lidhur me shkakun ligjor të *“cenimit të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë”*, ka vendosur standardin se është plotësisht e përshtatshme dhe proporcionale që masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, të aplikohet në rastet kur subjekti i rivlerësimit ka cënuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Në këtë kontekst është e detyrueshme të vlerësohet në mënyrë të drejtë dhe objektive tërësinë e sjelljeve të gjyqtarit dhe mbrojtjen e interesit publik në këtë proces. Për sa i përket matjes së cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, jurisprudenca ka vendosur standardin që institucionet e sistemit të drejtësisë duhet të gjenerojnë besim të vazhdueshëm te publiku, duke vepruar në mënyrë efektive dhe të drejtë, në përputhje me legjislacionin dhe duke e demonstruar këtë në mënyrë të vazhdueshme tek qytetarët. Ka një sërë sjelljesh, nëpërmjet të cilave gjyqtarët minojnë integritetin e institucioneve të drejtësisë dhe cenojnë besimin e publikut në sistemin tonë të drejtësisë, përmes korrupsionit, marrëdhënieve të rreme, shkeljes së betimit si nëpunës publik, veprimit në situatën e konfliktit të interesit, paaftësisë së rëndë në punën profesionale, vendosjes së interesave private përpara interesit publik etj.

Prandaj, në kontekstin e të drejtës disiplinore, duhet të ketë vlerësim të arsyeshme e të drejtë e objektive që ndaj *actus reus* të këtyre veprimit apo mosveprimit të gjyqtarit të aplikohet në mënyrë proporcionale masa disiplinore përfshirë edhe atë ekstreme të shkarkimit. Sanksionet disiplinore përgjithësisht kanë si qëllim të sigurojnë që anëtarët e grupeve të caktuara të veprojnë në pajtim me rregullat specifike të detyrueshme për tu zbatuar e normuar në këtë mënyrë sjelljen e tyre duke patur njëkohësisht edhe efekt parandalues gjatë zbatimit të tyre.

Në këtë kontekst për të konstatuar shkeljet e mundshme të magistratit gjatë ushtrimit të detyrës dhe më pas për të vlerësuar dhe adresuar këto shkelje duhen mbajtur parasysh dispozitat ligjore në fuqi që normojnë dhe rregullojnë këtë fushë ku përshtatshmëria e teknikës legjislative të përdorur dhe parashikueshmëria e saj në detajimet e formave të shkeljes synojnë respektimin e parimit të proporcionalitetit të raportit të shkeljes dhe masës se aplikuar.

Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e magistratit”, në nenet përkatësisht 101, 102 “shkeljet disiplinore dhe çështjet e veprimtarisë” dhe “shkeljet disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit”, ka

përcaktuar veprimet dhe sjelljet e magjistratit gjatë ushtrimit të detyrës të cilat mund të përbëjnë shkelje disiplinore.

Në mbështetje të parashikimeve germës “a”, të pikës 2, të nenit 140, të Kushtetutës, nenet 100-102, 105, 115, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim identifikimin e elementeve juridikë dhe faktikë mbi përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarit, subjekt hetimi disiplinor, kërkon të analizohen nëse veprimi apo mosveprimi i magjistratit subjekt hetimi disiplinor përbën ose jo shkelje disiplinore duke marrë parasysh një sërë faktorësh si: a) shkalla e pakujdesisë (fajësisë); b) shpeshësia e kryerjes së veprimit ose mosveprimit apo sjelljes; c) përvoja dhe pozicioni i magjistratit në sistem; d) dëmtimi, mundësia e shkaktimit të dëmtimit ose shkalla e pasojave që kanë ardhur ose mund të vijnë nga veprimi apo mosveprimi; si dhe e) çdo situatë që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor ose të prokurorisë.

Në pikën 1, të nenin 115, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohen në mënyrë jo shteruese, si kritere për caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore: (a) lloji dhe rrethanat e shkeljes; (b) shkalla e fajësisë dhe motivi; (c) pasojat e shkeljes; (ç) të dhënat profesionale, të çështjeve disiplinore dhe të dhëna kriminale të magjistratit; (d) masën e ndonjë rreziku të shkaktuar nga shkelja disiplinore; (dh) çdo rrethanë e rëndësishme që ka lidhje me shkeljen; (e) rrethana të lidhura me gjendjen shëndetësore të magjistratit; (ë) sjellja e magjistratit pas kryerjes së shkeljes dhe pas fillimit të hetimit; (f) sjellja e magjistratit gjatë hetimit/procedimit disiplinor dhe qëndrimin që mban ndaj tij; (g) çdo çështje tjetër që konsiderohet e rëndësishme.

Në analizë të neneve 111 dhe 115 të Ligjit Për Statusin, rezulton se shkarkimi është jo vetëm masa më e rëndë disiplinore që mund të merret ndaj gjyqtarit, por përkon me ato raste kur ndaj tij, për shkak të shkeljes shumë të rëndë të kryer, nuk mund të aplikohet asnjë prej masave të tjera që janë renditur në mënyrë të përshkallëzuar në dispozitën e sipërcituar. Për këtë arsye, ligji kërkon detyrimisht që kjo masë të jetë proporcionale me natyrën dhe pasojat që ka sjellë shkelja e kryer, në mënyrë që aplikimi i saj të justifikojë këtë shkelje, aspekte këto që ndikojnë në ligjshmërinë e masës disiplinore që merret ndaj tij, e cila me pas do të materializohet në aktin administrativ që nxjerr Këshilli i Lartë Gjyqësorë si një organ “quasi gjyqësor” në përfundim të procedimit disiplinor. Në rastin konkret, veprimet gjyqësorë të kryera nga gjyqtari nuk kanë një natyrë e peshë të tillë, të aftë për të aplikuar në mënyrë proporcionale masën “in extremis” e për të shkaktuar perceptimin e publikut se drejtësia nuk funksionon. Vlen të përmendet që parimi i zbatimit proporcional të sanksioneve disiplinore tek gjyqtarët citohet drejtpërdrejt në paragrafin 5.1 të Kartës Evropiane mbi statutin e gjyqtarëve dhe që disa Shtete të caktuara Evropiane e kanë ngritur në një hierarki më të detajuar sanksionesh për të përmbushur këtë parim.

Referuar kompetencës kushtetuese që e detyron gjyqtarin të luajë një rol themelor dhe të mbart përgjegjësi të rëndësishme në administrimin e drejtësisë në emër të shoqërisë dhe interesit publik; (ii) duke vlerësuar se veprimet dhe mosveprimet e gjyqtarit në kuadër të dhënies se drejtësisë kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në mbrojtjen dhe/ose cenimin e interesit të individëve dhe të Shtetit; (iii) duke mbajtur në konsideratë se besimi i publikut në sistemin e drejtësisë është pazgjdhshëmrisht i lidhur me transparencën, efektivitetin, profesionalizmin dhe integritetin e treguar nga gjyqtaret në ushtrimin e detyrës së tyre, çmojmë se elementet e analizuara dhe të përcaktuara në nenin 101 dhe 115 të Ligjit Për Statusin të cilat ndihmojnë për të konkluduar se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, nuk kanë një natyrë e peshë të tillë, të aftë për të aplikuar masën “in extremis” dhe shkaktuar përceptimin e publikut se drejtësia nuk funksionon.

Nga aktet e administruara në seance plenare, konkludohet se veprimtaria profesionale e gjyqtarit të materializuar në veprimet dhe mosveprimet e tij nuk përbejnë shkelje në kuptim të nenit 102 të Ligjit Për Statusin por është shkaktuar si pasojë e njohurive, aftësive, gjykimeve dhe qëndrime të tilla që përfaqësojnë një model profesional, jo të formës së kërkuar, dhe duhet t’i nënshtrohet vlerësimit etiko - profesional dhe të merret në konsideratë në sistemin e vlerësimit etiko – profesional të tij.

Aftësitë mbi njohuritë ligjore të kandidatit duhet t’i nënshtrohen procesit të vlerësimit etiko – profesional për shkak se në disa vendime të dhëna prej tij që ishin pjesë e procedimit disiplinor, kandidati nuk ka respektuar Vendimin Unifikues nr. 2, datë 25.05.2015 të Gjykatës së Lartë. Gjykata e Lartë në këtë vendim ka unifikuar praktikën gjyqësore në lidhje me interpretimin e shprehjes “arsye të veçanta” të përfshirë në nenin 64 të Kodit Penal që bën fjalë për rastet e “Lirimit para kohe me kusht”.

Vendimet unifikuese në fushën penale të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 438 paragrafi i 4 i KPP⁴³ janë të detyrueshme për tu zbatuar nga gjykata në rastet e tjera të ngjashme.

Në shqyrtimin e kërkesës për lirim para kohe me kusht nga i dënuari {...} regjistruar më datë 24. 09. 2018 në Gjykatën e Rrethit gjyqësor Gjirokastrë ka rezultuar se me vendimin e magjistratit datë 23. 10. 2018 është urdhëruar pezullimi i pjesës së mbetur të pavaajtur të dënimit prej 3 (tre) muaj e 28 (njëzet e tetë) ditë burgim për të dënuarin, të dhënë me vendimin nr. 394, datë 23.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, për veprën penale “Dhunë në familje” duke e vënë në provë kërkuesin {...}, për një periudhë prej 3 (tre) muaj e 28 (njëzet e tetë) ditë.

⁴³ Neni 438 paragrafi i 4 i KPP ka qenë në fuqi në kohën kur janë gjykuar çështjet penale me objekt lirim para kohe me kusht nga magjistrati, objekt i procedimit disiplinor. Aktualisht i njëjti përcaktim ligjor mbi detyrimin e zbatimit të vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara nga gjykata gjendet i parashikuar në nenin 438 paragrafi i 8 i KPP i ndryshuar në vitin 2021.

Nga aktet e përcjella nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë rezulton se shtetasi {...} ka qenë fillimisht i dënuar më parë për veprën penale të “Mosdhënia e mjeteve për jetesë”, parashikuar nga neni 125 i Kodit Penal, dënuar me vendimin nr. 23-2016-898 (125), datë 03.05.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, me 100.000 lekë gjobë. Mbi ankimin e bërë nga prokurori, Gjykata e Apelit Gjirokastrë me vendimin nr. 20-2016-831/195, date 21.07.2016 ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Sarandë duke deklaruar fajtor të pandehurin {...}, për kryerjen e kundërvajtjes penale të “Mosdhënia e mjeteve për jetesë” të parashikuar nga neni 125 i K. Penal dhe dënimin e tij me 3 (tre) muaj burgim. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim duke urdhëruar vënien në provë për 18 muaj. Urdhërohet i pandehuri të mbajë kontakte me shërbimin e provës si dhe me detyrimin që të paguajë pensionin ushqimor për fëmijët”.*

Vendimi është ekzekutuar me urdhrin nr. 282, datë 25.10.2016 të prokurorit të Prokurorisë Sarandë. Me vendim të prokurorit datë 19.02.2017 është vendosur pushimi i ekzekutimit të urdhrin të ekzekutimit nr. 282, datë 25.10.2016 në ngarkim të {...}, për shkak se përfiton nga amnistia, ku arsyetohet *“Nisur nga fakti se dënimi alternativ është vënë në ekzekutim, si dhe bazuar në ligjin nr. 141/2016, datë 22.12.2016 “Për dhënie amnistie”, neni 3, i dënuari plotëson kriteret për të përfituar nga kjo amnisti dhe për rrjedhojë ekzekutimi i mëtejshëm i këtij vendimi duhet të pushojë”.*

Ky vendim dënimi është i ndryshëm dhe i pari në radhë nga vendimi i dytë i dënimit të kërkuesit për të cilin ai u lirua para kohe me kusht. Ndaj kërkuesi {...} në kohën e shqyrtimit të kërkesës për lirim para kohe me kusht ekzistonin dy dënime njëri për kundërvajtje penale të përmendur më lart për të cilin u pushua ekzekutimi i tij për shkak amnistie dhe dënimi i dytë i dhënë për krimin e “Dhunës në familje”.

I përmendim këto dy dënime pasi ato kanë rëndësi në drejtim të përcaktimit të gjendjes gjyqësore të të dënuarit, gjendje e cila duhet të merret në vlerësim nga magjistrati në rastin e shqyrtimit të kërkesës për lirim para kohe me kusht mbështetur në nenin 64 të KP.

Lidhur me gjendjen gjyqësore të të dënuarit, në rast se i dënuari rezulton përsëritës për krime të kryera me dashje, gjykata në bazë të nenit 64, paragrafi 3 të Kodit Penal, është e detyruar të rrëzojë kërkesën, pasi ky element konsiderohet si ndalues i dhënies së lirit me kusht. Në rastin konkret rezultoi se i dënuari përveç dënimit për veprën penale që ishte duke vuajtur për të cilin ka kërkuar dhe lirimin me kusht ishte dënuar më parë për kundërvajtjen penale të “Mosdhënia e mjeteve për jetesë”, parashikuar nga neni 125 i Kodit Penal me vendimin e formës së prerë të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë në datën 21.07.2016. Kërkuesi rezulton të jetë dënuar dy herë nga gjykata. Herën e parë ai është dënuar për kundërvajtjen penale të “Mosdhënia e mjeteve për jetesë” të parashikuar nga

neni 125 i K. Penal me një dënim me 3 muaj burgim duke u pezulluar ekzekutimi i tij. Herën e dytë kërkuesi është dënuar për krimin e *“Dhunës në familje”* parashikuar nga neni 130/4 i KP.

Dënimi i mëparshëm për kundërvajtje penale nuk përbën një kusht ndalues nga neni 64, paragrafi 3 i Kodit Penal, i cili parashikon se nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje. Kjo është arsyeja se në këtë rast magjistrati nuk ka shkelur kriterin urdhërues të nenit 64 të KP sipas të cilit vetëm për të dënuarin përsëritës për krim nuk lejohet lirimi para kohe me kusht.

Megjithatë, sipas Vendimit Unifikues nr. 2, datë 25.05.2015, në rastet e tjera, hetimi mbi gjendjen gjyqësore të të dënuarit duhet të vlerësohet në perspektivën e rrezikut të recidivizmit të tij. Në këtë rast hetimi mbi gjendjen gjyqësore të të dënuarit nuk është kryer i plotë nga magjistrati në këtë gjykim. Është e vërtetë që në vërtetimin e gjendjes gjyqësore nr. 17, datë 20.8.2018 të sjellë në gjykim rezulton se kërkuesi {...} rezulton i padënuar. Gjithsesi kjo rrethanë referuar provave të shqytuara në gjykim ka qenë i pamjaftueshëm për të konfirmuar plotësisht gjendjen gjyqësore të të dënuarit. Në dosjen e kërkesës për lirim me kusht gjendet vendimi gjyqësor për të cilin kërkohet lirimi me kusht. Më konkretisht me vendimin nr. 394, datë 23.12.2016 shtetasi {...} është dënuar për veprën penale *“Dhuna në familje”*, parashikuar nga neni 130/4 i KP. Në këtë vendim pasqyrohet edhe gjendja gjyqësore e tij si i dënuar më parë, për kryerjen e veprës penale të *“Mosdhënia e mjeteve për jetesë”*, parashikuar nga neni 125 i KP. Në këtë mënyrë magjistrati nuk ka kryer një hetim të plotë gjyqësor mbi gjendjen gjyqësore të të dënuarit dhe për pasojë nuk e ka vlerësuar këtë rrethanë në perspektivën e rrezikut të recidivizmit të tij.

Në bazë të vërtetimit të gjendjes gjyqësore nr. 17, datë 20.8.2018 që gjendet në dosjen e lirimit me kusht rezulton se {...} është i padënuar, ndërkohë që përfundimi i dënimit të tij për veprën penale të *“Mosdhënia e mjeteve për jetesë”*, konsiderohet data 19.2.2017 kur ka dalë urdhri i prokurorit për pushimin e ekzekutimit të dënimit për shkak të amnistisë. Realisht shtetasi {...} do të rezultonte i padënuar, pasi të kishte kaluar dhe periudha e rehabilitimit prej 2 vitesh nga data 19.2.2017, që do të thotë pas datës 19.2.2019.

Mungesa e një hetimi të plotë në këtë rast ka shmangur përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në vendimin e Kolegjeve të Bashkuara nga ana e magjistratit. Më konkretisht në vendimin unifikues Nr. 2, datë 25.05.2015, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, janë analizuar dhe janë dhënë sqarime të hollësishme në kuptimin dhe zbatimin në praktikë të shprehjes *“arsye të veçanta”* të parashikuara nga neni 64 i Kodit Penal, ku merren parasysh:

- Natyra e veprave penale të kryera;

- Qëndrimi i personit të dënuar ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjareve të viktimës;
- Gjendja fizike apo psikologjike e personit të dënuar;
- Dinamika e sjelljes së të dënuarit në I.E.V.P;
- Kushtet familjare dhe prejudhjen shoqërore të të dënuarit.

Nisur nga natyra e veprës penale sipas vendimit unifikues, gjykata në shqyrtimin e kërkesave për lirim para kohe me kusht duhet të mbajë në konsideratë rrethana e kryerjes së veprës penale. Një vepër penale e kryer në bashkëpunim, me paramendim, apo me dhunë tregon për një shkallë të lartë rrezikshmërie të të dënuarit, çka duhet të shtyjë gjykatën për të qenë veçanërisht e kujdesshme në pranimin e kërkesës për lirim me kusht.

Në lidhje me rrethanën e dytë të evidentuar nga vendimi unifikues që lidhet me qëndrimin e të dënuarit ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjarëve të saj nga aktet e dosjes së procedimit disiplinor ka rezultuar se për veprën penale të dhunës në familje kërkuesi në gjykimin e kësaj vepre penale nuk e ka pranuar atë, duke pretenduar pafajësi. Në fazën e ekzekutimit të dënimit me burgim sipas raportit të {...} i dënuari e kishte pranuar kryerjen e veprës penale, por nuk është shprehur për pendesë. Në këtë pikë mund të vihet në diskutim çështja e rehabilitimit të tij, çështje e cila duhet të hetohet nga magjistrati dhe të pasqyrohet në vendimin e dhënë prej tij.

Në lidhje me rrethanën e normalizimit të marrëdhënieve me viktimën e përcaktuar si rrethanë nga vendimi unifikues si dhe nga nenit 31/6 të ligjit nr. 10024, datë 27.11.2008 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar nga aktet e dosjes ka rezultuar se, si nga raporti vlerësues i Shërbimit të Provës, ashtu edhe nga vlerësimi i sjelljes nga {...} Durrës, nuk gjendet i pasqyruar informacioni për të konfirmuar marrëdhëniet e kërkuesit me viktimën ose me familjarët e viktimës.

Në vetvete normalizimi i marrëdhënieve nuk është kusht i domosdoshëm për pranimin e kërkesës për lirim me kusht, por referuar lidhjes që kanë dy veprat penale për të cilat është dënuar kërkuesi në drejtim të fëmijës dhe ish gruas së tij, këto rrethana duhet të ishin të pasqyruara në vendimin gjyqësor të liritim para kohe me kusht si pjesë e hetimit dhe e vlerësimit të gjykatës.

Rrethanat e mësipërme nuk janë hetuar plotësisht nga magjistrati në gjykimin e kërkesës së të dënuarit {...} për lirim para kohe me kusht. Hetimi i plotë i këtyre rrethanave dhe konkluzioni që duhet të nxirret pas përfundimit të këtij hetimi përbën një shkak të arsyeshëm për të arritur në përfundimin se magjistrati nuk ka përmbushur tërësisht përcaktimet e kërkuara nga vendimi unifikues i Kolegjeve të Bashkuara.

Për çështjen e sjellë në kuadër të procedimit disiplinor për shqyrtimin e kërkesës së lirit para kohe me kusht për të dënuarin {...} në vlerësimin tonë janë evidentuar të njëjtat mangësi nga magjistrati në drejtim të mosrespektimit të vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të përmendur më lart.

Kërkesa e shtetasit {...} për lirim para kohe me kusht, është regjistruar me nr.17/80103-00700-21-2021 Akti, datë 13.09.2021 në gjykatën e rrethit gjyqësor Gjirokastrë dhe i ka rënë short për tu gjykuar nga magjistrati A. {...}.

Me vendimin nr. 21-2021-1771/17, datë 21.10.2021, gjyqtari {...} ka vendosur lirim me kusht të të dënuarit {...}, duke urdhëruar pezullimin e pjesës së mbetur të pavuajtur prej 1 (një) vit e 21 (njëzet e një) ditë burgim, të dënimit të dhënë me vendimin nr. 23-2020-506/98, datë 21.04.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, duke e vënë në provë të dënuarin {...} për një periudhë prej një (1) vit e 21 (njëzet e një) ditësh.

Në vendimin e lirit me kusht gjykata ka evidentuar se me vendimin nr. 23-2020-506/98, datë 21.04.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, kërkuesi {...} është dënuar me 5 (pesë) vjet burgim, për veprën penale të parashikuar nga neni 283/2 i KP. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë me vendimin nr. 36, datë 10.09.2020. Kërkuesi është arrestuar në datën 24.11.2018 dhe deri në ditën e dhënies së këtij vendimi, i kanë mbetur pa vuajtur 1 vit e 21 ditë burgim.

Në vlerësimin e “arsyeve të veçanta” të interpertuara tashmë nga vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë, në funksion të edukimit dhe riintegrit të kërkuesit në shoqëri, gjykata në çdo rast duhet të mbajë në konsideratë raportet e vlerësimit të kryera nga institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale ({...}) si dhe raportet e shërbimit të provës të zyrës vendore përkatëse. Këto raporte normalisht duhet ta kenë vlerësuar pozitivisht sjelljen e të dënuarit në {...} gjatë kohës së dënimit, si dhe duhet të tregojnë mundësinë për rehabilitim dhe risocializim të tij në shoqëri. Në rastin e të dënuarit {...} këto raporte të administruara gjatë gjykimit nuk janë cituar me hollësi në përmbajtjen e vendimit.

Sipas vlerësimeve periodike 6 mujore për sjelljen e të dënuarit në {...} Tepelenë gjatë gjithë qëndrimit në këtë institucion ka rezultuar se ai nuk e ka pranuar veprën penale. Njëkohësisht ka rezultuar se kërkuesi ka marrë një masë disiplinore për shkak të sjelljes së tij gjatë fazës së ekzekutimit të dënimit me burgim. Në vlerësimin e sjelljes që është paraqitur në gjykatë me shkresën me nr. 164, datë 7.10.2021, kërkuesi është vlerësuar negativisht nga institucioni i vuajtjes së dënimit duke mbajtur si qëndrim rrëzimin e kërkesës për lirim para kohe me kusht për të dënuarin Aldo Para. Arsyet për rrëzimin e kërkesës për të dënuarin nga ana e {...} Tepelenë lidheshin me faktin e problemeve të

sjelljes së tij gjatë fazës së vuajtjes së dënimit, si dhe në vlerësim të këtij institucioni i dënuari konsiderohej përsëritës.

Gjithashtu, nga shërbimi i provës me raportin nr. 292, datë 11.10.2021 konkludohet se nuk për të dënuarin {...} nuk është arritur qëllimi për riedukimin dhe rehabilitimin e tij, duke e lënë në çmim të gjykatës, duke u shprehur se mundësia për t'u integruar në familje e shoqëri është një mundësi normale e vështirë, por edhe e mundshme.

Në të tilla kushte për kërkuesin {...} nuk është bërë një hetim gjithëpërfshirës në drejtim të plotësisht prej tij të të gjitha "arsyeve të veçanta" të përcaktuara në vendimin unifikues të përmendura më lart, si rrethana të posaçme që duhet të evidentohen detyrimisht nga gjykata në rastin e shqyrtimit të kërkesës për lirim para kohe me kusht. Masa disiplinore e marrë nga kërkuesi gjatë fazës së ekzekutimit të dënimit është një rrethanë e cila do të duhet të evidentohet në vendimin e gjykatës, në drejtim të përcaktimit të sjelljes së tij si pjesë e vlerësimit nga gjykata. Referuar "arsyeve të veçanta" në vendimin unifikues pranimit të kërkesës së të dënuarit mund të realizohet nga gjykata vetëm në rast se i dënuari nëpërmjet rrethanave konkrete që lidhen me punën dhe sjelljen e tij gjatë vuajtjes së dënimit duhet të tregojë se është arritur qëllimi i riedukimit të tij.

Në rastin e kërkuesit {...} marrja e një mase disiplinore nga institucioni i vuajtjes së dënimit nuk passjell në mënyrë automatike rrëzimin e kërkesës për lirim para kohe me kusht. Neni 64 i KP nuk e ka përcaktuar si kriter ndalues për lirim para kohe me kusht marrjen e masës disiplinore. Gjithsesi sipas vendimit unifikues referuar "arsyeve të veçanta" që parashikon neni 64 i KP, këto arsye lidhen me punën dhe sjelljen korrekte që duhet të shfaq i dënuari gjatë vuajtjes së dënimit. "Arsyet e veçanta" përfaqësojnë rrethana që duhet të tregojnë se është arritur qëllimi i riedukimit dhe riintegritimit në shoqëri për të dënuarin. Në vendimin e dhënë nuk janë treguar arsyet se pse masa disiplinore e marrë nga i dënuari nuk kanë ndikuar ndjeshëm negativisht në sjelljen e tij dhe si e tillë kjo masë nuk është bërë pengesë për lirim para kohe me kusht.

Duke mos u shprehur në vendim për një situatë të tillë magjistrati ka anashkaluar detyrimet e përcaktuara në vendimin unifikues. Një hetim më i plotë dhe pasqyrim i këtij hetimi në përmbajtjen e vendimit të dhënë prej magjistratit do të përligjte jo vetëm përfundimin e arritur në këtë vendim, por do të përmbushte kriterin ligjor të respektimit të vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara për gjykatën më të ulët në bazë të nenit 438 të KPP.

Interesi për një hetim më të plotë dhe të gjithanshëm shtohen edhe më shumë në këtë rast për shkak të një çështje tjetër që e identifikon të dënuarin {...} si person të rehabilituar. Më parë shtetasi {...} ka qenë i dënuar me 8 (tetë) muaj burgim nga gjykata e rrethit gjyqësor Përmet me vendimin nr. 61 datë 11. 11. 2013 për veprën penale të "Vjedhjes". Shtetasi {...} e ka vuajtur këtë dënim si dhe më

pas rezulton të jetë i rehabilituar, pasi gjatë procesit të rehabilitimit ai nuk kishte kryer vepër tjetër penale.

Në vlerësimin e {...} Tepelenë, instituti i rehabilitimit nuk ndikon në përcaktimin e cilësisë si përsëritës (recidiv) të një personi të dënuar që kërkon lirim para kohe me kusht. Cilësia e të dënuarit si përsëritës në krim është një kriter ndalues ligjor për lirimin e tij me kusht në bazë të nenit 64 të KP. Duke ndjekur këtë logjikë, {...} Tepelenë në përfundim të gjyqimit të kërkesës për lirim para kohe me kusht ndaj të dënuarit {...} ka kërkuar rrëzimin e kësaj kërkesë, ku ndër të tjera si shkak i mospranimit të saj është edhe fakti se kërkuesi është përsëritës (recidiv).

Ndodhur përpara kësaj situatë magjistrati në vendimin e dhënë prej tij duhet të analizonte institutin e rehabilitimit në lidhje me nocionin “përsëritës” që kërkon neni 64 i KP si kriter ndalues për të rrëzuar kërkesën për lirim para kohe me kusht. Në këtë mënyrë magjistrati do t’i jepte një përgjigje konkrete kërkesës së paraqitur nga {...} Tepelenë, në vendimin e lirimit para kohe me kusht të dhënë ndaj të dënuarit {...}.

Të gjitha arsyet e përmendura më lart, në vlerësimin tonë përbëjnë shkaqe të rëndësishme që duhet të merren në konsideratë nga Këshilli gjatë procesit të vlerësimit etiko – profesional të magjistratit.

ANËTAR

ANËTARE

ANËTAR